



MES RITJES SË ÇMIMEVE, QYTETARËT HAPIN KULETAT EDHE PËR PARTITË

FAQE 4-5



Pavarësisht prej rritjes së çmimeve dhe inflacionit, qytetarët në Kosovë vazhdojnë të dhurojnë para për partitë politike gjatë fushatave zgjedhore. Ekspertët paralajmërojnë se donacionet shpesh nuk burojnë vetëm nga bindja politike, por edhe nga pritjet për favore

**ÇFARË
TREGON
RINUMËRIMI
I VOTAVE
DERI TANI?**

F. 5



**ISH-KANDIDATË
PËR ASAMBLISTË
NË FERIZAJ
KËRKOJNË HETIM
TË REZULTATIT TË
ZGJEDHJEVE
LOKALE**

F. 7



AKTUALE



**TË PAKTËN 11 TË VDEKUR
NË SHBA SI PASOJË
E STUHSË DIMËRORE**

F. 2


**OSMANI THEKSON RËNDËSINË E
KONSTITUIMIT SA MË TË SHPEJTË
TË INSTITUCIONEVE**

F. 2

**KOSOVA LANSON RRJETIN
E PARË TË GRAVE NË SIGURI,
NËNSHKRUHEN MEMORANDUMET**

F. 3

EKONOMI



**TRANSPORTUESIT RAJONALË
BLLOKOJNË KUFIJTË ME BE-në,
KOSOVA NË VËSHTIRËSI**

F. 8

SPORT



DRITA FITUESE E SUPERKUPËS

F. 11

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princsha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Osmani thekson rëndësinë e konstituimit sa më të shpejtë të institucioneve

PRISHTINË, 26 JANAR - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, priti sot në takim shefin e Misionit të OSBE-së në Kosovë, ambasadorin Gerard McGurk, me të cilin diskutoi për zhvillimet e fundit politike dhe institucionale në Kosovë.

Gjatë takimit u diskutua për procesin e zgjedhjeve parlamentare të 28 dhjetorit, ndaj në këtë kontekst, presidentja theksoi rëndësinë e konstituimit sa më të shpejtë të institucioneve. Më tutje, presidentja Osmani

dhe ambasadori McGurk diskutuan edhe rëndësinë e bashkëpunimit të vazhdueshëm midis institucioneve të Kosovës dhe OSBE-së në funksion të forcimit të demokracisë dhe sundimit të ligjit.



NETANYAHU PRET RAMËN NË JERUSALEM: PËRFAQËSONI SHPIRTIN E VËRTETË TË SHQIPËRISË

TIRANË, 26 JANAR - Kryeministri i Izraelit, Benjamin Netanyahu, ka pritur në Jerusalem kryeministrin e Shqipërisë, Edi Ramën, të cilin e quajti një mik të madh të tijin personal dhe të Izraelit. “Kryeministri Rama është mik i madh i popullit dhe shtetit hebre dhe një mik i madh i imi. Ai përfaqëson shpirtin e vërtetë të Shqipërisë”, tha Netanyahu. Ai gjithashtu përmendi faktin historik të mbrojtjes së hebrenjve nga shqiptarët gjatë Luftës II Botërore. “Bota duhet ta dijë që Shqipëria ishte i vetmi vend

evropian ku u rrit popullsia hebre u rrit dhe nuk u mpak. Sepse populli shqiptar, myslimanët shqiptarë, në frymën e moderimit dhe tolerancës, dinjitetit njerëzor, mbrojtën qindra hebrenj që jetonin asokohe në Shqipëri dhe mikpritjen e mijëra të tjerëve. Kjo është histori që frymëzon filma. Kjo është ajo frymë që ju vazhdoni ta kultivoni edhe sot. Ju qëndroni me kurajë kundër atyre që duan t’iu zmbropsin, qëndroni krah të vërtetës, ju qëndruat krah së vërtetës kur u sulmuam nga barbarët. Busulla juaj morale nuk u



lëkund. Kjo ju shënon si një udhëheqës të jashtëzakonshëm të popullit tuaj”, shtoi ai. Netanyahu tha se mes dy shteteve po ndërtohen marrëdhënie të shkëlqyera. “Numri i turistëve izraelitë që kanë shkuar në Shqipëri është rritur me 800 %. Mund t’u them të gjithë izraelitëve që Shqipëria është vend i mrekullueshëm, kështu që shkoni atje”, u shpreh ai. Kryeministri izraelit njoftoi edhe hapjen e Dhomës së përbashkët të Tregtisë në Jerusalem, e cila sipas tij do të çojë përpara lidhjet ekonomike mes dy vendeve.

TË PAKTËN 11 TË VDEKUR NË SHBA SI PASOJË E STUHSË DIMËRORE



NJU-JORK, 26 JANAR - Një stuhi e rrezikshme dimërore i ka mbështjellë Shtetet e Bashkuara, duke lënë të paktën 11 persona të vdekur. Mijëra persona raportohet të kenë mbetur pa energji elektrike. Shumë shkolla dhe rrugë nëpër ShBA janë mbyllur ndërsa mbi 11 mijë fluturime janë anuluar për shkak të kushteve “të rrezikshme për jetë”, sipas Shërbimit Kombëtar për Motin. Kryetari i Qytetit të Nju-Jorkut, Zohran Mamdani, ka thënë se

pesë persona kanë vdekur si pasojë e motit. Të paktën dy persona kanë vdekur si pasojë e hipotermisë në Luizianë dhe vdekje tjera të lidhura me stuhinë janë raportuar në Teksas, Tenesi dhe Kansas. Autoritetet kanë paralajmëruar se mund të ketë reshje të shumta të borës dhe akull të zi për disa ditë. Stuhia besohet se ka prekur mbi 180 milionë amerikanë - që do të thotë më shumë se gjysmën e popullsisë. Kryetari i qytetit të Nju-Jorkut, Zohran Mamdani, ka thënë

përmes një postimi në “X” që të paktën tetë persona kanë vdekur të shtunën, mirëpo shkaqet nuk janë përcaktuar ende. Ekspertë për motin kanë paralajmëruar që njëra prej rreziqeve më të mëdha të stuhisë është akulli, i cili mund t’i dëmtojë drunjtë, t’i shkatërrojë kabllot e energjisë dhe t’i bëjë rrugët të pasigurta. Ata besojnë se ndryshimet klimatike mund të kenë ndikuar në ashpërsimin e kushteve klimatike të çdo stine.

Alarm ekonomik: Mbi një miliard dollarë humbje në ditë nga bllokadat në kufijtë e Ballkanit Perëndimor

PRISHTINË, 26 JANAR - Aleanca Kosovare e Bizneseve (AKB) paralajmëron se bllokadat kufitare të krijuara pas zbatimit të Sistemit EES nga BE-ja po shkaktojnë humbje mbi 1 miliard dollarë në ditë në qarkullimin e mallrave ndërmjet Ballkanit Perëndimor dhe BE-së. “Kamionë të bllokuar, mallra

të vonuara, biznese në humbje. Transportuesit dhe bizneset po paguajnë çmimin e një sistemi të paadaptuar për realitetin e rajonit. Protestat e sotme janë pasojë e drejtpërdrejtë e këtyre barrierave që po godasin ekonominë rajonale. AKB-ja kërkon urgjentisht: zbatim fleksibil të EES për Ballkanin

Perëndimor kapacitete shtesë në pikat kufitare dialog të menjëhershëm me transportuesit dhe bizneset. Çdo ditë vonesë humbje të reja milionëshe dhe miliardëshe. AKB do të vazhdojë të jetë zëri i bizneseve transportuesve dhe EU mos të jetë pengesa”, thuhet në reagimin e AKB-së.



Kosova lanson Rrjetin e parë të Grave në Siguri, nënshkruhen memorandumet

PRISHTINË, 26 JANAR - Fondacioni Jahjaga ka lansuar të hënën Rrjetin e Grave në Siguri, i cili synon të jetë mekanizëm mbështetës që plotëson strukturat ekzistuese institucionale të sigurisë. “Sot, Fondacioni Jahjaga shënoi një hap të rëndësishëm në fushën e sigurisë duke lansuar Rrjetin e Grave në Sektorin e Sigurisë në Kosovë. Ky projekt i mbështetur nga Mbretëria e Holandës u formalizua nëpërmjet nënshkrimit të memorandumëve të mirëkuptimit mes Fondacionit



Jahjaga të përfaqësuar nga Kosovës, Policinë e Kosovës,
drejtoresha ekzekutive znj. Inspektoratin Policor të
Bexheti me Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe Shërbimin

Korrektues të Kosovës”, ka njoftuar në “Facebook”, ish-presidentja e Kosovës, Atifete Jahjaga.

Ajo ka theksuar se kjo nismë është pjesë e angazhimit për Agjendën e Grave, Paqes dhe Sigurisë, në përputhje me Rezolutën 1325 të OKB-së, dhe me mbështetjen e çmuar të Mbretërisë së Holandës, përmes Fondit MATRA dhe Human Rights Fund, si dhe bashkëpunimit me institucionet vendore dhe partnerët ndërkombëtarë. “Ky rrjet synon të fuqizojë

bashkëpunimin profesional, ndarjen e përvojave dhe rolin e grave në institucionet e sigurisë. Shpreh mirënjohje të veçantë për Mbretërinë e Holandës për mbështetjen e vazhdueshme dhe për të gjithë partnerët institucionalë për gatishmërinë dhe bashkëpunimin për realizimin e kësaj iniciative. Ndryshimi i vërtetë fillon kur vendosim të mos punojmë më vetëm, por së bashku. Pasi kur punojmë së bashku, forcojmë gratë, institucionet dhe vetë sigurinë e Kosovës”, ka thënë Jahjaga.

MINISTRI VENÇU: MARRËVESHJA SHQIPËRI-KOSOVË-KROACI KUNDËR ASKUJT

**EPOKA
ERE** **Faton DËRMAKU**

TI RANË, 26 JANAR - Ministri i Mbrojtjes i Shqipërisë, Pirro Vengu, tha se marrëveshja në fushën e mbrojtjes mes shtetit të tij, Kosovës dhe Kroacisë nuk është kundër askujt, as ndaj Serbisë, të cilën tha se e ka ftuar që t'i bashkohet. Kjo deklaratë vjen pasi ai u pyet për të komentuar deklaratat e bëra më herët nga presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, se kjo marrëveshje - e arritur në mars të vitit 2025 - është kundër serbëve, dhe këto shtete janë pjesë e një "aleance sulmuese". Edhe kur u nënshkrua marrëveshja për bashkëpunim në fushën e mbrojtjes, Serbia kishte reaguar ashpër, duke e cilësuar si një nismë kundër saj. Vengu tha se ka vërejtur që herë pas here "ka një sens paniku" në deklaratat zyrtare nga Serbia për këtë temë. "Ajo që mund t'iu them është që kjo është një marrëveshje trepalëshe e cila nuk është ndërtuar kundër askujt. Madje kam qenë unë i pari që kam shprehur ftesën pse jo që në qoftë se Serbia e gjykon që rajoni, stabiliteti, qëndrueshmëria dhe e ardhmja euroatlantike e vendeve të rajonit është e rëndësishme, atëherë pse jo edhe Serbia t'i bashkëngjitet kësaj iniciative. Ua merr mendja që nuk kam



marr përgjigje për sa i përket kësaj ftese”, tha ai.

Vengu, në një konferencë për media më 26 janar, tha se Shqipëria dhe Kosova kanë filluar “në bazë të kësaj marrëveshjeje, qoftë në rrafshin ushtarak, stërvitor, akademik-arsimor, por edhe të prodhimit ushtarak, të bashkëpunojnë”. Sipas tij, me Prishtinën, Tirana ka pajtëm s ai përket prodhimit

të mjeteve të blinduara, pasi që,
vlerësoi ai, të dy shtetet i shohin
njësojë kërcënimet dhe rreziqet
që i kanosen rajonit. “E dyta,
nuk besoj se Kroacia, Shqipëria
dhe Kosova, kanë nevojë të
marrin leje për saj i përket kësaj
pjesë. E treta, mirëpresim edhe
vende të tjera të na bashkohen.
Pra, është një bashkëpunim dhe
partneritet i hapur. Shumëkush
e quan aleancë, shumëkush

marrëveshje të mbrojtjes. Nuk jemi në situata të garancive të mbrojtjes”, tha Vengu. Sipas udhëheqësit të fushës së mbrojtjes në Shqipëri, të tri shtetet marrin më të mirat nga njëra-tjera me këtë marrëveshje. “Kroacia është vend lider në Evropë sa i përket dronëve të vegjël luftarakë dhe ka një industri të konsoliduar, si kundër edhe ne synojmë që në

pjesën e mjeteve taktike dhe të blinduara të krijojmë një epërsi dhe të mund të fillojmë të eksportojmë”, u shpreh ai.

Në fillim të janarit, Vuçiqi i akuzoi të tri shtetet se kanë krijuar një aleancë ushtarake dhe sulmuese, që sipas tij, është kundër serbëve. “Kjo është një aleancë sulmuese. Ka njerëz që ëndërrojnë se kur ka konflikt midis pjesëve të Perëndimit dhe Rasisë, kjo është një mundësi për ish-aleatët rusë, si ne, që të shkatërrohen plotësisht”, u shpreh presidenti serb.

Kroacia i është kundërpërgjigjur duke thënë se, si shteti anëtar i Bashkimit Evropian, bën thirrje për bashkëpunim dhe paqe në rajonin e Ballkanit Perëndimor. “Kroacia është anëtare e Bashkimit Evropian dhe gjithçka që bën në marrëdhëniet ndërkombëtare e bën në mënyrë transparente”, tha ministri i Punëve të Brendshme të Kroacisë, Davor Bozhinović.

Kroacia dhe Shqipëria janë pjesë e aleancës ushtarake perëndimore të NATO-s, aty ku Kosova shpreson të anëtarësohet.

Në kuadër të marrëveshjes së arritur, shtetet parashohin promovim të kapaciteteve mbrojtëse dhe bashkëpunimit, ndërveprimin përmes edukimit, trajnimit dhe kundërpërgjigje ndaj kërcënimeve hibride.

Shefi i Misionit të OSBE-së përgëzon KQZ-në për organizimin e procesit zgjedhor

PRISTINE, 26 JANAR - Kryesuesi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Kreshnik Radoniqi, ka pritur në takim shefin e Misionit të OSBE-së në Kosovë, Gerard McGurk. Gjatë takimit, Radoniqi e njoftoi ambasadorin McGurk për aktivitetet që aktualisht po i zhvillon Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në drejtim të

përmbylljes së procesit të rinumërimit të vendotimeve dhe shpalljes së rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve të parakohshme për Kuvendin e Kosovës. Nga ana e tij, ambasadori McGurk përgëzoi KQZ-në për organizimin e procesit zgjedhor, si dhe për hapat e ndërmarrë në evidentimin e problemeve gjatë procesit të

numërimin të votave për kandidatët për deputetë. Ai theksoi përkushtimin e KQZ-së në mbrojtjen e integritetit të votës dhe rezultateve zgjedhore. Në fund të takimit, Radoniqi dhe McGurk u pajtuan për hapat e ardhshëm të bashkëpunimit ndërmjet KQZ-së dhe Misionit të OSBE-së në Kosovë.





MES RRRITJES SË ÇMIMEVE, QYTETARËT HAPIN KULETAT EDHE PËR PARTITË

Pavarësisht prej rritjes së çmimeve dhe inflacionit, qytetarët në Kosovë vazhdojnë të dhurojnë para për partitë politike gjatë fushatave zgjedhore. Ekspertët paralajmërojnë se donacionet shpesh nuk burojnë vetëm nga bindja politike, por edhe nga pritjet për favore

PRISHTINË, 26 JANAR - Ndërsa disa qytetarë të Kosovës ankohen për çmime të larta dhe vështirësi për t'i përballuar shpenzimet mujore, të tjerë vazhdojnë t'i hapin kuletat sa herë që vendi hyn në fushatë zgjedhore. Edhe zgjedhjet e fundit lokale, të mbajtura më 12 tetor dhe raundi i dytë më 9 nëntor 2025, nuk bënë përjashtim. Nga 10 deri në 2 000 euro - kaq dhuruan dhjetëra qytetarë, anëtarë dhe simpatizantë për partitë më të mëdha politike në vend: Lëvizjen Vetëvendosje, Partinë Demokratike të Kosovës, Lidhjen Demokratike të Kosovës e Aleancën për Ardhmërinë e Kosovës. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) publikoi këtë muaj raportet e paaudituar të deklarimit financiar të subjekteve politike për fushatën e zgjedhjeve

lokale. Radio Evropa e Lirë kontaktoi përmes rrjeteve sociale nga dy qytetarë që dhanë donacione për Vetëvendosjen, PDK-në dhe LDK-në por, përkundër insistimit, asnjëri nuk pranoi të përgjigjej nëse gjesti i tyre ishte thjesht mbështetje e sinqertë politike, apo kishte ndonjë arsye tjetër.

Donacione që nuk janë gjithmonë mbështetje politike

Sipas përfaqësuesve të shoqërisë civile dhe ekspertëve të ekonomisë, dhënia e parave për partitë politike nuk buron gjithmonë nga bindja ideologjike. Altin Ademi nga organizata anti-korrupsion "Çohu" thotë se,

ndonëse një pjesë e qytetarëve kontribuojnë si shprehje e mbështetjes politike, mungesa e një tradite të qartë të profilizimit programor i bën këto donacione të perceptohen si investim për favore të ardhshme. "Në një kontekst ku besimi institucional është i brishtë, donacionet mund të shihen edhe si mënyrë për të ruajtur afërsinë me pushtetin apo për të krijuar pritje për përfitime - të drejtpërdrejta ose indirekte. Për këtë arsye, dhënia e donacioneve nuk është gjithmonë shprehje e pastër e bindjes politike", thotë Ademi për Radion Evropa e Lirë. Edhe profesori i Ekonomisë, Shkumbin Misini, vlerëson se motivet janë të ndryshme: nga pritjet për punësim në institucione publike deri tek "obligimi" ndaj partisë që i ka punësuar më herët. "... e një grup

më i vogël për shkak të lidhjes dhe besnikërisë ndaj liderit të partisë", sipas tij.

Sa mblodhën dhe sa shpenzuan partitë?

Sipas raporteve të KQZ-së, Lëvizja Vetëvendosje, si partia më e madhe në vend, grumbulloi 36.680 euro nga donacionet e qytetarëve. Pjesën më të madhe të financimit, ajo e kishte nga buxheti i shtetit - rreth 567 mijë euro. Por, shpenzimet e fushatës së saj arritën në rreth 992 mijë euro, ndaj partia mbeti me një borxh prej afro 388 mijë eurosh. PDK-ja mblodhi mbi 25 mijë euro donacione nga qytetarët, si dhe 223 mijë euro kontribute në mallra dhe shërbime. Në total, kjo parti kishte rreth 248 mijë euro në dispozicion, ndërsa fushata i kushtoi rreth 272 mijë euro. LDK-ja raportoi vetëm 7.750 euro donacione nga qytetarët dhe 15.790 euro kontribute - gjithsej 23.540 euro, ndërsa fushata i kushtoi rreth 203 mijë euro.

AAK-ja përfitoi vetëm 1.000 euro donacion nga një anëtar dhe 5.200 euro kontribute në mallra dhe shërbime, si dhe rreth 80 mijë euro nga buxheti i shtetit. Shpenzimet e fushatës i kishte mbi 61 mijë euro. Lista Serbe - partia më e madhe e serbëve në Kosovë - nuk raportoi as donacione e as kontribute, por shpenzoi rreth 334 mijë euro, prej të cilave 155 mijë i paraqiti si të hyra buxhetore.

Raporte që nuk pasqyrojnë realitetin?

Sipas Ademit dhe Misinit, vlerat e raportuara shpesh nuk reflektojnë gjendjen reale në terren. "Ekziston rreziku që donacionet individuale të përdoren si mbulesë për burime të tjera financimi, përmes ndarjes së shumave të mëdha në donacione më të vogla ose përdorimit të personave të tretë", paralajmëron Ademi. Misini shton se praktika të tilla janë të pranishme në Kosovë dhe se përbëjnë rrezik serioz për integritetin e procesit zgjedhor.

ÇFARË TREGON RINUMËRIMI I VOTAVE DERI TANI?

PRISHTINË, 26 JANAR - Derisa rinumërimi i votave të zgjedhjeve të parakohshme të dhjetorit po vazhdon në gjithë Kosovën dhe tashmë ka arritur në gjysmë të rrugës, dyshimet dhe hetimet për manipulim të votave janë duke u zgjeruar njëherazi edhe në pjesë të tjera të vendit.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve njoftoi të shtunën se janë rinumëruar mbi 55 për qind të votave në 2.557 vendvotime në mbarë vendin.

Rinumërimi nisi më 13 janar, fillimisht pjesërisht, pasi komisioni kishte gjetur mospërputhje në votat për kandidatët për deputetë të Kuvendit të Kosovës.

Por, kur mospërputhjet në vota u vërtetuan dhe dyshimet sa vinin e shtoheshin, autoritetet për zbatim të ligjit filluan të ndërmarrin masa.

Të dielën Gjykata Themelore në Prizren urdhëroi nga një muaj paraburgim për 23 të dyshuar për një sërë veprash penale lidhur me keqpërdorimin e votave, dy ditë pasi mbi 100 persona u arrestuan në këtë rajon.

Çfarë solli rinumërimi deri tani?

Nga rinumërimi i votave në mbi gjysmën e vendvotimeve deri tani, rreth 80 mijë vota të kandidatëve kanë rezultuar të pasakta dhe të numëruara gabimisht në Qendrat Komunale të Numërimit, sipas Eugen Cakollit nga organizata joqeveritare, Instituti Demokratik i Kosovës. “Prej tyre, pas rinumërimit, 47.619 vota u janë hequr kandidatëve (sepse u ishin shtuar gjatë numërimit



fillestar), ndërsa 32,018 vota u janë shtuar kandidatëve pas rinumërimit (sepse u ishin hequr në mënyrë të parregullt më herët)”, shkroi Cakolli në Facebook të premten.

Sipas tij, nga rreth 80.000 vota të prekura, afërsisht 40.000 i takojnë kandidatëve të Partisë Demokratike të Kosovës (DPK), rreth 15.000 partisë në pushtet Lëvizja Vetëvendosje (LV), rreth 11.000 Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) dhe rreth 4.000 Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK).

Mbi 80 për qind e këtyre votave vijnë vetëm nga komuna e Prizrenit, ndërsa pjesa tjetër nga Malisheva dhe Podujeva (në këtë të fundit janë rinumëruar vetëm 10 për qind të votave), shtoi Cakolli.

Rinumërimi i deritanishëm solli edhe veprime të autoriteteve për

zbatimin e ligjit në vend, pasi përveç Prizrenit, ato kanë zgjeruar hetimet edhe në Ferizaj dhe Malishevë.

Në ditët e fundit, prokurorët në Ferizaj dhe Gjakovë autorizuan Policinë të ndërmarrë të gjitha veprime, përfshirë identifikimin e personave përgjegjës, grumbullimin e të dhënave dhe sigurimin e provave në Ferizaj dhe Malishevë, lidhur me dyshimet për manipulim të votave.

Aksioni në Prizren

Autoritetet e kryen një aksion të premten në Prizren, komunën ku dyshohet se kishte më së shumti keqpërdorim të votave, duke i ndaluar 109 të dyshuar. Dy ditë më vonë, gjykata e pranoi kërkesën e prokurorëve për t'i dërguar në paraburgim 22

komisionarë dhe një vëzhgues të zgjedhjeve të 28 dhjetorit.

Gjykata tha të dielën se ata dyshohen për disa vepra penale, përfshirë atë kundër të drejtës së votimit, kanosjen, marrjen e ryshfetit dhe dhënien e ryshfetit. Dy ditë më parë, kryeprokurori i Prokurorisë Themelore në Prizren, Petrit Kryeziu, tha se në mesin e të arrestuarve në Prizren kishte edhe familjarë të kandidatëve për deputetë.

Sipas Kryeziut, një manipulim i tillë i votave nuk ka mundur që të ndodhë pa një kompromis mes komisionarëve të katër partive më të mëdha politike. “Po flasim për komunën e Prizrenit që janë shtuar hiç më pak se 40.497 vota dhe janë hequr hiç më pak se 27.520 vota. Pra, diferenca totale e keqpërdorimeve është 68.017 vota”, tha Kryeziu.

Reagimet

Teksa shumica e liderëve të partive të mëdha kishin reaguar pak pasi kishin dalë në sipërfaqe dyshimet për keqpërdorim të votave javë më parë, kryeministri në detyrë i Kosovës, Albin Kurti, njëherësh lider i partisë në pushtet, reagoi tek të shtunën.

Kurti bëri thirrje për hetim gjithëpërfshirës dhe ndëshkim për personat e dyshuar për manipulim të votave brenda partive politike.

Kurti, i cili paraprakisht ishte kritikuar për mosreagim - tha të shtunën në “Facebook” se “komisionerë e individë, që në mënyrë klandestine, janë përfshirë në manipulime votash brenda subjekteve politike duke dëmtuar kolegë e subjekte politike nuk kanë amnisti”.

Më herët, kryetari i PDK-së, Bedri Hamza, e kishte përshkruar rinumërimin si “hap të domosdoshëm dhe të drejtë” për mbrojtjen e integritetit të procesit zgjedhor.

Udhëheqësit e LDK-së dhe AAK-së, Lumir Abdixhiku dhe Ramush Haradinaj, kishin kërkuar më herët gjithashtu rinumërim të plotë, duke theksuar se vetëm ashtu mund të garantohej legjitimiteti i rezultateve.

Ndërkohë, edhe shumica e kandidatëve për deputetë të cilëve u janë hequr më së shumti vota gjatë rinumërimit, e kanë mohuar të kenë pasur gisht në keqpërdorim dhe kanë thënë se e dënojnë këtë dukuri.

Në Kosovë manipulimi i votave është vepër penale e dënueshme me burgim.

Megjithatë, së voni organizata joqeveritare, ÇOHU, e publikoi një hulumtim që tregoi se mbi 90 për qind e rasteve për manipulime zgjedhore përfundojnë me dënime me kusht ose gjoba.

“Forma më e zakonshme përfshin para të gatshme, pastrim të tyre, shpërndarje në emra të ndryshëm dhe depozitim në llogari të punëtorëve”, thotë ai. Kjo, sipas Misinit, krijon edhe një varësi të fshehtë të politikave nga grupet e interesit, si dhe cenon transparencën dhe llogaridhënien.

Në këtë kontekst, të dy ekspertët thonë se financimi i partive politike mbetet një nga fushat më të ndjeshme për demokracinë në Kosovë.

Pa transparencë reale, mbikëqyrje institucionale dhe informim të vazhdueshëm të publikut, rreziku i ndikimit të grupeve të interesit mbetet i lartë, thonë ata.

Në raportin e vitit të kaluar të organizatës Transperency International vlerësohej se Kosova ka bërë përparim të lehtë në luftën kundër korrupsionit, ndërsa më 2023, vendi u përmend në raport të Departamentit amerikan të Shtetit për korrupsion qeveritar.

Financimi i partive politike edhe në botë

Financimi i partive politike nga individë nuk është praktikë vetëm e Kosovës.

Në shumicën e demokracive perëndimore, qytetarët kanë të drejtë ligjore t'i mbështesin financiarisht partitë apo kandidatët që përfaqësojnë bindjet e tyre politike.

Në Shtetet e Bashkuara, për shembull, individët mund të japin mijëra dollarë për kandidatët presidencialë, kongresistët apo partitë politike, ndërsa ligji u lejon edhe krijimin e të ashtuquajturave Political Action Committees (PACs), të cilat mund të mbledhin shuma shumë të mëdha për të mbështetur fushatat.

Edhe pse këto struktura janë ligjore, ato janë shpesh objekt kritikash, pasi donatorët e mëdhenj - biznesmenë, korporata apo individë me

ndikim - mund të ushtrojnë presion jodirekt mbi politikat publike.

Në Kosovë, subjektet politike janë të obliguara me ligj që raportin financiar të fushatës ta dorëzojnë në KQZ jo më vonë se 30 ditë pas certifikimit të rezultateve përfundimtare. Sipas ekspertëve, sfida për vendin nuk është ndalimi i donacioneve, por ndërtimi i një sistemi ku çdo euro e dhënë për politikën, është e verifikueshme dhe e arsyetueshme për publikun.

Ky diskutim zhvillohet ndërsa Kosova, për gati një vit, funksionon me institucione në detyrë, pa stabilitet politik dhe pa vendimmarrje të plotë.

Për më tepër, rezultatet e zgjedhjeve të parakohshme të 28 dhjetorit nuk janë certifikuar ende, pasi mospërputhjet serioze në votat për deputetë detyruan KQZ-në të urdhërojë rinumërim të plotë në të gjitha vendvotimet.

Kjo vonesë institucionale ndodh

Si financohen partitë politike?

Partitë në Kosovë financohen nga dy burime kryesore: buxheti i shtetit dhe donatorët, që përfshijnë persona fizikë dhe juridikë.

Financimi publik realizohet përmes Fondit për Mbështetjen e Subjekteve Politike, i cili është rreth pesë milionë euro.

Ndarja bëhet sipas përfaqësimit të partive në Kuvendin e Kosovës, i cili ka 120 ulëse, por, me ligj, ato kanë të drejtë të pranojnë kontribute shtesë për fushatë edhe nga personat fizikë dhe juridikë.

Personat fizikë mund të dhurojnë deri në 2.000 euro në vit, ndërsa personat juridikë deri në 10.000 euro, përfshirë edhe kontribute në mallra dhe shërbime.

Partitë në Kosovë financohen nga dy burime kryesore: buxheti i shtetit dhe donatorët, që përfshijnë persona fizikë dhe juridikë.

Financimi publik realizohet përmes Fondit për Mbështetjen e Subjekteve Politike, i cili është rreth pesë milionë euro.

Ndarja bëhet sipas përfaqësimit të partive në Kuvendin e Kosovës, i cili ka 120 ulëse, por, me ligj, ato kanë të drejtë të pranojnë kontribute shtesë për fushatë edhe nga personat fizikë dhe juridikë.

Personat fizikë mund të dhurojnë deri në 2.000 euro në vit, ndërsa personat juridikë deri në 10.000 euro, përfshirë edhe kontribute në mallra dhe shërbime.

në kohën kur qytetarët përballen me inflacion dhe kosto gjithnjë e më të larta të jetesës. Sipas Agjencisë së Statistikave të

Kosovës, çmimet e konsumit në dhjetor 2025 ishin mesatarisht 5.3% më të larta krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2024.

Kosova thekson rëndësinë e bashkëpunimit me Emiratet e Bashkuara Arabe

PRISHTINË, 26 JANAR - Zëvendësministri i Ekonomisë, Getoar Mjeku, ka pritur në takim të Ngarkuarin me Punë të Ambasadës së Emirateve të Bashkuara Arabe, Yousof Naser Abdulla Albuainain Almazrouei. Gjatë këtij takimi u diskutua për marrëdhëniet dypalëshe ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Emirateve të Bashkuara Arabe, me fokus të veçantë në mundësitë për thellimin e bashkëpunimit ekonomik dhe nxitjen e investimeve strategjike, mbi

potencialin që ofron Kosova për investitorët e huaj, veçanërisht në sektorët prioritarë të ekonomisë dhe energjisë. Zëvendësministri Mjeku theksoi rëndësinë e bashkëpunimit me Emiratet e Bashkuara Arabe, duke vlerësuar interesimin e këtij shteti për investime në Kosovë, si dhe përvojën e tij në zhvillimin e projekteve të qëndrueshme ekonomike dhe energjetike. Ai nënvizoi angazhimin e Qeverisë së Republikës së

Kosovës për krijimin e një klime të favorshme për investime, përmes reformave dhe politikave mbështetëse për investitorët e huaj. Nga ana e tij, Almazrouei shprehu gatishmërinë e Emirateve të Bashkuara Arabe për të vazhduar dhe avancuar bashkëpunimin me Kosovën, duke theksuar interesin për eksplorimin e mundësive konkrete të investimeve, veçanërisht në sektorin e energjisë dhe projekte me ndikim në zhvillimin ekonomik të vendit.



AVDULLAH HOTI THOTË SE DO TË GAROJË PËR KRYETAR TË LDK-SË

PRISHTINË, 26 JANAR - Avdullah Hoti ka bërë me dije se dëshiron ta marrë drejtimin e Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), duke thënë se “ka ardhur koha” për ta kthyer atë në forcën kryesore politike në vend. Hoti, i cili shërbeu shkurtimisht si kryeministër i Kosovës mes viteve 2020 dhe 2021, ka shkruar në “Facebook” të dielën se do ta kërkojë besimin e delegatëve të partisë në Kuvendin e LDK-së më 31 janar. Ai tha se po e bën këtë “pas dorëheqjes së kryetarit Abdixhiku për shkak të rezultatit të fundit zgjedhor”. Kryetari i tanishëm Lumir Abdixhiku pritet ta kërkojë votëbesimin e delegatëve në Kuvendin e 31 janarit, pasi më parë kishte thënë se e ka ofruar dorëheqjen por se do të largohej vetëm nëse Kuvendi i partisë voton për shkarkimin e tij.

Nuk është e qartë nëse Abdixhiku, i cili ka mandat deri më 2027 do ta humbë votëbesimin për t’i hapur rrugë garës për kryetar të partisë. Hoti shkroi se “në këtë moment vendimtar për LDK-në dhe për Kosovën, unë zotohem me përgjegjësi të plotë të marr barrën e ringritjes politike dhe organizative të partisë”. Hoti, 50 vjeç, është pjesë e LDK-së nga viti 2006 dhe, përveç si kryeministër i vendit, në të kaluarën ai ka shërbyer edhe si ministër i Financave i Kosovës. “Zotohem se askush nuk do të mbetet në margjina. Se do të ndërtojmë një LDK të hapur, të drejtë dhe konkurruese. Një LDK ku avancimi bazohet në meritë, integritet dhe përkushtim; ku profesionistët, gratë dhe të rinjtë e gjejnë hapësirën që u takon”, shkroi ai.



Ai u shpreh i bindur se brenda LDK-së potenciali “është shumë më i madh”, duke shtuar se partia duhet ta shfrytëzojë atë për t’u kthyer në “forcën politike kryesore në Republikën e Kosovës, në shërbim të qytetarëve dhe të interesit shtetëror”. LDK-ja caktoi Kuvendin e partisë për 31 janar pas një

mbledhjeje të Kryesisë javën e kaluar, ku anëtarët diskutuan për rezultatin dëshpërues në zgjedhjet e parakohshme parlamentare të 28 dhjetorit. LDK-ja, partia më e vjetër në Kosovë, është duke përjetuar një ndër periudhat më të vështira në historinë e vet, pasi zgjedhjet e dhjetorit sollën rezultatin e dytë më të

keq për të. Disa anëtarë të partisë, përfshirë Hotin dhe Hykmete Bajramin - e cila dha dorëheqje të parevokueshme nga pozita e nënkryetares të partisë - kërkuar largimin e Abdixhikut, pasi LDK-ja doli e treta duke i fituar vetëm rreth 13 për qind të votave. Pas mbledhjes së Kryesisë javën e kaluar, zyrtari i LDK-së Besian Mustafa nuk konfirmoi se do të kishte garë për kryetar të partisë në Kuvendin e 31 janarit. Duke folur në një konferencë për media, Mustafa tha se “duhet të ketë një proces tjetër për të ardhur deri të kandidaturat e tjera për të pasur një proces zgjedhor në LDK”. “Tani jemi të pjesa e votëbesimit. Do ta shohim rezultatin e votëbesimit së pari”, tha Mustafa.

PROKURORIA THEMELORE NË PRISHTINË AUTORIZON POLICINË LIDHUR ME PROCESIN E NUMËRIMIT NË DRENAS



PRISHTINË, 26 JANAR - Prokuroria Themelore në Prishtinë, Departamenti i Krimeve të Rënda, duke përcjellë në vazhdimësi procesin e rinumërimit të votave për zgjedhjet e përgjithshme të mbajtura më 28 dhjetor, ka vërejtur mospërputhje lidhur me rezultatet e kandidatëve për deputet pas përfundimit të procesit të rinumërimit në komunën e Drenasit. Marrë parasysh këtë rrethanë

prokurori i shtetit sot ka lëshuar autorizim Policisë së Kosovës me qëllim të grumbullimit të informatave dhe evidentimit të shkeljeve të mundshme nga personat përgjegjës si dhe sigurimin e provave lidhur me këtë çështje. Po ashtu, prokurori i shtetit është duke përcjellë nga afër procesin e rinumërimit edhe në komunat e tjera që bien në kompetencë të kësaj prokurorie, ndërsa pas

përfundimit të këtij procesi do të analizohen të gjitha rrethanat dhe shqyrtohet mundësia e lëshimit të autorizimeve të tjera për grumbullimin e informatave. Prokuroria Themelore në Prishtinë është e determinuar në luftimin e dukurive negative në Republikën e Kosovës, veçanërisht me rastet që kanë të bëjnë me mbrojtjen e vullnetit të qytetarëve të shprehur përmes votës së lirë.

‘Nuk po rrënon bageri, po rrënon kryetari Faton Peci’

MITROVICË, 26 JANAR - Kryetari i Mitrovicës, Faton Peci, ka njoftuar se të dielën gjatë orëve të vona të natës, kompanisë që ishte përgjegjëse për rrënimin dhe largimin e objekteve pa leje, i është djegur një mekanizëm/bager. Ai e ka dënuar ashpër këtë akt makabër e qyqar. “Ky veprim

kriminal përbën kërcënim direkt për të gjithë ata që angazhohen që Mitrovica të jetë qytet ku mbretëron rendi dhe qetësia publike. Por, të gjithë ata që me akte të tilla kriminale e kërcënuese mendojnë se na frikësojnë e kanë gabim. Lufta jonë ndaj paligjshmërisë, kriminalitetit e parregullsisë nuk do të

ndalet. Në anën tjetër, organeve të rendit ju bëj thirrje të intensifikojnë veprimet e tyre për zbardhjen sa më të shpejtë të rastit. E për të gjithë ata me këtë logjikë dua t’i siguroj se paqe me krimin nuk do të ketë asnjëherë, askund në Mitrovicë, as në jug as në veri”, ka shkruar Peci në “Facebook”.



LDK-ja të shtunën mban Kuvendin Zgjedhor, Abdixhiku: Koha të flasë anëtarësia

PRISHTINË, 26 JANAR - Kryetari i LDK-së, Lumir Abdixhiku, ka bërë me dije se partia do të mblidhet këtë të shtunë për të diskutuar dhe vendosur mbi çështjet e brendshme, duke vënë theksin te procesi demokratik dhe pjesëmarrja e lirë e anëtarësisë. Abdixhiku ka theksuar rëndësinë e hapjes dhe debatit brenda partisë. “LDK nuk është parti që frikësohet nga anëtarësia e vet, as nga vota, as nga gara. Vendimet e saj i ka marrë gjithmonë në Kuvend, mes njerëzve të vet, hapur, me

debat dhe pa frikë; dhe në fund, me shumicë. Edhe në kohë shumë më të vështira se kjo”, ka shkruar Abdixhiku në “Facebook”. Ai ka sqaruar se procesi i së shtunës do të jetë në frymën e respektimit të anëtarësisë dhe pa ndikime të jashtme. “Këtë të shtunë mblidhemi për të diskutuar dhe për të vendosur mbi të gjitha çështjet tona, me vullnet të lirë dhe me votë të lirë, ashtu siç i takon një partie demokratike që respekton anëtarësinë e saj dhe asnjë interes tjetër veç saj. Ky është

parimi ynë dhe mënyra jonë e veprimit. LDK nuk di ndryshe”, u shpreh Abdixhiku. Kreu i LDK-së ka bërë thirrje për pjesëmarrje aktive dhe ka theksuar se nga ky proces partia do të dalë më e fortë. “Koha tani të flasë anëtarësia jonë. Nga ky proces do të dalim më të fortë, më të organizuar, më funksional e më të përqendruar te e ardhmja e LDK-së dhe e Kosovës”, ka shkruar ai. Abdixhiku ka konfirmuar gjithashtu se ftesat zyrtare për delegatët e partisë janë



dërguar. “Sot kam dërguar për të vendosur drejtimin e ftesën zyrtare për delegatët e shtëpisë sonë”, u shpreh LDK-së. Të shtunën takohemi Abdixhiku.

ISH-KANDIDATË PËR ASAMBLISTË NË FERIZAJ KËRKOJNË HETIM TË REZULTATIT TË ZGJEDHJEVE LOKALE

PRISHTINË, 26 JANAR - Tridhjetë e tre ish-kandidatë për Kuvendin Komunal të Ferizajt i janë drejtuar Prokurorisë Themelore në këtë komunë duke kërkuar zgjerim të hetimeve lidhur me rezultatin zgjedhor të zgjedhjeve lokale të 12 tetorit. Ndërkaq, nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve kanë kërkuar masa të jashtëzakonshme verifikuese. Megjithatë, KQZ-ja ka certifikuar rezultate për këto zgjedhje dhe ka asgjësuar materialin zgjedhor. Bashkim Fazliu, që garoi i pavarur për Kuvendin Komunal të Ferizajt, tha se po kërkojnë zgjerim të hetimeve, pasi dyshon se ka pasur manipulim të rezultateve zgjedhore, njësoj sikurse është vërejtur edhe për zgjedhjet e përgjithshme të 28 dhjetorit sa iu përket votave për kandidatë për deputetë. “Kërkesën e parë e kemi dorëzuar te Prokuroria Themelore në Ferizaj dhe për dijeni do t’ia dërgojmë edhe Laura Pulës, koordinatorë nacionale për zgjedhje. Në prokurori kemi bërë kërkesë për zgjerim të hetimeve që janë duke u bërë për 28 dhjetorin pasi është natyra e njëjtë, janë komisionarët pothuajse të njëjtë”, tha ai, duke shtuar se ekziston dyshimi se komisionarët mund të kenë keqpërdorur votat edhe për votimet e 12 tetorit. Me urdhër të Prokurorisë Themelore të Prizrenit javën e kaluar u ndaluan 109 persona,



nën dyshimet për keqpërdorime të rezultatit zgjedhor të 28 dhjetorit. Ndaj 23 prej tyre është caktuar masa e paraburgimit prej një muaji. Ndonëse në Prizren manipulimi vlerësohet se ishte në shkallë më të lartë, edhe në Ferizaj dhe Malishevë kanë nisur hetimet për keqpërdorim të mundshëm të rezultatit zgjedhor.

Fazliu tha për mediet se nga KQZ-ja është kërkuar ndërmarrja e masave të jashtëzakonshme verifikuese “pas daljes në pah të provave të reja të keqpërdorimeve dhe manipulimeve që kanë ndodhur më 28 dhjetor”. “Ne KQZ-së i kemi kërkuar ndërmarrjen e masave të jashtëzakonshme verifikuese, pastaj një ndër kërkesat është

edhe rinumërimi i fletëvotimeve. Nëse del rezultati i njëjtë për hair ju qoftë, nëse nuk del rezultati i njëjtë kërkojmë anulimin e certifikimit”, tha ai, duke shtuar se për dallim nga zgjedhjet e përgjithshme, për ato lokale edhe një votë përcakton se kush hyn në Kuvend Komunal, e kush jo. Fazliu tha se nuk ka parë

informacion që për zgjedhjet lokale, rezultati i të cilave u certifikuan në fillim të dhjetorit 2025, është asgjësuar materiali zgjedhor. Megjithatë, zëdhënësi i KQZ-së, Valmir Elezi, tha se në përputhje me ligjin, materiali zgjedhor për zgjedhjet lokale të tetorit është asgjësuar. Ligji parasheh që materiali zgjedhor të shkatërrohet brenda 60 ditësh, pas certifikimit të rezultatit zgjedhor, veç nëse Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia vendos ndryshe. Elezi nga KQZ tha se në procesin e shkatërrimit të materialeve janë përjashtuar ato për të cilat Prokuroria e Shtetit dhe gjykatat “janë duke i trajtuar”. Radio Evropa e Lirë iu drejtua Prokurorisë së Shtetit me pyetjen nëse në mesin e pyetjeve që mund të jenë duke u trajtuar ka edhe nga komuna e Ferizajt, por ajo ridrejtoi pyetjet për Prokurorinë Themelore në Ferizaj. Nga organi ndjekës në Ferizaj ende nuk kanë kthyer përgjigje. Ndryshe, për shkak të mospërputhjeve të vërejtura te votat e kandidatëve për deputetë, më 19 janar KQZ-ja vendosi rinumërim të plotë të votave të rregullta. Rinumërimi pritët ta shtyjë edhe më shumë formimin e institucioneve të reja të Kosovës të dala nga zgjedhjet e 28 dhjetorit.

‘Shqipëria dhe Kosova ecin së bashku, përgjegjësia ndaj kombit tonë’

PRISHTINË, 26 JANAR - Kryetari i PDK-së, Bedri Hamza, ka pritur në takim ambasadorin e Shqipërisë, Petrit Malaj, me të cilin ka diskutuar për forcimin e lidhjeve

kombëtare dhe bashkëpunimin në mes të Kosovës dhe Shqipërisë. “Bashkëbisedim i hapur me ambasadorin Petrit Malaj për forcimin e lidhjeve kombëtare dhe bashkëpunimin

mes Kosovës dhe Shqipërisë. Marrëdhëniet tona shkojnë përtej diplomacisë. Ato janë vëllazëri, histori dhe një e ardhme e përbashkët.

Shqipëria dhe Kosova ecin së bashku, të lidhura ngushtë nga vlerat dhe përgjegjësia ndaj kombit tonë”, ka shkruar Hamza në “Facebook”.



TRANSPORTUESIT RAJONALË BLOKOJNË KUFIJTË ME BE-NË, KOSOVA NË VËSHTIRËSI

Kompanitë e transportit nga disa vende të Ballkanit Perëndimor bllokuan pikat kufitare drejt BE-së, si reagim ndaj sistemit të ri elektronik të hyrje-daljeve (EES). Bllokadat ndikojnë në eksportet dhe importet e Kosovës, që përfshijnë mbi 20 milionë euro mallra në ditë, dhe mund të shkaktojnë probleme në zinxhirin e furnizimit dhe kosto shtesë për kompanitë

PRISHTINË, 26 JANAR - Transportues nga Serbia, Maqedonia e Veriut, Bosnje e Hercegovina dhe Mali i Zi, nga mesdita e 26 janarit, bllokuan pikat kufitare për qarkullimin e mallrave drejt zonës Schengen të Bashkimit Evropian. Ky veprim është reagim ndaj sistemit të ri të BE-së për kontrollin e hyrje-daljeve, të cilin ata e konsiderojnë shkak për dëbime, vonesa dhe humbje ekonomike, dhe kërkojnë që kompanitë e transportit të përjashtohen nga zbatimi i tij. Transportuesit njoftuan se bllokadat do të zgjasin shtatë ditë, nëse gjatë kësaj kohe nuk gjendet zgjidhje për problemin e tyre.

Çka është sistemi EES?

I njohur si EES (Entry/Exit System), ky sistem u vendos në kufijtë e jashtëm të zonës Schengen dhe nisi të zbatohet gradualisht më 12 tetor 2025. Ai pritet të jetë plotësisht funksional deri më 10 prill 2026. Rregulli i ashtuquajtur “90/180 ditë” parasheh që transportuesit nga vendet jashtë Schengenit mund të qëndrojnë në këtë zonë maksimumi 90 ditë brenda një periudhe prej 180 ditësh. Si importuese e shumë mallrave përmes Serbisë dhe Maqedonisë së Veriut, Kosova pritet të ndjejë pasojat e protestave në qarkullimin e mjeteve të transportit. Qendra Kombëtare për Menaxhim të Kufirit njoftoi se, sipas informacionit të pranuar nga zyrtarët kufitarë të Serbisë, “do të ketë ndërprerje të qarkullimit të kamionëve në të gjitha pikat kufitare me Serbinë”. “Këto protesta ndikojnë në qarkullimin e mjeteve të transportit dhe mallrave, si dhe mbingarkojnë trafikun në zonat kufitare të Republikës së Kosovës me vendet e rajonit, që janë të përfshira në protesta”, thuhet në njoftim. Qendra Kombëtare për Menaxhim të Kufirit paralajmëroi se bllokadë të ngjashme do të ketë edhe nga Mali i Zi. Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës (OEK), Lulzim Rafuna, njëherësh udhëheqës i Odave Ekonomike të Ballkanit Perëndimor, thotë se Kosova nuk merr pjesë në protestë, pasi vendi nuk ka ende kompani

logjistike që realizojnë transport të rregullt me vendet e BE-së. Por, paralajmëron se efektet e saj do të ndihen edhe në Kosovë. “Për shkak të bllokadës së kufijve, Kosova nuk do të mund as të eksportojë dhe as të importojë mallra”, thotë Rafuna për Radion Evropa e Lirë. Sipas të dhënave të Doganës së Kosovës për vitin e kaluar, vendi ka importuar produkte në vlerë prej mbi 7 miliardë eurosh në total, ose rreth 20 milionë euro në ditë - një sasi të madhe të tyre përmes Serbisë dhe Maqedonisë së Veriut. Vlera e eksporteve, ndërkaq, ishte rreth 942 milionë euro vitin e kaluar, apo rreth 2.6 milionë euro në ditë. Në përpjekje për të gjetur një zgjidhje, Rafuna thotë se gjashtë Odat Ekonomike të Ballkanit Perëndimor i kanë dërguar një shkresë presidentes së Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen. Në letrën që siguroi Radio Evropa e Lirë dhe që mban datën e 20 janarit, kërkohet që të gjendet një zgjidhje e qëndrueshme për këtë çështje. “Zhvillimet e pritshme si pasojë e këtyre masave, janë shqetësuese dhe mund të shndërrohen në një sfidë sistematike ekonomike dhe politike për rajonin”, thuhet në letër. Sipas Rafunës, sistemi i ri ka detyruar kompani në Ballkanin Perëndimor që, çdo tre muaj, të punësojnë shoferë të rinj. “Ky është problem i madh, sepse ka mungesë të tyre... dhe kjo komplet e çrregullon zinxhirin e furnizimit”, thotë ai. Nënkryetari i Shoqatës së Transportuesve të Mallrave nga Kosova, Besnik Aliu, thotë për Radion Evropa e Lirë se transportuesit në Kosovë përballen me sfida të ngjashme me kolegët e tyre në rajon, për shkak të sistemit EES. Sipas tij, edhe pse në Kosovë janë të licencuar rreth 2.000 kamionë për transport mallrash, sektori mbetet i dobët në transportin ndërkombëtar, pasi shumica e importeve dhe eksporteve realizohen nga kompani të rajonit dhe BE-së. “Nuk është e lehtë të gesh shoferë për tregun e BE-së, sikurse gjenden për transportin brenda Kosovës apo në rajon”, thotë ai. Duke folur për Radion Evropa e Lirë, Sasho Ilievski, pronar i kompanisë “Stema Transport” në



Shkup, thotë se nuk preket drejtpërdrejt nga rregullat e reja - pasi kamionët e tij udhëtojnë drejt shteteve më të afërta të BE-së - por shton se ai do t'i mbështesë kolegët në protestë. “Udhëtimet tona zhvillohen kryesisht në Austri, Sllovaki, Republikën Çeke dhe Hungari. Për çdo udhëtim, qëndrojmë maksimumi katër deri në pesë ditë”, thotë ai. “Megjithatë, ka kompani që operojnë më thellë brenda BE-së... që hyjnë në Suedi, Norvegji, Portugali. Për një udhëtim, ato kalojnë 15 deri në 20 ditë brenda BE-së. Kur kthehen, nuk u lejohet të hyjnë përsëri gjatë atij muaji. E, nëse nuk udhëtojnë sërish, kompania dhe biznesi humbasin, pasi shoferët nuk mund t'i përmbushin detyrimet e tyre profesionale brenda asaj kohe. Ata nuk janë turistë, janë shoferë profesionistë dhe duhet t'u lejohet të qëndrojnë më gjatë”, shton Ilievski. Para se të hynte në fuqi sistemi elektronik, EES, transportuesit maqedonas nuk kishin probleme, edhe pse rregulli i 90 ditëve për qëndrimin në zonën Schengen ishte në fuqi. Doganierët vulosnin pasaportat, por nuk numëronin ditët dhe shpesh i “shikonin përmes gishtave”, thotë Ilievski. Por, që nga fillimi i funksionimit të sistemit elektronik të BE-së, qëndrimet në zonën Schengen monitorohen më rreptë. Kompjuteri me të dhëna biometrike përmbledh saktë të gjitha ditët - nga koha e kaluar në udhëtim, pushimet në parkime e deri te pritjet në kufi. “Të gjithë ata që udhëtojnë më thellë brenda Bashkimit Evropian, do të qëndrojnë më shumë ditë. Kjo i prek rreth 70 për qind të kompanive në vend. Kolegët në Suedi, për shembull, nuk mund të kthehen shpejt... Shoferi e drejton automjetin për 9 orë në ditë dhe pastaj duhet të pushojë. Pushimi që merr është brenda BE-së dhe konsiderohet po ashtu qëndrim, edhe pse ai nuk po punon”, thotë Ilievski. “Prandaj, ne kërkojmë nga BE-ja që t'i përjashtojë kompanitë e transportit. Shoferëve ose duhet

t'u zgjatet qëndrimi, ose të llogariten vetëm orët e tyre të punës”, sipas tij. Transportuesit maqedonas do të bllokojnë dhjetë pika kufitare - në kufi me Bullgarinë, në kufi me Greqinë, në kufi me Shqipërinë dhe në kufi me Kosovën. Pika kufitare Tabanovc nuk do të bllokohet nga maqedonasit, por nga transportuesit serbë në anën e tyre të kufirit, që tashmë i kanë bllokuar edhe pikat e tjera. Bllokadat aplikohen vetëm për trafikun e mallrave, duke mbyllur korsitë dhe terminalët për kamionët, ndërsa makinat e zakonshme, autobusët dhe trafiku i pasagjerëve do të lëvizin pa pengesa. Në Maqedoninë e Veriut, mobilizimi për bllokadat u organizua nga “Makam-Trans” - shoqata më e madhe e punëdhënësve të kompanive të transportit në këtë vend. Bilana Muratovska, sekretare e përgjithshme e “Makam-Trans”, thotë se shoferët maqedonas, sikurse edhe të tjerët në rajon, përballen me rrezikun e dëbimit pas qëndrimit 90-ditor në zonën Schengen. Më herët, Konsorciumi i Logjistikës i Bosnje dhe Hercegovinës njoftoi se 100 shoferë profesionalë janë kthyer me forcë nga vendet e BE-së, ndërsa 47 shoferë kanë humbur punën për shkak të problemeve me qëndrimin në këto vende. “Ne kemi raste të tilla. Nuk kam një numër të saktë, por duhet bërë një dallim... për shembull, flota e transportit në Bosnje e Hercegovinë dhe në Serbi është shumë më e madhe se e jona”, thotë Muratovska. Ajo shton se dëmet për kompanitë janë të mëdha dhe shkaktojnë shpenzime shtesë. “Kur i llogarisim kostot që na shkaktojnë - sepse mjeti lihet në një parking plot me mallra, që mund të jetë shumë i shtrenjtë dhe pa mbrojtje, dhe ne nuk e dimë se çfarë do t'u ndodhë shoferëve - situata bëhet e vështirë. Shoferët dëbohen me avion, sepse nuk kanë ditë të mjaftueshme për t'u kthyer me

autobus ose me kolegët e tyre. Këto kosto i mbajnë transportuesit”, shpjegon Muratovska. BE: Asgjë nuk ka ndryshuar me rregullat e Schengenit Sistemi EES nuk vendos asnjë kërkesë të re për qëndrimet e shkurtra në zonën Schengen, tha zëdhënësi për Çështjet e Brendshme të Komisionit Evropian, Markus Lammert, më 19 janar, në përgjigje të pretendimeve të shoqatave të transportit nga Ballkani Perëndimor se sistemi i ri po i lë punëtorët dhe shoferët pa punë. “EES siguron zbatim më të mirë të rregullave ekzistuese dhe zbulim sistematik të parregullsive”, tha Lammert, duke theksuar se Komisioni Evropian po ndjek nga afër çështjen e njoftimeve për bllokada nga transportuesit. “Sipas rregullave, shtetasit e vendeve të treta pa vizë kanë të drejtë të qëndrojnë në zonën Schengen për gjithsej 90 ditë brenda çdo periudhe 180-ditore. Çdo ditë që e tejkalon këtë, duhet të mbulohet me vizë afatgjate ose leje të lëshuar nga një shtet anëtar”, shtoi Lammert. Por, sipas Muratovskës, edhe pse BE-ja thotë se rregulli i qëndrimit 90-ditor brenda 180 ditëve nuk ka ndryshuar, rrethanat kanë ndryshuar. “Të gjitha shtetet anëtare të Bashkimit Evropian tashmë janë në zonën Schengen - plus dy vende që nuk janë anëtare të BE-së, Norvegjia dhe Zvicra. Tani, pa marrë parasysh se si largohesh nga vendi, menjëherë hyn në zonën Schengen. Ndaj, pretendimet se situata është e njëjtë si më parë, janë fyerje për inteligjencën”, thotë Muratovska. Qeveria maqedonase u doli në mbrojtje transportuesve të vendit. Ministri i Transportit, Aleksandar Nikolovski, tha se e kupton revoltën dhe propozoi që problemi të zgjidhet ose duke shtyrë sistemin elektronik për shoferët profesionistë, ose duke u dhënë atyre mundësinë të marrin viza pune.

BLLACA '99

NË KOHË LUFTE DHE NË KOHË PAQEJE



Shkruan: Fatmir **KRASNIQI**

Vitet 1998-1999 përbëjnë një nga periudhat më të veçanta për historinë më të re të Kosovës, ngase ngjau çlirimi i saj nga pushtimi shekullor serb. Pas Luftës heroike të Prekazit e Masakrës së Drenicës, UÇK-ja (Ushtria e Lavdishme dhe e Pathyeshme Çlirimtare e Kosovës) zhvillonte luftë frontale për jetë a vdekje kundër forcave pushtuese të Serbisë. UÇK-ja është vepër epokale e popullit shqiptar të Kosovës, që lindi në zjarrin e luftës së tij për mbrojtjen e jetës, të lirisë dhe të drejtave njerëzore e kombëtare nga shtypja, sundimi e regjimi i egër serb. Gjatë muajit mars 1998, në shtëpinë time, ku banoja në Lagjen e Spitalit në Prishtinë, tani e njohur si Rruga “Muharrem Fejza”, erdhën për të biseduar Afrimi, djali i axhës tim, së bashku me Kadri Krasniqin, kontribuues për UÇK-në, që ishin të angazhuar rreth logistikës për Zonën Operative të Pashtrikut, Njësi të “Çeliku”, që vepronte në Kleçkë e në Malet e njohura të Berishës, rreth mundësisë që në shtëpinë time njëkatëshe të kenë të siguruar një Pikë logjistike. Dëshira për të kontribuar e mbështetur UÇK-në, ish-nxënësit e mi trima e luftëtarë të dalluar e sypatrembur, si dhe bashkëvendësit e mi të dashur, ishte e madhe. Në oborr vinin kamioneta që zbarkonin e grumbullonin gjëra ushqimore e veshmbathje për t’i shpërndarë e dërguar në Malet e Berishës. Shpesh ndodhte që djali i axhës, Bajrami, avokat i njohur, atdhetar, veprimtar i palodhshëm e guximtar së bashku me Sylejman Ahmetin, po ashtu një atdhetar e veprimtar i shquar, vinin me veturë dhe ngarkonin materiale të nevojshme për luftë e niseshin drejt Berishës me shumë rreziqe, fljime e të papritura. Nganjëherë më merrnin edhe mua në Tërpezë, si dhe djalin tim Nolin, që ishte në klasën e parë në Shkollën fillore “Hasan Prishtina”, në Prishtinë. Nolit iu pat ngulitur një kujtim i paharruar, kur me një rast, duke shkuar për në Berishë, disa ushtarë i dhanë dredhëza. Ai, kur shkoi në shkollë, nga gëzimi e me shumë

emocione, i thotë mësueses se UÇK-ja i kishin dhënë dredhëza. Në të njëjtën kohë ngritët në këmbë shoku i tij klasës, Galdimi, duke iu drejtuar mësueses Antigone: “Edhe babai im është në UÇK...!” (është fjala për Ramë Bujën). Mësuesja me shumë vëmendje i dëgjon e me shumë kujdes i tejkalon emocionet e rrëfimet e Nolit e të Galdimit. Kur dihej se, në atë kohë ende kishte mëdyshje tek disa individë në Prishtinë, se ka apo nuk ka UÇK?! Dihej publikisht se Malisheva ishte Zonë e Lirë, e vetmja në Kosovë, në muajt maj-korrik 1998. Malisheva ishte dhe është zemra e Kosovës, ku Ushtria Çlirimtare e Kosovës arriti ta çlironte Malishevën gjatë këtyre muajve. Shpeshherë fqinjët ishin shumë kureshtarë dhe i pyesnin fëmijët e mi: Albulenën, Tringën e Nolin se përse po vinin këto kamioneta në oborrin tuaj?!... Fëmijëve u pata thënë se Afrimi, pra djali i axhës tim, e ka një shitore në Malishevë. Dhe, fëmijët sa herë që i pyesnin ua kthenin këtë përgjigje. Përveç Naimes, bashkëshortes sime, si dhe motrës së saj, Bahries dhe Mustafës – bashkëshortit a mjeshtakut tim, që i kishim shtëpitë në një oborr të përbashkët, askush tjetër nuk e dinte se në shtëpinë tonë ishte Pika logjistike e UÇK-së.

I mbijetuari i luftës – “Terroristi i vogël”

Tërpeza e Malishevës ishte bërë fortifikatë dhe qendër e rezistencës ndaj forcave policore, ushtarake e paraushtarake, dhe në pamundësi për të depërtuar në Malet e Berishës, ku edhe kryekrimineli Sheshel ëndërronte e shpresonte se aty do të pinte kafe, por që nuk iu realizua e as nuk iu mundësua, ngase aty qëndronin ushtarët trima, duke rezistuar e qëndruar të pamposhtur e duke luftuar ballë për ballë me forcat serbe. Forcat serbe ishin përqendruar e pozicionuar në Smanicë të Tërpezës, ku të tmerruar kishin filluar me granatime të ashpra e të shtëna nga të gjitha anët. Granatimet kishin filluar, më 19.4.1998, rreth orës 17:15 e që kishin vazhduar gjatë tërë natës, ku ishin dëgjuar të shtëna nga armë të ndryshme. Çak i granatimeve në fshatin Tërpezë, nuk ishin vetëm shtëpitë, por edhe Shkolla fillore “Hasan Prishtina”, ambulanca dhe tendat plastmase në të cilat ishte strehuar një pjesë e madhe e popullsisë edhe nga fshatra të

tjera. Aty gjatë këtyre granatimeve u plagosën nënë e bir, Shpresa Krasniqi dhe djali i saj, Albioni, gjashtëmuajsh. Pikërisht në ditën kur u plagos Albioni, ai kishte mbushur gjashtë muaj jetë. Albioni u lind, më 19.4.1998 dhe u plagos, më 19.10.1998. Shpresa, me shumë emocione e ndjenja të përziera, tregon për ngjarjen e rëndë, që veç fati i ka shpëtuar, se ka mundur të shndërrohej në tragjedi të paparë. Shpërthimi i granatave ishte i tmerrshëm, saqë para nesh lopët e Ahmet Imerit, u qëlluan duke rënë përtoke. Për fatin e tij, për pak nga granatimi kishte shpëtuar Hamit Dobruna, mik i familjes sonë, profesor i shquar, veprimtar i dalluar, i përndjekur dhe i burgosur politik, tani i ndjerë që kishte qëlluar afër tyre. Shpresa, në ato çaste, kishte menduar si ta mbronte e shpëtonte Albionin, duke mbuluar me tërë trupin e saj si mburojë, ku dorën e gishtin e saj e kishte goditur një cifël e shpërndarë e granatës, ku papritmas kishte ndjerë një therje e dhimbje të papërballueshme, por që mendjen e kishte vetëm te djali i saj i shtrenjtë gjashtëmuajsh, se si ta mbronte e shpëtonte, duke treguar heroizëm të paparë. Megjithatë, përkundër përpjekjeve të saj mbinjerëzore, e njëjta cifël kishte depërtuar dhe e kishte qëlluar Albionin në pjesën e prapme të krahavorit. Kjo cifël granate edhe tashmë qëndron në trupin e Albionit 27 vjeçar, si dëshmi e luftës, por që nuk paraqet rrezik, i kanë thënë mjekët. Albioni, megjithatë, ka shëndet të plotë. Ai është shumë

i dashur e simpatik. Në ditën kur u plagosën, ai së bashku me nënë Shpresën, ishin në gjendje shumë të rëndë, ndërkohë që nuk iu kishte lejuar dërgimi i tyre në spital. Për këtë ngjarje të rëndë kishte njoftuar edhe Radio “Dojçe Vele”. Vendi ku ishin plagosur njihej si Rrëza e Mullinit, luginë e bukur me një përrua që rrjedh nga një krrua, rrëzë rrënjëve të një ahu, i njohur si Vrella e Tërpezës. Në këtë luginë, të rrethuar me lisa ahu, ishin strehuar banorët e Tërpezës dhe shumë fshatrave të tjerë. Gjendja shëndetësore e Albionit po përkeqësohej, ngase gjakderdhja nuk po i ndalej, rrëfen Shpresa. - Edhe, unë kisha gjakderdhje, por shqetësimin, brengën e mendjen e kisha tek djali. Shaip Dobruna, që ishte i strehuar në Tërpezë, ua kishte ofruar veturën, ku Tomorri – nipi i tij së bashku me Jetishin, axhën e Albionit, Baliun, babain e të plagosurit, Shpresën e Albionin, ishin nisur me shpejtësi, nën breshërinë e të shtënave drejt Fshatit të Ri, ku ishte ambulanca. Aty iu kishte dhënë ndihma e parë, por gjakderdhja Albionit nuk i ndalej. Me të njëjtën veturë, por drejtues ishte një nip Tërpeze, djali i Sabrijes, nga Çikatova, Shemi. Ata ishin nisur drejt fshatit Shalë, ku ishte Spitali Usharak. Doktor Fitimi kishte bërë të pamundurën për ta mjekuar, por që Albioni kishte nevojë për serum. Një shofer autobusi nga Shala kishte shkuar në Prishtinë, duke ia siguruar e sjell serumin në Shalë, e që atë natë kishin bërë konak te një familje shumë bujare, te Sanija, vajza e dajës

Selman Gashi, nga Nekoci, që ishte e martuar në Shalë. Shpresa, falënderon me mirënjohje më të thellë këtë familje për të gjitha! Të nesërmen ishin nisur me autobus, që bartte vetëm gra për në Prishtinë. Në autobus ishte edhe Kushtrim Berisha, nga Prishtina, që kthehej nga Berisha, ku kishte qëndruar e kontribuar si ushtar e përkthyes në Malet e Berishës, e në Shtabin e Kleçkës. Kushtrimi i kishte thënë Shpresës të mos shqetësohej se sapo të mbërrinin në Prishtinë, po i priste nëna e tij. Për befasi, me nënën e Kushtrimit, Sheribanen, punonim së bashku në Shkollën fillore “Elena Gjika”. Kushtrimi është djali i profesorit të shquar të historisë, Sahit Berishës, të burgosurit politik e veprimtar i dalluar. Me të mbërrirë në Prishtinë, Shpresa u drejtohet Sheribanes e Kushtrimit: “Mua më duhet për të shkuar në Lagjen e Spitalit, se aty e ka shtëpinë kushëriri i burrit, Fatmir Krasniqi, është arsimtar!”. Sheribanja i drejtohet Shpresës: “Mos u shqetëso, se me Fatmirin punojmë bashkë dhe deri në shtëpinë e tij të dërgojmë ne!”. Dhe, me të mbërritur në shtëpinë tonë, u del përpara Naimja, bashkëshortja ime, që me profesion është infermiere, e cila deri në pension ka punuar në Klinikën e ORL-së, në Prishtinë. Ajo i pret me përzemërsi. Shpresa, ende pa hyrë brenda, e njofton Naimen se Albioni është i plagosur, e po ashtu e plagosur ishte edhe ajo. Naimja, menjëherë intervenon në pastrimin e plagëve, por që gjakderdhja Albionit nuk po i



ndalej. Pasi u ktheva nga shkolla, mbeta i shtangur kur pashë Albionin, të plagosur, por edhe Shpresën me plagë në duar. Menjëherë iu drejtova Mustafës, mjeshtakut (baxhanakut), që me veturën e tij të na dërgojë në Ambulancën “Nënë Tereza”, në Kodrën e Trimave.

Mjeku, siç dukej e kishte paksa të paqartë se ku ta dërgonim?!... Dihet, se në atë kohë spitalet dhe shtëpitë e shëndetit administroheshin nën masa të dhunshme.

Vendosëm t’u drejtohem i urologëve të shquar Dr. Lutfi Dërvishit e Dr. Tunë Pervorfit, që punonin në një ambulancë private në “Dardani”. Ata na pritën shumë mirë, edhe pse plagët e Albionit, rasti i tij, nuk kishte të bënte me fushën e tyre të ngushtë të mjekësisë.

Megjithatë, të dy mjekët e kontrolluan me shumë kujdes Albionin, ku na udhëzuan për një rëntgen, që gjendej afër tyre. Dhe, pas shikimit, mjekët konstatuan se një cifël e granatës ishte në pjesën e prapme të krahavorit të Albionit. Në fakt, ata gjatë kontrollimit, veç e vërejtën dhe dyshuan për një mjet shpërthyes në trupin e vogëlushit.

Na thanë e na udhëzuan se përkundër gjendjes së krijuar në spitalin shtetëror, sa më urgjentisht ta dërgonim në Klinikën Torakale. Pas shumë përpjekjesh e mundimesh arritëm që Albionin ta kontrollonim në Klinikën Torakale. Sinqerisht e me shumë përgjegjësi e them se atje nuk u trajtua siç duhej një foshnjë gjashtëmuajshe?!

Jo që nuk e pati përkujdesjen e trajtimit të duhur human, por Albioni, nga personeli serb i Klinikës Torakale e mori epitelin a nofkën e parë “Terroristi i vogël”, edhe pse ishte foshnjë gjashtëmuajshe? “Terroristi i vogël”, ishte nga fshati Tërpezë e Malishevës, që nga serbët konsiderohej Zonë e luftës dhe shumë e rrezikshme.

Nga Klinika u larguam, unë së bashku me Shpresën, ku e bartnim Albionin në qafë e mbi supe, kur e dërguam disa herë për kontrollë mjekësore te mjeku i njohur për fëmijë Dr. Fazli Mekuli, që ordinancën e kishte afër Shkollës fillore “Gjergj Fishta” në Prishtinë. Me të parë gjendjen e Albionit që po i përkeqësohej, ngase nuk kishte shenja përmirësimi, Dr. Mekuli na këshilloi e na udhëzoi që të angazhohemi për t’i siguruar sasi gjaku, në të kundërtën gjendja shëndetësore e tij mund të rrezikohej, pasi që kishte humbur shumë gjak...

Naimja, meqë punonte në spital, shkon dhe bisedon me Dr. Remzije Kocin, pediatre, në Spitalin Pedriatik të Fëmijëve, duke e njoftuar për rastin dhe gjendjen e rëndë shëndetësore të Albionit.

Ajo i thotë Naimes: “Po

rrezikojmë dhe po e pranojmë, ku do ta trajtojmë me një “diagnozë tjetër”, për të mos e kuptuar personeli serb i klinikës se Albioni është i plagosur!”. Beteja tjetër ishte se si t’i sigurohej sasia e gjakut. Së bashku me Naimen, biseduam me fqinjin tonë, Haki Buçanin, teknik laborant i njohur, duke e njoftuar në hollësi për rastin.

Hakiu, me përkushtimin dhe humanizmin e paparë, u zotua se sasinë e gjakut do ta siguronte dhe se do t’ua sjellte në pediatri, ku ishte i shtrirë Albioni. Hakiu bisedon me Dr. Bukurijshe, që punonte në Transfuzion të Gjakut, ku këta të dy së bashku me Naimen dhe personelin tjetër të transfuzionit, nuk u frikësuan dhe urgjentisht siguruan gjakun dhe e dërguan në Pediatri për foshnjën gjashtëmuajshe. Kështu Albionin e plagosur gjatë luftës e shpëtuan!

Falënderim me mirënjohje më të thellë për: Dr. Remzijen, Hakiun, Dr. Bukurijshe si dhe për personelin tjetër shqiptar të spitalit të fëmijëve! – shprehin familjarët e Albionit.

Albioni, i mbijetuari i luftës, tani është me shëndet të plotë dhe i fortë si çeliku, i dashur dhe shumë i respektuar.

Gjatë asaj kohe, derisa ishte duke u mjekuar Albioni, në shtëpinë tonë qëndruan: dada Nurijshe, gjyshja e Albionit, së bashku me mbesat e saj, motrat Valentina e Dafina, vajzat e Fadilit, axhës së Albionit. Gjatë kohës sa qëndruan ata në shtëpinë time, erdhi gazetari i shquar i “Dojçe Veles”, Agim Zogaj, tani profesor e publicist i njohur dhe i dalluar, i cili e realizoi një intervistë me Shpresën, nënën e Albionit.

Për ushtarët e UÇK-së dhe popullsinë civile gatuheshin edhe nga 100 bukë në ditë

Shpresa na tregonte se si gjatë kohës së luftës, ajo së bashku me bashkëshortin Baliun si dhe kunatat Zejnijen e Mihrijen, gatuanin deri 100 bukë në ditë dhe nga pesë – gjashtë pite për ushtarët e popullsinë civile, që ishin zhvendosur në malet e Tërpezës.

Popullata ishin të kërcënuar, të larguar dhe zhvendosur nga një lagje në një lagje tjetër të Prishtinës dhe së fundi edhe të dëbuar për në Bllacë.

Gjatë marsit të vitit 1999, forcat policore serbe u pozicionuan në kulmin e ndërtesës së Arkivit të Kosovës, duke vëzhguar me çdo kujdes çdo lëvizje të banorëve të kësaj lagjeje, si dhe qytetarët tjerë.

Po ashtu, forcat serbe kishin ngritur edhe barrikada pranë shtëpive të Lagjes së Universitetit, që ishin përballë shtëpive tona (shtëpia ime, e Mustafës dhe e Elmi Mustafës)



që na ndanin nga policia e ushtria vetëm disa troje pa shtëpi dhe rruga.

Çdo çast a moment ne ishim të rrezikuar dhe nuk dinim si të vepronim. Madje, në shtëpinë time ishte edhe Pika logjistike, gjë që rreziku ishte edhe më i madh.

Disa herë ishim të detyruar e të kërcënuar që të zhvendoseshim nga një lagje në lagjen tjetër, herë në “Ulpianë”, tek daja i bashkëshortes, Ramiz Bytyçi, herë në “Tophane” tek motra Bahtije e dhëndri i ndjerë Rrahim Gërdovci dhe herë në “Breg të Diellit”, në banesën e Sami Berishës, profesor e humanist i shquar, tani i ndjerë. Një ditë, duke u kthyer nga “Ulpiana”, afër fushës së sportit te Shkolla fillore “Hasan Prishtina”, unë dorë për dore me Albulenën e Tringën dhe Naimja me Nolin, papritmas dhe befasisht, para nesh dolën nga vetura e tyre, ngjyrë të kuqe e tipit të vjetër “Lada”, pjesëtarë të uniformuar si policë, të cilët na urdhëruan që të ndalemi, duke na i kërkuar letërnjoftimet. Pasi që na i shikuan, iu drejtuan Naimes: “Ti ndalu, ngase vendlindja jote, Llapushniku, është zonë e luftës! Çfarë po kërkon ti këtu?”.

Naimja, u shqetësua aq shumë saqë nuk mund të fliste dhe t’ua kthente përgjigjen. Nuk e di as vetë, se si në ato çaste tmerruese dhe me shumë qetësi iu drejtova

që të shikojnë mirë letërnjoftimin dhe adresën e vendbanimit, duke u thënë se Naimja vetëm ka lindur në Llapushnik, dhe se si fëmijë ka jetuar me familjen e saj në Prizren.

Ne, tashmë, jemi të martuar, punojmë e jetojmë në Prishtinë, në Lagjen e Spitalit. Është infermiere e punon në spital, dhe se tani është duke shkuar në punë.

Pas një situatë shumë të tensionuar, na thanë: “Shkoni e mos t’ju shohim më!”

Kur mbërrimë në shtëpi, rrugës ishte atmosferë e zymtë dhe tejet e rëndë, nga njerëz të hutuar e shumë të frikësuar dhe të pashpresë, të cilët nuk dinin si të vepronin e ku të shkonin. Gjatë një pasditeje, një kalimtar rasti i moshuar, që shkonte në drejtim të “Bregut të Diellit”, afër truallit të Çerkinit, e shumë afër shtëpive tona, forcat serbe e qëlluan me breshëri plumbash, e vranë!

I vrari, kuptuam më vonë, ishte babai i fqinjit të lagjes, Jakup Shaqirit, që quhej Bajram Shaqiri. Trupi i të ndjerit qëndroi, po aty ku u vra, tërë natën deri në orët e hershme të mëngjesit. Gjatë asaj kohe plumbat kanë goditur edhe shtëpinë e Mustafës, por ne nuk u tregonim fëmijëve, se edhe ashtu ata ishin shumë të frikësuar e të shqetësuar. Nga dritarja e shtëpisë sonë e kishin

parë trupin e vranë të të ndjerit. Tringa, vajza ime, në Kampin e Stankovecit këtë ngjarje tmerruese, e vrasjen e kalimtarit të rastit, njeriut të pafajshëm, e pati vizatuar – pikturuar.

Të hënën, 29 mars 1999 – një lumë njerëzish dëboheshin nga Prishtina

Ishim të lodhur e dërmuar fizikisht, të thyer shpirtërisht e emocionalisht, të pambrojtur e të kërcënuar, të shtrënguar e të detyruar, dhunshëm të dëbuar të lëviznim e të ndërronim lagjet, ku mendonim se janë “më të sigurta”. Prishtinën, atë ditë e kishin mbuluar re të zeza. Rrugët e Prishtinës ishin shndërruar si lumenj të mbushur me njerëz, që niseshin nga të gjitha anët drejt stacionit hekurudhor, ku ishte shpresa e vetme e cakt për t’u larguar si të dëbuar, e pa e ditur se ku do të shkonin dhe se a do të mbërrinin?!...

Edhe ne u nisëm në drejtim të stacionit hekurudhor, drejt “Bregut të Diellit”, por që nuk ishim të sigurt se a do të mund të mbërrinin?!...

Duke kaluar afër ambulancës, nga lart dëgjuam disa zëra, duke thirrur nga ballkoni i banesës, emrin tim!

Ngrita kokën lart dhe i befasuar e shumë i emocionuar pashë Lutën e Miradijen, duke na e bërë me dorë, duke na ftuar, që të ktheheshim e të ndaleshim në

banesën e tyre. Bashkëshortët Miradije e Lutfi Qehaja, na e hapën derën e madhe të konakut. Me Miradijen punonim së bashku në Shkollën fillore “Elena Gjika”. Familja Qehaja është e njohur, meqë shquhet për virtyte e tipare të larta të bujarisë e të mikpritjes, të zemërgjerësisë e shpirtmadhëstisë, të humanizmit e fisnikërisë. Në banesën e tyre ishte edhe motra e Lutës, Kadirja me fëmijët Visarin e Albanin. Madje, aty na u bashkuan edhe Shpresa e Nazmi Çitaku, së bashku me vajzën e tyre Blerandën. Me Shpresën punonim së bashku në shkollë. Shpresa e Nazi banonin shumë afër banesës së Lutës e Miradijes, dhe se një natë patëm qëndruar edhe në banesën e tyre.

Që nga data 29 mars e deri më 3 prill 1999, ne qëndruam në banesën e familjes Qehaja, në “Bregun e Diellit”. Përkundër gjendjes së rëndë të luftës, ankthit e tmerrit, fëmijët gjatë atyre ditëve sa qëndruam aty, sikur ndjeheshin më të sigurt e më të qetë, ngase ne si prindër iu dhuronin dashuri, ngrohtësi e qetësi...

Ato ditë, për ne, do të mbetën përjetë të paharruara, ku me mirënjohjen më të thellë nga zemra e falënderojmë këtë familje me zemër të madhe për mikpritjen e veçantë e shumë të ngrohtë dhe të përzemërt. Familja Qehaja është shembull e simbol i oqeanit të mikpritjes e bujarisë, bamirësisë e humanizmit si dhe fisnikërisë së rrallë shqiptare e të pakrahasuar.

Bllaca e atyre ditëve e netëve të tmerrit e të ferrit...

E shtunë, 3 prill 1999

Nuk e dimë ende, as sot e asaj dite, se ç’ndodhi me foshnjën gjashtëmuajshe?!... Në asnjë lagje të Prishtinës nuk ishte askush i sigurt, meqë dëbimi masiv dhe i tmerrshëm i qytetarëve të Prishtinës, nga forcat serbe ishte gjenocid i paparë, thjesht pastrim etnik. Dhe, i ashtuquajturi “Korridori” i Gligorovit, Plani famëkeq “Patkoi” i Millosheviqit si dhe realizimi i një ëndrrë shekullore serbomadhe për një Kosovë pa shqiptarë, filloi të zbatohej në vazhdimësi... Në orët e hershme të mëngjesit, të së shtunës, dolëm nga banesa e familjes së madhe bujare Qehaja, për të vazhduar rrugëtimin me shpresa të thyera e pakthim drejt stacionit hekurudhor.

Shiheshin qytetarë në grupe të hutuar e shumë të shqetësuar, të kërcënuar e me fëmijë të frikësuar përdore, duke ecur në rrugë e drejtime të ndryshme. Feridja, ish-arsimtare, me një zë shumë të ulët e me një mirësjellje të veçantë m’u drejtua: “Mund të vini edhe ju me ne në një autobus, që jemi

duke pritur për t’u nisur për në Bllacë!”. Autobusi u vonua, megjithatë pritëm një kohë të gjatë por më vonë mbërrini. Megjithatë, kishte vështirësi e nuk kishte siguri se nga cili vend të niseshim?!...Dhe, më në fund, pritjes së gjatë e shumë të mundimshme i erdhi fundi. U nisëm... Një nisje e papërballueshme, shumë e madhe dhe e dhimbshme. Në autobus ishim mbi 80 persona, nga foshnjat e deri më të moshuarit. Në të dy anët e rrugës, nga Lipjani e deri në Han të Elezit, shihnim shtëpi të djegura dhe tymra që përhapeshin në qiell, si dhe dëgjoheshin të shtëna armësh e granatimesh. Udhëtimi me autobus zgjati 50 minuta. Mbërrimë në Bllacë. Bllaca, vend tmerri e ferri. Një kohë të gjatë na ndalën te Fabrika e Çimentos, e madje policët serbë na urdhëruan që të ecnim vetëm brenda binarëve të trenit ngase në të dy anët e hekurudhës, na thoshin: “Janë të minuara?!”. Në Bllacë, pranë lumit, shihje njerëz të dëbuarish, si lumenj të rrëmbyeshëm. Nuk dinim se ku e si të vendoseshim?!... Iu bashkuam turmës së madhe të njerëzve që prisnin e shpresonin ta kalonin kufirin e hekurit maqedonas. Aty takuam Dr. Sami Delijajn së bashku me bashkëshorten, djalin dhe vajzat e tij. Pjesën tjetër të familjes së tij, nga Abria e Drenicës, forcat serbe ia kishin vrarë e masakruar. Unë i njihja, meqë isha arsimtar dhe kujdestar i djalit të tij, Gentritit. Ishim shumë të lodhur, të këputur e të dërmuar dhe mezi qëndronim në këmbë, vetëm e vetëm me shpresën se ndoshta do të kemi fatin që ta kalojmë atë kufi të mallkuar...

Atë natë mundi e përpjekja jonë dështoi, por edhe disa ditë e net të tjera dështuan dhe assesi ta preknim a ta kalonim atë kufi të çeliktë nga ushtarët maqedonas! Binte një shi dhe bënte ftohtë. Një natë shumë e zymtë, e nën qiellin e hapur e me vetëm dy batanije, e pa tendë plastmase, fëmijët dhe bashkëshorten time i zuri gjumi. Unë qëndroja pranë tyre. Bllaca gjëmonte nga qarjet e foshnjave a fëmijëve dhe mallkimet e nënave. Rreth orës 22:00 afrohet një nënë me foshnjën e saj duke e lutur Naimen që t’i bëjë pak vend sa të shtrihej për t’i dhënë gjë foshnjës së saj gjashtëmuajshe. Naimja, me shumë mirësi, i bëri vend dhe i tha: “Eja e shtriju lirisht!” – ku ajo u mbulua me batanije.

Pas një kohe, pasi i dha gjë dhe e qetësoi fëmijën, nëna e foshnjës, na u drejtua neve: “A mund ta lë për një kohë fëmijën këtu tek ju, derisa t’i takoj prindërit e burrit?”. Foshnjën e zuri gjumi në prehër të Naimes. Kaluan dy orë dhe nëna e fëmijës nuk po vinte dhe as që mund ta shihnim edhe pse e kërkonim?!... Pas mesnate foshnja u zgjua nga

gjumi dhe filloi të qante e të dëneste me të madhe, saqë edhe neve zemra filloi të na dridhej, ngase nuk mund ta qetësonim atë assesi. Në ato çaste përjetuam shumë emocione dhembshurie dhe ishim shumë të prekur e të shqetësuar! Fillova ta kërkoja nënën e foshnjës nga të gjitha anët, por ishte e pamundur ta dalloja a njihja në ato orë të vona të natës dhe në atë turmë të madhe njerëzish. Pas shumë kërkimesh e njoftova Kryqin e Kuq me rastin. Ata erdhën menjëherë, e me shumë kujdes e mirësi e morën foshnjën. Për ne ishte një çast shumë i ndjeshëm, shumë i prekshëm dhe shumë i dhembshëm si dhe i paharruar në mendjen dhe në kujtesën tonë?! Sa shumë do të dëshironim të dinim se çfarë ndodhi më vonë, me fatin e kësaj foshnjeje engjëlllore?!... Sa do të dëshironim ta takonim! Por, asgjë kurrë nuk mësuam se çfarë ndodhi me atë?! Në luginën e tmerrshme të Bllacës veneronim njerëz të këputur e të lodhur si dhe të thyer shpirtërisht e emocionalisht, meqë ishin të pangrënë, pa bukë dhe pa ujë.

Pas dy ditësh, ne mezi me ndihmën e disa njerëzve të mirë, e ngritëm një tendë të vogël prej plastmase. Për fatin tonë ishin shqiptarët e Maqedonisë, motrat e vëllezërit tanë që u organizuan dhe u aktivizuan me bujarinë e fisnikërinë si dhe me humanizmin e tyre të paparë për të na ndihmuar me ushqime e gjëra të tjera. Asnjëherë nuk mund t’i harroj ato çaste të prekshme, kur nga traktorët apo automjetet tjera, ato vullnetarët humanistë shqiptarë të Shkupit e rrethinës, në pamjaftueshmëri të hapësirës hidhnin bukë në drejtim të turmës të njerëzve, që ishin me duar të zgjatura e të ngritura për të siguruar së paku një bukë. Megjithatë, një njeri shpirtkazmë, edhe pse i rritur, nga duart ia mori bukën Tringës, vajzës sime 12 vjeçare?!!!

Atë ditë, megjithatë, ne mbetëm pa bukë. Por, ndërkohë takova fqinjin tonë, Shaqir Shaqirin, i njohur si mësuesi Shaqë, një veprimtar e humanist i madh. Ai sapo kishte ardhur me familjen e tij nga Prishtina, m’i dha disa gurabije që i kishte marrë me vete nga shtëpia. Për atë ditë e atë natë na mjaftuan ato gurabijtë e fqinjit tonë të nderuar, Shaqës. Po ashtu, në Bllacë, takova Mire Gashin me familje. Me mësuesen e dalluar Mire, punonim së bashku në shkollë. Aty takova edhe Qëndrim Gashin djalin e saj, ish-nxënësi imi, tani Doktor i Matematikës, ish-ambasador e profesor i shquar ndërkombëtar. Në Bllacë ne qëndruam deri më 7 prill, ku në orët e hershme të mëngjesit, diku rreth orës 4:00, iu



afrova ushtarëve maqedonas duke i lutur me mirëkuptim dhe ndjenjë humaniteti, duke i njoftuar se fëmijët nuk po ndjeheshin mirë, duke kërkuar nga ata për të na mundësuar për të kaluar atë kufi të mallkuar!... Një ushtar, me shumë mirësjellje, ndoshta ishte shqiptar (?) më tha: “Shko dhe zgjoji fëmijët dhe ejani!”.

Me shpejtësi u ktheva te gjysmëtenda dhe i zgjova nga gjumi fëmijët dhe bashkëshorten. Shpejt i morëm valixhet dhe u nisëm drejt vendit, pika e caktuar, ku më sygjeroi ushtari. Por, ky ushtari për një çast e kishte ndërruar vendin e pozicionin, ndërkaq ai tjetri që ishte aty, na u kërcënua që të zbrisnim shpejt poshtë. Por, për fatin tonë, nga largësia na vërejti ai ushtari i cili më herët më kishte premtuar se do të na ndihmojë ta kalonim kufirin. Ai na ftoi që të afroheshim duke na ndihmuar që të kalonim mbi shkallët e improvizuara.

Më në fund morëm frymë lirshëm. Autobusët ishin radhitur në pritje, ndërsa ne as që dinim se ku mund të na dërgonin?! Ishin disa procedura, para se të hipnim në autobus ngase persona të caktuar në gjuhën maqedonase na pyesnin të gjithëve për emrin e mbiemrin, vitin e lindjes dhe vendin... Disa gra të moshuara, por edhe më të reja, nuk kuptonin se çfarë po u thonin e kërkonin?!..

Albulena, vajza ime 15 vjeçare, përveç gjuhës angleze njihte edhe gjuhën serbe, ku te dera e fundit e autobusit përkthente për ata që nuk e kuptonin gjuhën, ndërsa unë isha te dera e parë. Pas kryerjes së këtyre procedurave autobusi u nis. Askush nuk na tregonte se ku po na dërgonin. Dhe, pas një kohe autobusi u ndal në Kampin e

Stankovecit.

Në kampin e Stankovecit në intervistë me gazetarin e Televizionit Belg, VRT

Në Stankovec na pritën e na vendosën menjëherë në Tendën B-65, ushtarët italianë të KFOR-it, ku na dhanë pako me gjëra ushqimore, pije e veshmbathje. Në tendën tonë e vendosën edhe familjen Veselaj nga Gllareva e Klinës.

Në Kampin e Stankovecit takuam edhe familjen Hajrullahu, fqinjët tanë të nderuar: Selamiun e Havën, vajzën e tyre – Jehonën si dhe djemtë Astritin e Kujtimin, ku kalonim së bashku një pjesë të kohës.

Çdo mëngjes para tendës na sillnin gjëra ushqimore. Po ashtu edhe kushtet higjienike ishin, deri diku, pak më të mira, në krahasim me Kampin e përqendrimit famëkeq të Bllacës. Përkujdesja shëndetësore ishte në nivelin e duhur. Pas disa ditësh Kampi i Stankovecit u stërmbysh me refugjatë të luftës dhe gjendja u përqeqësua. Natën bënte shumë ftohtë. Sa herë që binte shi krijohesh baltë e madhe.

Në Stankovec qëndruam prej datës 7-18 prill 1999. Në Kampin e Stankovecit filloi të bëhej jeta e padurueshme dhe e papërballueshme, e mundimshme dhe e frikshme. Përveç ushtarëve të KFOR-it, që përkujdeseshin për sigurinë tonë, vepronin edhe organizata humanitare të ndryshme ndërkombëtare.

Opinionin botëror u njoftua me gjendjen e rëndë të refugjatëve shqiptarë të Kosovës. Filluan të vepronin urgjentisht: Kryqi i Kuq Ndërkombëtar, Komisariati i



Lartë Ndërkombëtar, OSB dhe UNHCR.

Shumë shtete të botës, përmes UNHCR-it filluan të merrnin refugjatë nga Kampi i Stankovecit. Unë u paraqita në zyrat e UNHCR-së, duke kërkuar që të më sistemonin në ndonjë nga shtetet, që të largoheshim nga kampi sa më parë.

Aty i plotësova formularët sipas procedurave të kërkuara dhe shtetin se ku mund të na dërgonin. Pasi i plotësova formularët, zyrtarit i kishte lënë përshtypje të madhe bukurshkrimi im.

Meqë unë nuk njihja gjuhën angleze, përkthyesi një djalë tejet i edukuar nga Prishtina, më drejtohet me shumë mirësjellje, duke më thënë se çfarë po më thoshte e propozonte zyrtari.

Ai mu drejtua duke më thënë se në cilën prej këtyre shteteve dëshiroja të shkoja: në Izrael, Holandë, Gjermani apo në Austri?! Mua, në ato çaste, më ishte ngulitur në mendje Belgjika. Prandaj, kërkoja të shkoja nëse do të më mundësohej vetëm në Belgjikë, pasi atje jetonte, që nga viti 1991, motra ime Sevdija së bashku me bashkëshortin, Avniun, si dhe fëmijët: Emirjetën, Shqipronin dhe Ermirën. Përgjigjja e zyrtarit irlandez ishte: “Belgjika ende nuk ka kërkuar zyrtarisht refugjatë”. Unë isha i vendosur, duke u thënë se vetëm në Belgjikë dëshiroja të shkoja. Zyrtari me shumë mirësjellje mu drejtua: “Belgjika ende nuk kishte ofruar njoftimin zyrtar për strehimin e refugjatëve të luftës nga Kampi i Stankovecit”. Zyrtari, megjithatë, shkruajti emrin tim, numrin e tendës B-65 dhe kërkesën time për Belgjikë. Po atë ditë ata e dërgojnë kërkesën time në ambasadën e Belgjikës në Shkup.

Dhe, pas një dite erdhën gazetarët belgë dhe më takuan te tenda B-65, ku edhe zhvilluan një intervistë me mua. Gazetari i ri, i njohur dhe i shquar belg Tim Pauwels, së bashku me kameramanin belg dhe një përkthyes shqiptar nga Shkupi, erdhën në tendën ku rrinim për të realizuar një intervistë, kronikë e dokumentar me mua dhe familjen time në Kampin e Stankovecit, pasi që Ambasada belge i kishte njoftuar ata për dëshirën time të zjarrtë që si refugjat i luftës të shkoja në Belgjikë.

Timi me profesionalizmin e tij të rrallë e humanizmin e madh realizoi një intervistë e kronikë të drejtpërdrejtë, të rrallë, prekëse dhe të veçantë televizive, duke njoftuar Qeverinë e opinionin belg për gjendjen, tmerrin e luftës që po përjetonim ne shqiptarët e Kosovës nga regjimi i egër shtypës e shfarosës i Millosheviqit, meqë po ushtronte e bënte dhunë të paparë, duke vrarë e djegur si dhe duke na dëbuar dhunshëm nga shtëpitë e trojet tona shekullore.

“Ju, Tim, erdhët në Kampin e Stankovecit në kohën e duhur dhe në momentet më dramatike, që po përjetonim për të na vizituar neve të dëbuarve kosovarë, refugjatë të luftës!”- i thashë. Pas mbarimit të Intervistës e kronikës, me pamjet nga kampi, ata na u falënderuan, por falënderimi për ta, me mirënjohjen më të thellë ishte i pafund nga ana jonë!

Para se të përshëndeteshin ata më dhanë një copë letër, me emrat e tyre dhe diçka të shkruar që mund të më shërbente si dëshmi.

Të enjten, më 15 prill, u realizua intervista, dhe po të njëjtën ditë, në orët e mbrëmjes e kishin dhënë kronikën për ne në lajmet qendrore Televizioni Belg, VRT, dhe televizionet tjera të Belgjikës.

Shumë shpejt reagon Qeveria belge, duke marrë vendim të menjëhershëm, që më 18 prill, t'i merrte 170 refugjatët e parë me aeroplan nga Kampi i Stankovecit. Njoftimin e dhanë dhe e publikuan në Kamp përfaqësuesit e UNHCR-së. Me shpejtësi u dha lajmi dhe u grumbullua një numër i madh refugjatësh, duke krijuar radhë të gjata pritjeje për të plotësuar formularët që kërkoreshin.

Meqë, gazetarët belgë më patën thënë, duke ma dhënë edhe një letër, se kurdo që Belgjika kërkon refugjatë nga ky kamp: “Familja juaj do të jetë ndër të parat!” Pas shumë përpjekjesh iu afrova zyrtarit, si dhe përkthyeses nga Mitrovica, duke i njoftuar e kërkuar nga ata që ta shikonin letrën e gazetarëve.

E vërejta, se përkthyesja nuk po përkthente siç duhej?!... Këtë e vërejtë edhe zyrtari, por që s'mund të kuptohesha me të pasi nuk dija anglisht.

Përkthyesja, me shumë ironi mu drejtua duke më thënë: “Mos vallë, me këtë copë letër po mendon se mund të shkosh në Belgjikë?!...”

– Pritë në radhë, nëse ke fat derisa të plotësohet numri i kërkuar! – më thanë.

Hyra në radhë të pritjes, pas një kohe vëreja se po priste në radhë për të shkuar në Belgjikë edhe fqinja jonë, Hava.

Atë, në pritje të gjatë, e ndërronin nganjëherë Selamiu e Jehona. Ndërsa, mua herë pas here, më sillte ujë bashkëshortja ime, Naimja.

Pritëm në radhë prej orës 18:00 të mbrëmjes deri në orën 5:00 të mëngjesit, kur na njoftuan lajmin e hidhur se ishte plotësuar lista. I zhgënjyer tejmasë, i lodhur e i dërrmuar u ktheva në tendë për të pushuar pak...

Gjatë ditës, shikoja se mos po publikohej ndonjë njoftim i ri nga ndonjë shtet tjetër?!... Diku rreth orës 18:00 ishin tubuar refugjatë të shumtë, duke shikuar e shpresuar se a janë emrat e tyre në listën e publikuar nga autoritetet belge dhe të UNHCR-së, se lista për t'u



strehuar në Belgjikë, tashmë ishte plotësuar.

Unë, as që u afrova për të shikuar?! Pas një kohe më ndal një i njohur dhe më thotë: “Sa mirë ishte bërë për ju, ku pashë listën që ishit pranuar për të shkuar në Belgjikë!”

Nxitova, meqë nuk besoja... U afrova duke shikuar me shumë kujdes listën, meqë më nuk kishte turmë të madhe njerëzish.

Në fillim të listës ishte emri im, si kryefamiljar dhe i anëtarëve tjerë të familjes sime. Shkova drejt te tenda, i njoftova fëmijët dhe bashkëshorten. Në fytyrat e tyre, pas një kohe shumë të gjatë, shpërtheu buzëqeshja e gëzimi i papërshekruar! Të dielën, më 18 prill 1999, u larguam paradite me një ndjenjë lehtësimi shpirtëror e emocional nga Kampi i Stankovecit, dhe të gëzuar u nisëm me aeroplan special nga Aeroporti i Shkupit për në Belgjikë. Në aeroplan ishim 170 refugjatët e parë të luftës nga Kosova.

Mikpritja më madhështore për ne në Belgjikë

Ne as që e dinim se me të arritur në Aeroportin e Brukselit, po na pritnin gazetarët e shquar belgë, Timi dhe kryeredaktori (tashmë) i ndjerë i Televizionit belg VRT Jose, si dhe motra ime Sevdija e dhëndri, Avni Durguti. Pasi pushuam e u çmallëm me ta, të gjithë refugjatët na dërguan në një bazë ushtarake për të rregulluar procedurat e statusin se çfarë kërkohej për qëndrim në shtetin shumë mikpritës, bujar e human të Belgjikës, si refugjatë të luftës. Madje, me autobusë e të shoqëruar me vetura të policisë na dërguan në Qendrën e Frepos, që më parë kishte shërbyer si pushimore e punëtorëve të postës, ku kushtet ishin shumë të mira, dhe asgjë nuk na mungonte.

Gjatë udhëtimit tonë me autobusë, në të dy anët e rrugës, kishin dalë qytetarët belgë për të na përshëndetur, e për të na uruar mirëseardhje, duke u solidarizuar me ne refugjatët e parë të luftës nga Kosova.

Të nesërmen në Qendër erdhën gazetarë të ndryshëm, jo vetëm belgë, për të na pyetur e intervistuar për gjendjen e luftën e tmerrshme, që kishim përjetuar në Kosovë, por edhe për kushtet në Kampet e Bllacës e të Stankovecit.

Një gazetar jo belg, ndër të tjera m'u drejtua me një pyetje provokative, duke më thënë: “Ju keni ikur nga bombardimet e NATO-s?!”. Përgjigjja ime ishte shumë e prerë duke i thënë: “Kjo që ju po thoni nuk është e vërtetë dhe se nuk qëndron, por jemi dëbuar nga regjimi agresiv i Millosheviqit, i cili në pamundësi për t'iu kundërpërgjigjur sulmeve të NATO-s, tërë arsenalin e tij luftarak (ushtarak e policor), ai e drejtonte ndaj popullsisë së pafajshme civile, duke vrarë e masakruar e duke realizuar politikën e Tokës së Djegur në Kosovë!”.

Pastaj iu drejtova gazetarëve: “Tash e sa më parë, për të shpëtuar Kosovën, atje duhet të dërgohen urgjentisht edhe Trupat Tokësore të NATO-s!”

Të gjitha intervistat dhe kronikat tjera televizive belge, kudo ku kam folur, i kam të ruajtura si dëshmi atëherë e kësaj dite.

Këto dëshmi ua kam ofruar disa regjisorëve në Prishtinë, për të realizuar ndonjë dokumentar, por për çudi, asnjëri nga ata nuk ka shprehur interesim për këto?! Pas dy javësh, në Qendrën ku ishim të vendosur në Frepo, ne refugjatët, nën mbikëqyrjen e përkujdesjen e madhe të Kryqit të Kuq të Belgjikës, pasi që kishte shikuar intervistat e mia në TV, si dhe disa nga kronikat e shumta televizive belge, erdhi një zonjë e madhe dhe e nderuar belge, me shpirt e zemër humane për të na takuar e biseduar me ne.

Njohja dhe takimi i saj me ne ishte shumë i përzemërt e emocional, befasues dhe i papritur. Ajo na u prezantua me emrin Michele Delperdange, duke na u drejtuar me shumë dashamirësi e lutje për të na marrë në shtëpinë e saj.

Dhe, ne pas dy ditësh, vendosëm të shkonim. Bertogne ishte shumë larg Qendrës, ku banonin ata. Ajo erdhi me veturën e saj e

na mori. Na vendosi në shtëpi të re, ku asgjë nuk na mungonte. Shtëpinë e kishte rregulluar posaçërisht për ne, me të gjitha gjërat e reja. Dhe, të mos flasim për ushqim të bollshëm e veshmbathje të reja për të gjithë ne. Ajo shtëpi e saj, tashmë ku u vendosëm edhe ne, kishte edhe pishinë.

Në atë kohë me ne në Bertogne, ishte edhe familja Zeka-Spahiu nga Ferizaj, Flora me fëmijët Lizin e Zanën. Ata qëndruan te familja Baltus, Zhozef e Marizhoja.

Me gjithë zemër ne e falënderojmë familjen Delperdange, posaçërisht zonjën e madhe e humanisten e dalluar, miken më të shtrenjtë të familjes sonë, Michele, prindërit e saj shumë bujarë e të dashur (tani të ndjerë), djalin e saj Fransua, qytetarët e dashur dhe shumë bujarë e fisnikë të Bertonjes (Bertogne), Shkollën fillore të Bertonjes (Bertogne), drejtoreshën Francine Lambert, mësueset: Stephanie Calbert, Pascale Meunier, e të tjerë. Gjimnazin Real të Bastonjes (Bastogne), Komunën e Bertonjes (Bertogne), Zhaninën, Kryqin e Kuq të Belgjikës, Mjekun e shuqar të familjës sonë, doktor Schabben, Kishën e Bertonjes (Bertogne). Njeriun e mirë e bujar Rene Gillet, Emilie, motrën e Michele dhe familjen e saj. Qendrën Strehuese të Frepos, si dhe drejtorin e palodhshëm e shumë të respektuar Billin. Me mirënjohjen më të thellë e të përzemërt falenderojmë gazetarët e shquar e shpëtimtarët tanë të VRT-së, Tim Pauwels e Joos Van Hemelrijck, televizionet tjera e gazetatat e njohura belge.

Ne Belgjikën e ndjejmë si atdhe tonin, të dytë! Më 29 qershor 2000, ne u kthyem vullnetarisht nga Belgjika në Kosovë, edhe pse e kishim të rregulluar statusin e refugjatëve të luftës, ku mund ta merrnim edhe shtetësinë belge. Ky ishte një rrëfim yni familjar, me përjetime lufte, nga ai rrugëtim i gjatë, por edhe ngadhënjimtar.

DITËLINDJA E RADHËS E GAZETËS MË TË GUXIMSHME SHQIPTARE



Ismet SYLEJMANI

25 Janari i vitit 2000, sigurisht se shënon shumë ditëlindje, por për ne 25 Janari i vitit 2000 shënon ditëlindjen e gazetës EPOKA E RE, të gazetës më të guximshme shqiptare! Në këtë ditëlindje të gjithë gëzojnë, por më së shumti gëzon shoku e miku im i madh Muhamet Mavraj!

Gëzuar të gjithëve ditëlindjen e 26 -të Epokës së Re, e më së shumti shokut e mikut tim të madh Muhamet Mavraj! DITËLINDJA E “EPOKËS SË RE”, ËSHTË DITËLINDJA E GAZETARISË SË PAVARUR NË KOSOVËN E LIRË Ish – gazeta studentore legale e Universitetit të Prishtinës

“bota e re”, ish- gazeta ilegale e LPK-se “Zëri i Kosovës” bashkë me dokumentet e UÇK-së,definitivisht janë shkrirë gazetën e lirë dhe të pavarur “Epoka e Re”! Gazeta Epoka e Re, mbetet trekëndëshi i famshëm, i cili i ka lidhur në një edhe UP-në, edhe LPK-në edhe UÇK-në!

Shëndet e suksese themeluesit të saj, shokut e mikut tim të madh Muhamet Mavraj! Shëndet e suksese stafit të mrekullueshëm të “EPOKËS SË RE”! Gëzuar ditëlindjen e famshmja “EPOKA E RE”! Prishtinë, 25 Janar 2026!





Korenica po kërkohet edhe në Kinë

PRISHTINË, 26 JANAR - Meriton Korenica edhe pse vlerësohet lojtar shumë i rëndësishëm për Clujin, ka gjasa që të largohet nga skuadra rumune gjatë këtij muaji. Te Cluji kanë pranuar se kanë marrë oferta për Korenicën edhe nga Kina, por nuk kanë

përmendur emrat e skuadrave të interesuara. Gjithashtu, në garë është edhe ekipi nga MLS e ShBA-së, DC United që veçse ka ofruar 4 milionë dollarë për kartonin e tij. “Ka interes nga Kina, nga MLS për Korenicën por do të mundohemi ta mbajmë edhe pse do të jetë

vështirë pasi ofertat janë të mira. Ai është lojtar i rëndësishëm për ne dhe me largimin e tij do të humbim shumë, por do të shohim”, ka thënë Bogdan Mara, drejtori sportiv i Clujit. 29-vjeçari është pjesë e Clujit prej vitit 2024 dhe ka kontratë deri në verën e

vitit të ardhshëm, ndërsa në sezonin aktual, Korenica ka 7 gola e po asistime në 31 paraqitje në të gjitha garat. Gjithashtu, Korenica ka edhe gjashtë ndeshje të luajtura me Kombëtaren e Kosovës për të cilën debutoi në shtator të vitit 2023.



DRITA FITUESE E SUPERKUPËS

ANTALYA, 26 JANAR - Drita ka fituar Superkupën e Kosovës duke e mposhtur Prishtinën, me rezultat 2:1. Ky është trofeu i dytë i Superkupës në histori për skuadrën gjilanase, pas suksesit të saj të parë në edicionin 2018/2019, kur edhe atëherë kishte mposhtur të njëjtin kundërshtar. Ndeshja është zhvilluar në stadiumin “Mardan Sports Complex” në Antalya të Turqisë, atje ku të dyja skuadrat janë duke e zhvilluar fazën përgatitore për

stinorin pranveror. Prishtina, fituese aktuale e Kupës së Kosovës, ka kaluar e para në epërsi në minutën e 8-të me golin e Leotrim Kryeziut. Besnik Krasniqi ka barazuar rezultatin në 1:1 për Dritën në minutën e 39-të nga penalltia. Në fund të pjesës së parë, Prishtina ka mbetur me një futbollist më pak pasi Harun Kariq është ndëshkuar me karton të kuq për pengim të një kundërsulmi të shpejt të Dritës. Golin vendimtar e të



fitores (2:1), e ka shënuar Kristal Abazaj në minutën e 50-të, me gjuajtje me kokë, duke i dhënë Dritës trofeun e Superkupës. Trofeun e Superkupës Besnik

Krasniqi dhe Faton Malokut ia ka dorëzuar presidenti i FFK-së, Agim Ademi, ndërsa medaljet për ekipet janë ndarë nga kryetari i Komunës së Gjilanit, Alban Hyseni, dhe drejtori i sportit në Komunën e Prishtinës, Kushtrim Mushica. Pas fitores në finalen e Supekupës nuk ka munguar as urimi i presidentit Ademi për Dritën. “Përgëzoj përzemërsisht FC Dritën për fitimin e këtij trofeu, ku organizimi dhe performanca e

mirë në fushë u kurorëzuan me sukses. Një vlerësim i veçantë edhe për FC Prishtinën, për lojën e mirë e shpirtin luftarak deri në minutat e fundit. Ndeshje të tilla janë dëshmi e progresit të vazhdueshëm të klubeve tona dhe e ambicies për paraqitje dinjitoze edhe në arenën ndërkombëtare. Vazhdojmë përpara së bashku me punë dhe përkushtim për ta ngritur futbollin e Kosovës në nivelin që meriton”, ka thënë Ademi.

KËRKOHEN INVESTIME URGJENTE NË BREZOVICË PËR ZHVILLIMIN E SPORTIT

PRISHTINË, 26 JANAR - Komiteti Olimpik i Kosovës (KOK) ka prezantuar zyrtarisht ekipin që do të përfaqësojë vendin në Lojërat Olimpike Dimërore “Milano Cortina 2026”. Skitarët Kiana Kryeziu dhe Drin Kokaj do të mbajnë flamurin e Kosovës në këtë ngjarje madhore sportive, por sukseesi i tyre vjen me një sfond sfidash dhe një apel të fuqishëm për investime në infrastrukturën e sporteve dimërore në vend. Kryetari i Federatës Skitare të Kosovës, Milaim Kelmendi, ka thënë se mungesa e infrastrukturës së nevojshme sportive që nga paslufta është duke penalizuar zhvillimin e sportistëve në Kosovës, pasi në të kundërtën, sipas tij, në lojëra të tilla Kosova do të

përfaqësohej me më shumë skitarë. “Ata janë të përgatitur, kanë ditë shumë në borë, por kryesisht i kanë nëpër vende të tjera. Edhe gjithë ato mjete financiare kanë shkuar atje, do të thotë për t'u përgatitur këta. Duke e ditur që ne nuk kemi një infrastrukturë të tillë që të ngrisim edhe më lart cilësinë e këtyre sportistëve, edhe patjetër që me infrastrukturën e re që do të na vijë, dashtë Zoti, do të shkojmë edhe me dy, edhe me katër, edhe me gjashtë, edhe me më shumë sportistë, sepse kemi mundësi ta ushtrojmë këtë sport në vendin tonë këtu afër nesh. Kështu që infrastruktura është ajo e cila e ka penalizuar qysh nga mbarimi i luftës edhe deri tani që Kosova të ngecë vetëm me dy sportistë. Kështu që

nëse na bëhet infrastruktura e mirëfilltë si duhet në Kosovë, atëherë besoj që do të kemi më shumë garues prezent nëpër olimpiadat e radhës”, ka thënë Kelmendi. Këtij apeli i është bashkuar edhe presidenti i KOK-ut, Ismet Krasniqi, i cili i ka bërë thirrje Qeverisë së Kosovës të ndërmarrë hapa urgjentë për të investuar në Brezovicë, vend ky në të cilin skitarët vendorë edhe do të mund të përgatiteshin, por edhe të zhvilloheshin garat të nivelit të lartë. “Kiana na përfaqëson me tri disiplina dhe Drini me një. Kosova në Lojërat Olimpike Dimërore ‘Cortina’ do të jetë në mediet e gjithë botës për katër ditë radhazi. Kjo është besoj një impakt shumë i mirë për vendin tonë,



për qeverinë tonë, për vendin tonë si një shtet i ri që ka shumë nevojë për promovim të tillë. E kjo po bëhet më së miri përmes sportit. E ftoj Qeverinë e Kosovës që me hapa urgjentë të ndërmerr

masa që Brezovica, një aset shumë i madh i Kosovës, mos të lihet anash. Kemi nevojë për këtë vend që të investohet në infrastrukturë sportive. Jo vetëm për garuesit tanë, por pse jo të vijnë edhe nga rajoni të bëjnë gara dhe të ushtrojnë në atë vend, që mos të çojmë paratë në vende të tjera kur e kemi vendin tonë këtu brenda në Kosovë”, ka thënë Krasniqi. Paraqitja e Kosovës me dy atletë në “Milano Cortina 2026” është vlerësuar një sukses i madh, derisa është kërkuar që talenti dhe sakrifica e sportistëve të mbështeten nga një vizion strategjik dhe investime konkrete shtetërore për të garantuar një të ardhme të ndritur për sportet dimërore në Kosovë. /KP

Hoffenhemi dhe Beshiktashi afër marrëveshjes për Rashicën


PRISHTINË, 26 JANAR - Milot Rashica sipas të gjitha gjasave do të rikthehet në Bundesligën gjermane, por te skuadra e Hoffenheimit. Mediumet turke kanë bërë me dije se Hoffenheimi është në negociata zyrtare me Beshiktashin për Rashicën, i cili gjatë kësaj

jave mund të bëjë lëvizjen nga Turqia për në Gjermani. Negociatat mes klubeve janë duke shkuar mirë dhe palët janë afër marrëveshjes, pasi Hoffenheimi ka ofruar sulmuesin Adam Hlozek si pjesë të shkëmbimit me Rashicën. Mësohet se palët

janë duke i negociuar kushtet, përpara se të bëhet zyrtare gjithçka dhe Rashica të bashkohet me Hoffenheimin, ekip ku luajnë edhe tre futbollistët e Kosovës, Fisnik Asllani, Leon Avdullahu dhe Alban Hajdari. Rashica këtë sezon ka shënuar 2 gola dhe ka

bërë 3 asistime në 20 paraqitje për Beshiktashin, ekip me të cilin ka kontratë deri në vitin 2027. Ai te Beshiktashi është transferuar në vitin 2023, ndërsa karrierë ka bërë edhe te Norwich City, Galatasaray, Werder Bremei dhe Vitesse.





Në mbështetje të nenit 8, nenit 10 nën par. 2.2 dhe nenit 15 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës i shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës me datë 01.12.2010, nenin 7 të Udhëzimit Administrativ MFPT - Nr. 01/2024 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik i cili është pjesë e Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës i cili është i shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës me datë 11.03.2024, neni 18 dhe nenin 22 të Rregullores Nr. 13/25 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës të miratuar nga Bordi i Drejtorëve të N.P.L "Përparimi" Sh. A, e duke u bazuar në vendimin me nr. të protokollit 155/26 të datës 26.01.2026 të Kryeshefit Ekzekutiv, N.P.L "Përparimi" Sh. A, me datë 26.01.2026 shpall:

KONKURS PUBLIK

I. Titulli: Mbledhës i mbeturinave – Punëtor Fizik

Numri i ekzekutuesve: 1

Orët e punës: 40 orë në javë

Kohëzgjatja e emërimit: Me kohë të caktuar një (1) vit nga të cilat gjashtë (6) muaj do të jenë punë provuese, me mundësi vazhdimi.

Përgatitja profesionale: Shkolla Fillore

Përvoja e punës: Preferohet një (1) vit

I raporton: Menaxherit të Njësisë të Mbledhjes dhe Transportimit të Mbeturinave

Koeficienti i pagës: 457.87 Euro Bruto

Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësi të punës:

- Kryen të gjitha punët në mbledhjen dhe ngarkimin e mbeturinave.
- Mbledh mbeturina dhe bënë zbrazjen e Kontejnerëve dhe mjeteve tjera për mbeturina apo çesëve nga shfrytëzuesit të shërbimeve në sektorin privat dhe shtetëror.
- Pas zbrazjes së Kontejnerëve dhe mjeteve tjera, është i obliguar t'i kthejë ato në vende të caktuara dhe për to të ketë kujdes.
- Është përgjegjës për kryerjen e punëve në mënyrë efikase dhe kualitative, për sjellje korrekte me qytetarët-shfrytëzuesit e shërbimeve.
- Për punën e tij i përgjigjet Menaxherit të Njësisë së Mbledhjes dhe transportimit të mbeturinave.

Aplikacionit i duhet bashkangjitur:

- Formulari për aplikim i N.P.L "Përparimi" Sh. A - Vushtri.;
- Dëshmitë për kualifikimin shkollor (e skanuar);
- Ekstraktin e lindjes; (certifikata e nxjerrë online në platformën e-Kosova do të pranohet);
- Certifikatën mbi dënimin penal të lëshuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, se nuk ka dënime penale në evidencën qendrore penale të Republikës së Kosovës (certifikata e nxjerrë online në platformën e-Kosova do të pranohen);
- Dëshmitë për përvojën e punës (të skanuara) (nuk është obligative);
- Kopjen e letërnjoftimit (e skanuar);

Kriteret e përgjithshme që duhet t'i plotësojnë të gjithë kandidatët.

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës.
- Të ketë zotësi të plotë veprimi.
- Të zotërojë të paktën njërën nga gjuhët zyrtare në pajtim me Ligjin për Gjuhët.

Mënyra e vlerësimit të kandidatëve.

- Testimi me shkrim deri në shtatëdhjetë (70) pikë.
- Intervista me gojë deri në njëzetë (20) pikë
- Jetë përshkrimi (CV) i kandidatit deri në dhjetë (10) pikë.

Periudha e aplikimit të kandidatëve dhe kalendari i përafërt i procedurës së rekrutimit.

Konkursi mbetet i hapur pesëmbëdhjetë (15) ditë kalendarike nga dita e publikimit të të njëjtit. Shpallja është e hapur nga data 27.01.2026 deri me datë 10.02.2026 në ora 16:00.

Kalendari i përafërt i procedurës së rekrutimit:

- Verifikimi paraprak i aplikacioneve të kandidatëve më së largu deri me datë 18.02.2026.
- Afati për ankesë nga data 19.02.2026 deri me datë 23.02.2026.
- Periudha e kandidatëve kur do t'i nënshtrohen testit me shkrim, dhe kur do të bëhet vlerësimi i tyre do të jetë më së largu deri me datë 05.03.2026.
- Afati për ankesë nga data 06.03.2026 deri me datë 09.03.2026.
- Periudha e kandidatëve kur do t'i nënshtrohen intervistës me gojë, dhe kur do të bëhet vlerësimi i tyre do të jetë më së largu deri me datë 16.03.2026.
- Afati për ankesë nga data 17.03.2026 deri me datë 19.03.2026.
- Publikimi i rezultateve përfundimtare në lidhje me kandidatin e suksesshëm është më së largu 26.03.2026.

- Formulari për aplikim i N.P.L "Përparimi" Sh. A - Vushtri.;
- Dëshmitë për kualifikimin shkollor (e skanuar);
- Ekstraktin e lindjes; (certifikata e nxjerrë online në platformën e-Kosova do të pranohet);
- Certifikatën mbi dënimin penal të lëshuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, se nuk ka dënime penale në evidencën qendrore penale të Republikës së Kosovës (certifikata e nxjerrë online në platformën e-Kosova do të pranohen);
- Dëshmitë për përvojën e punës (të skanuara) (nuk është obligative);
- Kopjen e letërnjoftimit (e skanuar);

Kriteret e përgjithshme që duhet t'i plotësojnë të gjithë kandidatët.

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës.
- Të ketë zotësi të plotë veprimi.
- Të zotërojë të paktën njërën nga gjuhët zyrtare në pajtim me Ligjin për Gjuhët.

Mënyra e vlerësimit të kandidatëve.

- Testimi me shkrim deri në shtatëdhjetë (70) pikë.
- Intervista me gojë deri në njëzetë (20) pikë
- Jetë përshkrimi (CV) i kandidatit deri në dhjetë (10) pikë.

Periudha e aplikimit të kandidatëve dhe kalendari i përafërt i procedurës së rekrutimit.

Konkursi mbetet i hapur pesëmbëdhjetë (15) ditë kalendarike nga dita e publikimit të të njëjtit. Shpallja është e hapur nga data 27.01.2026 deri me datë 10.02.2026 në ora 16:00.

Kalendari i përafërt i procedurës së rekrutimit:

- Verifikimi paraprak i aplikacioneve të kandidatëve më së largu deri me datë 18.02.2026.
- Afati për ankesë nga data 19.02.2026 deri me datë 23.02.2026.
- Periudha e kandidatëve kur do t'i nënshtrohen testit me shkrim, dhe kur do të bëhet vlerësimi i tyre do të jetë më së largu deri me datë 05.03.2026.
- Afati për ankesë nga data 06.03.2026 deri me datë 09.03.2026.
- Periudha e kandidatëve kur do t'i nënshtrohen intervistës me gojë, dhe kur do të bëhet vlerësimi i tyre do të jetë më së largu deri me datë 16.03.2026.
- Afati për ankesë nga data 17.03.2026 deri me datë 19.03.2026.
- Publikimi i rezultateve përfundimtare në lidhje me kandidatin e suksesshëm është më së largu 26.03.2026.

Lumë's Details
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lumë's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi



U osnovu člana 8, člana 10 stav 2.2 i člana 15 Zakona o radu br. 03/L-212 objavljenog u Službenom glasniku Republike Kosovo od 01.12.2010, člana 7 Administrativne upute MFPT br. 01/2024 o uređenju postupaka konkursa u javnom sektoru, koji je dio Zakona o radu br. 03/L-212 objavljenog u Službenom glasniku Republike Kosovo od 11.03.2024, člana 18 i člana 22 Pravilnika br. 13/25 o unutrašnjoj organizaciji i sistematizaciji radnih mjesta, donijetog od strane Upravnog odbora J.P. "Perparimi" Sh. A, i na osnovu odluke br. Protokola ____/26, a na osnovu rješenja br. protokola 45/26 od **26.01.2026**, godine glavnog izvršnog direktora, N.P.L. "Perparimi" Sh. A od **26.01.2026**, saopštava:

JAVNI KONKURS

- I. Naslov:** Skupljač otpada – Fizički radnik
Broj izvršilaca: 1
Radno vrijeme: 40 časova nedeljno
Trajanje termina: Na određeno vreme od jedne (1) godine, od čega će šest (6) meseci biti probni rad, sa mogućnošću produženja.
Stručna priprema: Osnovna škola
Radno iskustvo: Preferira se jedna godina
Izveštava: Menadžer Jedinice za prikupljanje i transport otpada
Iznos mjesečne plate: 457.87 Euro bruto

Opis radnih obaveza i odgovornosti:

- Obavlja sve poslove prikupljanja i utovara otpada.
- Skuplja otpad i prazni kontejnere i druge posude za otpad ili kese od korisnika usluga u privatnom i državnom sektoru.
- Nakon praznjenja kontejnera i drugih posuda, dužan je da ih vrati na određena mjesta i da vodi računa o njima.
- Odgovoran je za efikasno i kvalitetno obavljanje poslova, kao i za korektno ponašanje prema građanima-korisnicima usluga.
- Za svoj rad odgovara Menadžeru Jedinice za prikupljanje i transport otpada.

Uz prijavu je potrebno priložiti sljedeće:

- Formular za prijavu J.P. "Perparimi" Sh. A - Vučitrn;
- Dokaz o školskoj kvalifikaciji (skenirana kopija);

- Izvod iz matične knjige rođenih (online sertifikat sa platforme e-Kosova će biti prihvaćen);
- Potvrdu o nekažnjavanju izdatu od Vijeća sudova Kosova, koja potvrđuje da nema krivičnih osuda u centralnoj evidenciji Republike Kosovo (online sertifikat sa platforme e-Kosova će biti prihvaćen);
- Dokaz o radnom iskustvu (skenirana kopija) (nije obavezno);
- Kopija lične karte (skenirana kopija).

➤ Dokumenti potrebni prije zasnivanja radnog odnosa:

- Da bude državljanin Republike Kosovo.
- Da ima punu poslovnu sposobnost.
- Da govori barem jedan od službenih jezika u skladu sa Zakonom o jezicima.

➤ Način vrednovanja kandidata.

- Pismeni test do sedamdeset (70) bodova.
- Usmeni intervju do dvadeset (20) bodova
- CV kandidata do deset (10) bodova.

➤ Rok za prijavu kandidata i okvirni kalendar procedure zapošljavanja.

Konkurs ostaje otvoren petnaest (15) kalendarskih dana od dana objavljivanja. Oglas je otvoren od **27.01.2026** do **10.02.2026** u 16:00 sati.

Okvirni kalendar procedure zapošljavanja:

- Prethodna verifikacija prijava kandidata najkasnije do **18.02.2026**.
- Rok za žalbu je od **19.02.2026** do **23.02.2026**.
- Period kada će kandidati polagati pismeni test, i kada će biti obavljena njihova evaluacija, biće najkasnije do **05.03.2026**.
- Rok za žalbu je od **06.03.2026** do **09.03.2026**.
- Period kada će kandidati obaviti usmeni intervju i kada će biti obavljena njihova evaluacija biće najkasnije do **16.03.2026**.
- Rok za žalbu je od **17.03.2026** do **19.03.2026**.
- Objavljivanje konačnih rezultata za uspješnog kandidata najkasnije do **26.03.2026**.

Okvirni kalendar postupka zapošljavanja može biti duži ili kraći, u zavisnosti od toga da li je pritužba podneta ili ne, a u zavisnosti od rada komisije za evaluaciju i kadrovske službe. U svim slučajevima kada se pritužba podnese u bilo kojoj fazi postupka zapošljavanja, žalba će imati suspenzivno dejstvo, sve dok istu ne razmotri Komisija za žalbe.

➤ Kako se prijaviti i komunicirati sa kandidatima

Zainteresovani kandidati mogu dobiti prijavni formular u Arhivu N.P.L. "Perparimi" Sh. A u gradu Vučitrnu, ul. "Gjergj Kastriot Skënderbeu" br. 82, (bivša zgrada TMK kod Osnovnog suda u Mitrovici – filijala u Vučitrnu) svakog radnog dana od 08:00 do 16:00 časova. Kadrovska služba za sprovođenje člana 8 st. 3 Uputstva MFPT-br. 01/2024 za Uređenje konkursnih procedura u javnom sektoru, daće potrebna pojašnjenja za kandidate u vezi sa kriterijumima javnog konkursa, te pomoći i dati potrebna uputstva za prijavu putem elektronske adrese.

Podnošenje prijave sa svom potrebnom dokumentacijom u ovom javnom oglasu vrši se isključivo putem elektronske adrese: hrperparimi@gmail.com .

N.P.L. "Perparimi" Sh. A u Vučitrnu nudi jednake mogućnosti zapošljavanja za sve građane Republike Kosovo.

Sva komunikacija tokom postupka javnog nadmetanja odvijat će se putem elektronske komunikacije.

Napomena: Prijave dostavljene nakon navedenog roka neće biti prihvaćene.

➤ Objašnjenje:

Preduzeće ima za cilj da razjasni pitanje termina koji se koriste u rodnom kontekstu, gde reči i naslovi jednog roda uključuju i drugi rod.

➤ Zaključak:

N.P.L. "Perparimi" Sh. A u Vučitrnu pruža jednake mogućnosti zapošljavanja za sve građane Republike Kosovo, a posebno ohrabruje pripadnike manjinskih zajednica, osobe sa invaliditetom i manje zastupljeni pol da se prijave.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Genius Connect” Sh.P.K. me seli në Fushë Kosovë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb UNIK: 812293025 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Genius Connect D.O.O. od Kosova Polje, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 812293025 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “Genius Connect” L.L.C. with headquarters Fushë Kosova, has come to the decision to quit its business: 812293025 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Ballkan Darabuka Dj Nicky” Sh.P.K. me seli në Mitrovicë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb UNIK: 811945312 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Ballkan Darabuka Dj Nicky” D.O.O. od Mitrovica, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811945312 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “Ballkan Darabuka Dj Nicky” L.L.C. with headquarters Mitrovica, has come to the decision to quit its business: 811945312 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “RAHAMOBISHOP” Sh.P.K. me seli në Prishtinë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb UNIK: 812220333 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “RAHAMOBISHOP” D.O.O. od Prishtina, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 812220333 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “RAHAMOBISHOP” L.L.C. with headquarters Prishtina, has come to the decision to quit its business: 812220333 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

“Palma” SH.P.K. me numër Unik Identifikues: 810679417, Gjilan me pronar Ekrem Shahini bënë shpallje në gazetë për zvogëlim të kapitalit nga 1759953.92 Euro në 4000 Euro.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Enkela Gashi shpall të pavlefshme dëftesat, certifikatën, diplomën QK “11 Marsi” Prizren.

- Belkize Krasniqi shpall te pavlefshme diplomën shme “Ymer Prizreni” Prizren.

- Dafina Gashi shpall të pavlefshme dëftesat e vitit XI , XII shme “Ymer Prizreni” Prizren.

- Nazmi Krasniqi shpall të pavlefshme certifikatën QK “11 Marsi” Prizren.

- Mesude Dogani shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - IX shfmu “Mati Logoreci” Prizren.
- “FAR” SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. Unik Identifikues: 810155722.

- Fitore Rexhepi shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore “Fazli Greiçevci”.

- Maurita Koca nga Bishtazhini KK Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e kl.10 të Gjimnazit “Hajdar Duishi” Gjakovë.

- Bedri Zeneli nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12 dhe diplomën dhe certifikatën e notave të Gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.

MEKA
®
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992





ROYAL CROWN

RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

Columbus, Georgia, USA
Since 1904

Columbus, Georgia, USA
0.5L

Osmani thekson rëndësinë e konstituimit sa më të shpejtë të institucioneve

PRISHTINË, 26 JANAR - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, priti sot në takim shefin e Misionit të OSBE-së në Kosovë, ambasadorin Gerard McGurk, me të cilin diskutoi për zhvillimet e fundit politike dhe institucionale në Kosovë.

Gjatë takimit u diskutua për procesin e zgjedhjeve parlamentare të 28 dhjetorit, ndaj në këtë kontekst, presidentja theksoi rëndësinë e konstituimit sa më të shpejtë të institucioneve. Më tutje, presidentja Osmani

dhe ambasadori McGurk diskutuan edhe rëndësinë e bashkëpunimit të vazhdueshëm midis institucioneve të Kosovës dhe OSBE-së në funksion të forcimit të demokracisë dhe sundimit të ligjit.



NETANYAHU PRET RAMËN NË JERUSALEM: PËRFAQËSONI SHPIRTIN E VËRTETË TË SHQIPËRISË

TIRANË, 26 JANAR - Kryeministri i Izraelit, Benjamin Netanyahu, ka pritur në Jerusalem kryeministrin e Shqipërisë, Edi Ramën, të cilin e quajti një mik të madh të tijin personal dhe të Izraelit. “Kryeministri Rama është mik i madh i popullit dhe shtetit hebre dhe një mik i madh i imi. Ai përfaqëson shpirtin e vërtetë të Shqipërisë”, tha Netanyahu. Ai gjithashtu përmendi faktin historik të mbrojtjes së hebrenjve nga shqiptarët gjatë Luftës II Botërore. “Bota duhet ta dijë që Shqipëria ishte i vetmi vend

evropian ku u rrit popullsia hebre u rrit dhe nuk u mpak. Sepse populli shqiptar, myslimanët shqiptarë, në frymën e moderimit dhe tolerancës, dinjitetit njerëzor, mbrojtën qindra hebrenj që jetonin asokohe në Shqipëri dhe mikpritjen e mijëra të tjerëve. Kjo është histori që frymëzon filma. Kjo është ajo frymë që ju vazhdoni ta kultivoni edhe sot. Ju qëndroni me kurajë kundër atyre që duan t’iu zmbriapsin, qëndroni krah të vërtetës, ju qëndruat krah të vërtetës kur u sulmuam nga barbarët. Busulla juaj morale nuk u



lëkund. Kjo ju shënon si një udhëheqës të jashtëzakonshëm të popullit tuaj”, shtoi ai. Netanyahu tha se mes dy shteteve po ndërtohen marrëdhënie të shkëlqyera. “Numri i turistëve izraelitë që kanë shkuar në Shqipëri është rritur me 800 %. Mund t’u them të gjithë izraelitëve që Shqipëria është vend i mrekullueshëm, kështu që shkoni atje”, u shpreh ai. Kryeministri izraelit njoftoi edhe hapjen e Dhomës së përbashkët të Tregtisë në Jerusalem, e cila sipas tij do të çojë përpara lidhjet ekonomike mes dy vendeve.

TË PAKTËN 11 TË VDEKUR NË SHBA SI PASOJË E STUHSË DIMËRORE



NJU-JORK, 26 JANAR - Një stuhi e rrezikshme dimërore i ka mbështjellë Shtetet e Bashkuara, duke lënë të paktën 11 persona të vdekur. Mijëra persona raportohet të kenë mbetur pa energji elektrike. Shumë shkolla dhe rrugë nëpër ShBA janë mbyllur ndërsa mbi 11 mijë fluturime janë anuluar për shkak të kushteve “të rrezikshme për jetë”, sipas Shërbimit Kombëtar për Motin. Kryetari i Qytetit të Nju-Jorkut, Zohran Mamdani, ka thënë se

pesë persona kanë vdekur si pasojë e motit. Të paktën dy persona kanë vdekur si pasojë e hipotermisë në Luizianë dhe vdekje tjera të lidhura me stuhinë janë raportuar në Teksas, Tenesi dhe Kansas. Autoritetet kanë paralajmëruar se mund të ketë reshje të shumta të borës dhe akull të zi për disa ditë. Stuhia besohet se ka prekur mbi 180 milionë amerikanë - që do të thotë më shumë se gjysmën e popullsisë. Kryetari i qytetit të Nju-Jorkut, Zohran Mamdani, ka thënë


përmes një postimi në “X” që të paktën tetë persona kanë vdekur të shtunën, mirëpo shkaqet nuk janë përcaktuar ende. Ekspertë për motin kanë paralajmëruar që njëra prej rreziqeve më të mëdha të stuhisë është akulli, i cili mund t’i dëmtojë drunjtë, t’i shkatërrojë kabllot e energjisë dhe t’i bëjë rrugët të pasigurta. Ata besojnë se ndryshimet klimatike mund të kenë ndikuar në ashpërsimin e kushteve klimatike të çdo stine.

Alarm ekonomik: Mbi një miliard dollarë humbje në ditë nga bllokadat në kufijtë e Ballkanit Perëndimor

PRISHTINË, 26 JANAR - Aleanca Kosovare e Bizneseve (AKB) paralajmëron se bllokadat kufitare të krijuara pas zbatimit të Sistemit EES nga BE-ja po shkaktojnë humbje mbi 1 miliard dollarë në ditë në qarkullimin e mallrave ndërmjet Ballkanit Perëndimor dhe BE-së. “Kamionë të bllokuar, mallra

të vonuara, biznese në humbje. Transportuesit dhe bizneset po paguajnë çmimin e një sistemi të paadaptuar për realitetin e rajonit. Protestat e sotme janë pasojë e drejtpërdrejtë e këtyre barrierave që po godasin ekonominë rajonale. AKB-ja kërkon urgjentisht: zbatim fleksibil të EES për Ballkanin

Perëndimor kapacitete shtesë në pikat kufitare dialog të menjëhershëm me transportuesit dhe bizneset. Çdo ditë vonësë humbje të reja milionëshe dhe miliardëshe. AKB do të vazhdojë të jetë zëri i bizneseve transportuesve dhe EU mos të jetë pengesa”, thuhet në reagimin e AKB-së.



Kosova lanson Rrjetin e parë të Grave në Siguri, nënshkruhen memorandumet

PRISHTINË, 26 JANAR - Fondacioni Jahjaga ka lansuar të hënën Rrjetin e Grave në Siguri, i cili synon të jetë mekanizëm mbështetës që plotëson strukturat ekzistuese institucionale të sigurisë. “Sot, Fondacioni Jahjaga shënoi një hap të rëndësishëm në fushën e sigurisë duke lansuar Rrjetin e Grave në Sektorin e Sigurisë në Kosovë. Ky projekt i mbështetur nga Mbretëria e Holandës u formalizua nëpërmjet nënshkrimit të memorandumëve të mirëkuptimit mes Fondacionit



Jahjaga të përfaqësuar nga Kosovës, Policinë e Kosovës,
drejtoresha ekzekutive znj. Inspektoratin Policor të
Bexheti me Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe Shërbimin

Korrektues të Kosovës”, ka njoftuar në “Facebook”, ish-presidentja e Kosovës, Atifete Jahjaga.

Ajo ka theksuar se kjo nismë është pjesë e angazhimit për Agjendën e Grave, Paqes dhe Sigurisë, në përputhje me Rezolutën 1325 të OKB-së, dhe me mbështetjen e çmuar të Mbretërisë së Holandës, përmes Fondit MATRA dhe Human Rights Fund, si dhe bashkëpunimit me institucionet vendore dhe partnerët ndërkombëtarë. “Ky rrjet synon të fuqizojë

bashkëpunimin profesional, ndarjen e përvojave dhe rolin e grave në institucionet e sigurisë. Shpreh mirënjohje të veçantë për Mbretërinë e Holandës për mbështetjen e vazhdueshme dhe për të gjithë partnerët institucionalë për gatishmërinë dhe bashkëpunimin për realizimin e kësaj iniciative. Ndryshimi i vërtetë fillon kur vendosim të mos punojmë më vetëm, por së bashku. Pasi kur punojmë së bashku, forcojmë gratë, institucionet dhe vetë sigurinë e Kosovës”, ka thënë Jahjaga.

MINISTRI VENÇU: MARRËVESHJA SHQIPËRI-KOSOVË-KROACI KUNDËR ASKUJT

**EPOKA
ERE**

Faton DËRMAKU

TI RANË, 26 JANAR - Ministri i Mbrojtjes i Shqipërisë, Pirro Vengu, tha se marrëveshja në fushën e mbrojtjes mes shtetit të tij, Kosovës dhe Kroacisë nuk është kundër askujt, as ndaj Serbisë, të cilën tha se e ka ftuar që t'i bashkohet. Kjo deklaratë vjen pasi ai u pyet për të komentuar deklaratat e bëra më herët nga presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, se kjo marrëveshje - e arritur në mars të vitit 2025 - është kundër serbëve, dhe këto shtete janë pjesë e një "aleance sulmuese". Edhe kur u nënshkrua marrëveshja për bashkëpunim në fushën e mbrojtjes, Serbia kishte reaguar ashpër, duke e cilësuar si një nismë kundër saj. Vengu tha se ka vërejtur që herë pas here "ka një sens paniku" në deklaratat zyrtare nga Serbia për këtë temë. "Ajo që mund t'iu them është që kjo është një marrëveshje trepalëshe e cila nuk është ndërtuar kundër askujt. Madije kam qenë unë i pari që kam shprehur ftesën pse jo që në qoftë se Serbia e gjykon që rajoni, stabiliteti, qëndrueshmëria dhe e ardhmja euroatlantike e vendeve të rajonit është e rëndësishme, atëherë pse jo edhe Serbia t'i bashkëngjitet kësaj iniciative. Ua merr mendja që nuk kam



marr përgjigje për sa i përket kësaj ftese”, tha ai.

Vengu, në një konferencë për media më 26 janar, tha se Shqipëria dhe Kosova kanë filluar “në bazë të kësaj marrëveshjeje, qoftë në rrafshin ushtarak, stërvitor, akademik-arsimor, por edhe të prodhimit ushtarak, të bashkëpunojnë”. Sipas tij, me Prishtinën, Tirana ka pajtëm s ai përket prodhimit

të mjeteve të blinduara, pasi që,
vlerësoi ai, të dy shtetet i shohin
njësojë kërcënimet dhe rreziqet
që i kanosen rajonit. “E dyta,
nuk besoj se Kroacia, Shqipëria
dhe Kosova, kanë nevojë të
marrin leje për saj i përket kësaj
pjesë. E treta, mirëpresim edhe
vende të tjera të na bashkohen.
Pra, është një bashkëpunim dhe
partneritet i hapur. Shumëkush
e quan aleancë, shumëkush

marrëveshje të mbrojtjes. Nuk jemi në situata të garancive të mbrojtjes”, tha Vengu. Sipas udhëheqësit të fushës së mbrojtjes në Shqipëri, të tri shtetet marrin më të mirat nga njëra-tjera me këtë marrëveshje. “Kroacia është vend lider në Evropë sa i përket dronëve të vegjël luftarakë dhe ka një industri të konsoliduar, si kundër edhe ne synojmë që në

pjesën e mjeteve taktike dhe të blinduara të krijojmë një epërsi dhe të mund të fillojmë të eksportojmë”, u shpreh ai.

Në fillim të janarit, Vuçiqi i akuzoi të tri shtetet se kanë krijuar një aleancë ushtarake dhe sulmuese, që sipas tij, është kundër serbëve. “Kjo është një aleancë sulmuese. Ka njerëz që ëndërrojnë se kur ka konflikt midis pjesëve të Perëndimit dhe Rusisë, kjo është një mundësi për ish-aleatët rusë, si ne, që të shkatërrohen plotësisht”, u shpreh presidenti serb.

Kroacia i është kundërpërgjigjur duke thënë se, si shteti anëtar i Bashkimit Evropian, bën thirrje për bashkëpunim dhe paqe në rajonin e Ballkanit Perëndimor. “Kroacia është anëtare e Bashkimit Evropian dhe gjithçka që bën në marrëdhëniet ndërkombëtare e bën në mënyrë transparente”, tha ministri i Punëve të Brendshme të Kroacisë, Davor Bozhinoviç.

Kroacia dhe Shqipëria janë pjesë e aleancës ushtarake perëndimore të NATO-s, aty ku Kosova shpreson të anëtarësohet.

Në kuadër të marrëveshjes së arritur, shtetet parashohin promovim të kapaciteteve mbrojtëse dhe bashkëpunimit, ndërveprimin përmes edukimit, trajnimit dhe kundërpërgjigje ndaj kërcënimeve hibride.

Shefi i Misionit të OSBE-së përgëzon KQZ-në për organizimin e procesit zgjedhor

PRISHTINE, 26 JANAR -
Kryesuesi i Komisionit
Qendror të Zgjedhjeve,
Kreshnik Radoniqi, ka pritur
në takim shefin e Misionit të
OSBE-së në Kosovë, Gerard
McGurk. Gjatë takimit,
Radoniqi e njoftoi
ambasadorin McGurk për
aktivitetet që aktualisht po i
zhvillon Komisioni Qendror i
Zgjedhjeve në drejtim të

përmbylljes së procesit të rinumërimit të vendvotimeve dhe shpalljes së rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve të parakohshme për Kuvendin e Kosovës. Nga ana e tij, ambasadori McGurk përgëzoi KQZ-në për organizimin e procesit zgjedhor, si dhe për hapat e ndërmarrë në evidentimin e problemeve gjatë procesit të

numërimin të votave për kandidatët për deputetë. Ai theksoi përkushtimin e KQZ-së në mbrojtjen e integritetit të votës dhe rezultateve zgjedhore. Në fund të takimit, Radoniqi dhe McGurk u pajtuan për hapat e ardhshëm të bashkëpunimit ndërmjet KQZ-së dhe Misionit të OSBE-së në Kosovë.





MES RRRITJES SË ÇMIMEVE, QYTETARËT HAPIN KULETAT EDHE PËR PARTITË

Pavarësisht prej rritjes së çmimeve dhe inflacionit, qytetarët në Kosovë vazhdojnë të dhurojnë para për partitë politike gjatë fushatave zgjedhore. Ekspertët paralajmërojnë se donacionet shpesh nuk burojnë vetëm nga bindja politike, por edhe nga pritjet për favore

PRISHTINË, 26 JANAR - Ndërsa disa qytetarë të Kosovës ankohen për çmime të larta dhe vështirësi për t'i përballuar shpenzimet mujore, të tjerë vazhdojnë t'i hapin kuletat sa herë që vendi hyn në fushatë zgjedhore. Edhe zgjedhjet e fundit lokale, të mbajtura më 12 tetor dhe raundi i dytë më 9 nëntor 2025, nuk bënë përjashtim. Nga 10 deri në 2 000 euro - kaq dhuruan dhjetëra qytetarë, anëtarë dhe simpatizantë për partitë më të mëdha politike në vend: Lëvizjen Vetëvendosje, Partinë Demokratike të Kosovës, Lidhjen Demokratike të Kosovës e Aleancën për Ardhmërinë e Kosovës. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) publikoi këtë muaj raportet e paaudituar të deklarimit financiar të subjekteve politike për fushatën e zgjedhjeve

lokale. Radio Evropa e Lirë kontaktoi përmes rrjeteve sociale nga dy qytetarë që dhanë donacione për Vetëvendosjen, PDK-në dhe LDK-në por, përkundër insistimit, asnjëri nuk pranoi të përgjigjej nëse gjesti i tyre ishte thjesht mbështetje e singertë politike, apo kishte ndonjë arsye tjetër.

Donacione që nuk janë gjithmonë mbështetje politike

Sipas përfaqësuesve të shoqërisë civile dhe ekspertëve të ekonomisë, dhënia e parave për partitë politike nuk buron gjithmonë nga bindja ideologjike. Altin Ademi nga organizata anti-korrupsion "Çohu" thotë se,

ndonëse një pjesë e qytetarëve kontribuojnë si shprehje e mbështetjes politike, mungesa e një tradite të qartë të profilizimit programor i bën këto donacione të perceptohen si investim për favore të ardhshme. "Në një kontekst ku besimi institucional është i brishtë, donacionet mund të shihen edhe si mënyrë për të ruajtur afërsinë me pushtetin apo për të krijuar pritje për përfitime - të drejtpërdrejta ose indirekte. Për këtë arsye, dhënia e donacioneve nuk është gjithmonë shprehje e pastër e bindjes politike", thotë Ademi për Radion Evropa e Lirë. Edhe profesori i Ekonomisë, Shkumbin Misini, vlerëson se motivet janë të ndryshme: nga pritjet për punësim në institucione publike deri tek "obligimi" ndaj partisë që i ka punësuar më herët. "... e një grup

më i vogël për shkak të lidhjes dhe besnikërisë ndaj liderit të partisë", sipas tij.

Sa mblodhën dhe sa shpenzuan partitë?

Sipas raporteve të KQZ-së, Lëvizja Vetëvendosje, si partia më e madhe në vend, grumbulloi 36.680 euro nga donacionet e qytetarëve. Pjesën më të madhe të financimit, ajo e kishte nga buxheti i shtetit - rreth 567 mijë euro. Por, shpenzimet e fushatës së saj arritën në rreth 992 mijë euro, ndaj partia mbeti me një borxh prej afro 388 mijë eurosh. PDK-ja mblodhi mbi 25 mijë euro donacione nga qytetarët, si dhe 223 mijë euro kontribute në mallra dhe shërbime. Në total, kjo parti kishte rreth 248 mijë euro në dispozicion, ndërsa fushata i kushtoi rreth 272 mijë euro. LDK-ja raportoi vetëm 7.750 euro donacione nga qytetarët dhe 15.790 euro kontribute - gjithsej 23.540 euro, ndërsa fushata i kushtoi rreth 203 mijë euro.

AAK-ja përfitoi vetëm 1.000 euro donacion nga një anëtar dhe 5.200 euro kontribute në mallra dhe shërbime, si dhe rreth 80 mijë euro nga buxheti i shtetit. Shpenzimet e fushatës i kishte mbi 61 mijë euro. Lista Serbe - partia më e madhe e serbëve në Kosovë - nuk raportoi as donacione e as kontribute, por shpenzoi rreth 334 mijë euro, prej të cilave 155 mijë i paraqiti si të hyra buxhetore.

Raporte që nuk pasqyrojnë realitetin?

Sipas Ademit dhe Misinit, vlerat e raportuara shpesh nuk reflektojnë gjendjen reale në terren. "Ekziston rreziku që donacionet individuale të përdoren si mbulesë për burime të tjera financimi, përmes ndarjes së shumave të mëdha në donacione më të vogla ose përdorimit të personave të tretë", paralajmëron Ademi. Misini shton se praktika të tilla janë të pranishme në Kosovë dhe se përbëjnë rrezik serioz për integritetin e procesit zgjedhor.

ÇFARË TREGON RINUMËRIMI I VOTAVE DERI TANI?

PRISHTINË, 26 JANAR - Derisa rinumërimi i votave të zgjedhjeve të parakohshme të dhjetorit po vazhdon në gjithë Kosovën dhe tashmë ka arritur në gjysmë të rrugës, dyshimet dhe hetimet për manipulim të votave janë duke u zgjeruar njëherazi edhe në pjesë të tjera të vendit.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve njoftoi të shtunën se janë rinumëruar mbi 55 për qind të votave në 2.557 vendvotime në mbarë vendin.

Rinumërimi nisi më 13 janar, fillimisht pjesërisht, pasi komisioni kishte gjetur mospërputhje në votat për kandidatët për deputetë të Kuvendit të Kosovës.

Por, kur mospërputhjet në vota u vërtetuan dhe dyshimet sa vinin e shtoheshin, autoritetet për zbatim të ligjit filluan të ndërmarrin masa.

Të dielën Gjykata Themelore në Prizren urdhëroi nga një muaj paraburgim për 23 të dyshuar për një sërë veprash penale lidhur me keqpërdorimin e votave, dy ditë pasi mbi 100 persona u arrestuan në këtë rajon.

Çfarë solli rinumërimi deri tani?

Nga rinumërimi i votave në mbi gjysmën e vendvotimeve deri tani, rreth 80 mijë vota të kandidatëve kanë rezultuar të pasakta dhe të numëruara gabimisht në Qendrat Komunale të Numërimit, sipas Eugen Cakollit nga organizata joqeveritare, Instituti Demokratik i Kosovës. “Prej tyre, pas rinumërimit, 47.619 vota u janë hequr kandidatëve (sepse u ishin shtuar gjatë numërimit



fillestar), ndërsa 32,018 vota u janë shtuar kandidatëve pas rinumërimit (sepse u ishin hequr në mënyrë të parregullt më herët)”, shkroi Cakolli në Facebook të premten.

Sipas tij, nga rreth 80.000 vota të prekura, afërsisht 40.000 i takojnë kandidatëve të Partisë Demokratike të Kosovës (DPK), rreth 15.000 partisë në pushtet Lëvizja Vetëvendosje (IV), rreth 11.000 Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) dhe rreth 4.000 Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK).

Mbi 80 për qind e këtyre votave vijnë vetëm nga komuna e Prizrenit, ndërsa pjesa tjetër nga Malisheva dhe Podujeva (në këtë të fundit janë rinumëruar vetëm 10 për qind të votave), shtoi Cakolli.

Rinumërimi i deritanishëm solli edhe veprime të autoriteteve për

zbatimin e ligjit në vend, pasi përveç Prizrenit, ato kanë zgjeruar hetimet edhe në Ferizaj dhe Malishevë.

Në ditët e fundit, prokurorët në Ferizaj dhe Gjakovë autorizuan Policinë të ndërmarrë të gjitha veprime, përfshirë identifikimin e personave përgjegjës, grumbullimin e të dhënave dhe sigurimin e provave në Ferizaj dhe Malishevë, lidhur me dyshimet për manipulim të votave.

Aksioni në Prizren

Autoritetet e kryen një aksion të premten në Prizren, komunën ku dyshohet se kishte më së shumti keqpërdorim të votave, duke i ndaluar 109 të dyshuar. Dy ditë më vonë, gjykata e pranoi kërkesën e prokurorëve për t'i dërguar në paraburgim 22

komisionarë dhe një vëzhgues të zgjedhjeve të 28 dhjetorit.

Gjykata tha të dielën se ata dyshohen për disa vepra penale, përfshirë atë kundër të drejtës së votimit, kanosjen, marrjen e ryshfetit dhe dhënien e ryshfetit. Dy ditë më parë, kryeprokurori i Prokurorisë Themelore në Prizren, Petrit Kryeziu, tha se në mesin e të arrestuarve në Prizren kishte edhe familjarë të kandidatëve për deputetë.

Sipas Kryeziut, një manipulim i tillë i votave nuk ka mundur që të ndodhë pa një kompromis mes komisionarëve të katër partive më të mëdha politike. “Po flasim për komunën e Prizrenit që janë shtuar hiç më pak se 40.497 vota dhe janë hequr hiç më pak se 27.520 vota. Pra, diferenca totale e keqpërdorimeve është 68.017 vota”, tha Kryeziu.

Reagimet

Teksa shumica e liderëve të partive të mëdha kishin reaguar pak pasi kishin dalë në sipërfaqe dyshimet për keqpërdorim të votave javë më parë, kryeministri në detyrë i Kosovës, Albin Kurti, njëherësh lider i partisë në pushtet, reagoi tek të shtunën.

Kurti bëri thirrje për hetim gjithëpërfshirës dhe ndëshkim për personat e dyshuar për manipulim të votave brenda partive politike.

Kurti, i cili paraprakisht ishte kritikuar për mosreagim - tha të shtunën në “Facebook” se “komisionerë e individë, që në mënyrë klandestine, janë përfshirë në manipulime votash brenda subjekteve politike duke dëmtuar kolegë e subjekte politike nuk kanë amnisti”.

Më herët, kryetari i PDK-së, Bedri Hamza, e kishte përshkruar rinumërimin si “hap të domosdoshëm dhe të drejtë” për mbrojtjen e integritetit të procesit zgjedhor.

Udhëheqësit e LDK-së dhe AAK-së, Lumir Abdixhiku dhe Ramush Haradinaj, kishin kërkuar më herët gjithashtu rinumërim të plotë, duke theksuar se vetëm ashtu mund të garantohej legjitimiteti i rezultateve.

Ndërkohë, edhe shumica e kandidatëve për deputetë të cilëve u janë hequr më së shumti vota gjatë rinumërimit, e kanë mohuar të kenë pasur gisht në keqpërdorim dhe kanë thënë se e dënojnë këtë dukuri.

Në Kosovë manipulimi i votave është vepër penale e dënueshme me burgim.

Megjithatë, së voni organizata joqeveritare, ÇOHU, e publikoi një hulumtim që tregoi se mbi 90 për qind e rasteve për manipulime zgjedhore përfundojnë me dënime me kusht ose gjoba.

“Forma më e zakonshme përfshin para të gatshme, pastrim të tyre, shpërndarje në emra të ndryshëm dhe depozitim në llogari të punëtorëve”, thotë ai. Kjo, sipas Misinit, krijon edhe një varësi të fshehtë të politikave nga grupet e interesit, si dhe cenon transparencën dhe llogaridhënien.

Në këtë kontekst, të dy ekspertët thonë se financimi i partive politike mbetet një nga fushat më të ndjeshme për demokracinë në Kosovë.

Pa transparencë reale, mbikëqyrje institucionale dhe informim të vazhdueshëm të publikut, rreziku i ndikimit të grupeve të interesit mbetet i lartë, thonë ata.

Në raportin e vitit të kaluar të organizatës Transperency International vlerësohej se Kosova ka bërë përparim të lehtë në luftën kundër korrupsionit, ndërsa më 2023, vendi u përmend në raport të Departamentit amerikan të Shtetit për korrupsion qeveritar.

Financimi i partive politike edhe në botë

Financimi i partive politike nga individë nuk është praktikë vetëm e Kosovës.

Në shumicën e demokracive perëndimore, qytetarët kanë të drejtë ligjore t'i mbështesin financiarisht partitë apo kandidatët që përfaqësojnë bindjet e tyre politike.

Në Shtetet e Bashkuara, për shembull, individët mund të japin mijëra dollarë për kandidatët presidencialë, kongresistët apo partitë politike, ndërsa ligji u lejon edhe krijimin e të ashtuquajturave Political Action Committees (PACs), të cilat mund të mbledhin shuma shumë të mëdha për të mbështetur fushatat.

Edhe pse këto struktura janë ligjore, ato janë shpesh objekt kritikash, pasi donatorët e mëdhenj - biznesmenë, korporata apo individë me

ndikim - mund të ushtrojnë presion jodirekt mbi politikat publike.

Në Kosovë, subjektet politike janë të obliguara me ligj që raportin financiar të fushatës ta dorëzojnë në KQZ jo më vonë se 30 ditë pas certifikimit të rezultateve përfundimtare. Sipas ekspertëve, sfida për vendin nuk është ndalimi i donacioneve, por ndërtimi i një sistemi ku çdo euro e dhënë për politikën, është e verifikueshme dhe e arsyetueshme për publikun.

Ky diskutim zhvillohet ndërsa Kosova, për gati një vit, funksionon me institucione në detyrë, pa stabilitet politik dhe pa vendimmarrje të plotë.

Për më tepër, rezultatet e zgjedhjeve të parakohshme të 28 dhjetorit nuk janë certifikuar ende, pasi mospërputhjet serioze në votat për deputetë detyruan KQZ-në të urdhërojë rinumërim të plotë në të gjitha vendvotimet.

Kjo vonesë institucionale ndodh

Si financohen partitë politike?

Partitë në Kosovë financohen nga dy burime kryesore: buxheti i shtetit dhe donatorët, që përfshijnë persona fizikë dhe juridikë.

Financimi publik realizohet përmes Fondit për Mbështetjen e Subjekteve Politike, i cili është rreth pesë milionë euro.

Ndarja bëhet sipas përfaqësimit të partive në Kuvendin e Kosovës, i cili ka 120 ulëse, por, me ligj, ato kanë të drejtë të pranojnë kontribute shtesë për fushatë edhe nga personat fizikë dhe juridikë.

Personat fizikë mund të dhurojnë deri në 2.000 euro në vit, ndërsa personat juridikë deri në 10.000 euro, përfshirë edhe kontribute në mallra dhe shërbime.

Partitë në Kosovë financohen nga dy burime kryesore: buxheti i shtetit dhe donatorët, që përfshijnë persona fizikë dhe juridikë.

Financimi publik realizohet përmes Fondit për Mbështetjen e Subjekteve Politike, i cili është rreth pesë milionë euro.

Ndarja bëhet sipas përfaqësimit të partive në Kuvendin e Kosovës, i cili ka 120 ulëse, por, me ligj, ato kanë të drejtë të pranojnë kontribute shtesë për fushatë edhe nga personat fizikë dhe juridikë.

Personat fizikë mund të dhurojnë deri në 2.000 euro në vit, ndërsa personat juridikë deri në 10.000 euro, përfshirë edhe kontribute në mallra dhe shërbime.

në kohën kur qytetarët përballen me inflacion dhe kosto gjithnjë e më të larta të jetesës. Sipas Agjencisë së Statistikave të

Kosovës, çmimet e konsumit në dhjetor 2025 ishin mesatarisht 5.3% më të larta krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2024.

Kosova thekson rëndësinë e bashkëpunimit me Emiratet e Bashkuara Arabe

PRISHTINË, 26 JANAR - Zëvendësministri i Ekonomisë, Getoar Mjeku, ka pritur në takim të Ngarkuarin me Punë të Ambasadës së Emirateve të Bashkuara Arabe, Yousof Naser Abdulla Albuainain Almazrouei. Gjatë këtij takimi u diskutua për marrëdhëniet dypalëshe ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Emirateve të Bashkuara Arabe, me fokus të veçantë në mundësitë për thellimin e bashkëpunimit ekonomik dhe nxitjen e investimeve strategjike, mbi

potencialin që ofron Kosova për investitorët e huaj, veçanërisht në sektorët prioritarë të ekonomisë dhe energjisë. Zëvendësministri Mjeku theksoi rëndësinë e bashkëpunimit me Emiratet e Bashkuara Arabe, duke vlerësuar interesimin e këtij shteti për investime në Kosovë, si dhe përvojën e tij në zhvillimin e projekteve të qëndrueshme ekonomike dhe energjetike. Ai nënvizoi angazhimin e Qeverisë së Republikës së

Kosovës për krijimin e një klime të favorshme për investime, përmes reformave dhe politikave mbështetëse për investitorët e huaj. Nga ana e tij, Almazrouei shprehu gatishmërinë e Emirateve të Bashkuara Arabe për të vazhduar dhe avancuar bashkëpunimin me Kosovën, duke theksuar interesin për eksplorimin e mundësive konkrete të investimeve, veçanërisht në sektorin e energjisë dhe projekte me ndikim në zhvillimin ekonomik të vendit.



AVDULLAH HOTI THOTË SE DO TË GAROJË PËR KRYETAR TË LDK-SË

PRISHTINË, 26 JANAR - Avdullah Hoti ka bërë me dije se dëshiron ta marrë drejtimin e Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), duke thënë se “ka ardhur koha” për ta kthyer atë në forcën kryesore politike në vend. Hoti, i cili shërbeu shkurtimisht si kryeministër i Kosovës mes viteve 2020 dhe 2021, ka shkruar në “Facebook” të dielën se do ta kërkojë besimin e delegatëve të partisë në Kuvendin e LDK-së më 31 janar. Ai tha se po e bën këtë “pas dorëheqjes së kryetarit Abdixhiku për shkak të rezultatit të fundit zgjedhor”. Kryetari i tanishëm Lumir Abdixhiku pritet ta kërkojë votëbesimin e delegatëve në Kuvendin e 31 janarit, pasi më parë kishte thënë se e ka ofruar dorëheqjen por se do të largohej vetëm nëse Kuvendi i partisë voton për shkarkimin e tij.

Nuk është e qartë nëse Abdixhiku, i cili ka mandat deri më 2027 do ta humbë votëbesimin për t’i hapur rrugë garës për kryetar të partisë. Hoti shkroi se “në këtë moment vendimtar për LDK-në dhe për Kosovën, unë zotohem me përgjegjësi të plotë të marr barrën e ringritjes politike dhe organizative të partisë”. Hoti, 50 vjeç, është pjesë e LDK-së nga viti 2006 dhe, përveç si kryeministër i vendit, në të kaluarën ai ka shërbyer edhe si ministër i Financave i Kosovës. “Zotohem se askush nuk do të mbetet në margjina. Se do të ndërtojmë një LDK të hapur, të drejtë dhe konkurruese. Një LDK ku avancimi bazohet në meritë, integritet dhe përkushtim; ku profesionistët, gratë dhe të rinjtë e gjejnë hapësirën që u takon”, shkroi ai.



Ai u shpreh i bindur se brenda LDK-së potenciali “është shumë më i madh”, duke shtuar se partia duhet ta shfrytëzojë atë për t’u kthyer në “forcën politike kryesore në Republikën e Kosovës, në shërbim të qytetarëve dhe të interesit shtetëror”. LDK-ja caktoi Kuvendin e partisë për 31 janar pas një

mbledhjeje të Kryesisë javën e kaluar, ku anëtarët diskutuan për rezultatin dëshpërues në zgjedhjet e parakohshme parlamentare të 28 dhjetorit. LDK-ja, partia më e vjetër në Kosovë, është duke përjetuar një ndër periudhat më të vështira në historinë e vet, pasi zgjedhjet e dhjetorit sollën rezultatin e dytë më të

keq për të. Disa anëtarë të partisë, përfshirë Hotin dhe Hykmete Bajramin - e cila dha dorëheqje të parevokueshme nga pozita e nënkryetares të partisë - kërkuar largimin e Abdixhikut, pasi LDK-ja doli e treta duke i fituar vetëm rreth 13 për qind të votave. Pas mbledhjes së Kryesisë javën e kaluar, zyrtari i LDK-së Besian Mustafa nuk konfirmoi se do të kishte garë për kryetar të partisë në Kuvendin e 31 janarit. Duke folur në një konferencë për media, Mustafa tha se “duhet të ketë një proces tjetër për të ardhur deri të kandidaturat e tjera për të pasur një proces zgjedhor në LDK”. “Tani jemi të pjesa e votëbesimit. Do ta shohim rezultatin e votëbesimit së pari”, tha Mustafa.

PROKURORIA THEMELORE NË PRISHTINË AUTORIZON POLICINË LIDHUR ME PROCESIN E NUMËRIMIT NË DRENAS



PRISHTINË, 26 JANAR - Prokuroria Themelore në Prishtinë, Departamenti i Krimeve të Rënda, duke përcjellë në vazhdimësi procesin e rinumërimit të votave për zgjedhjet e përgjithshme të mbajtura më 28 dhjetor, ka vërejtur mospërputhje lidhur me rezultatet e kandidatëve për deputet pas përfundimit të procesit të rinumërimit në komunën e Drenasit. Marrë parasysh këtë rrethanë

prokurori i shtetit sot ka lëshuar autorizim Policisë së Kosovës me qëllim të grumbullimit të informatave dhe evidentimit të shkeljeve të mundshme nga personat përgjegjës si dhe sigurimin e provave lidhur me këtë çështje. Po ashtu, prokurori i shtetit është duke përcjellë nga afër procesin e rinumërimit edhe në komunat e tjera që bien në kompetencë të kësaj prokurorie, ndërsa pas

përfundimit të këtij procesi do të analizohen të gjitha rrethanat dhe shqyrtohet mundësia e lëshimit të autorizimeve të tjera për grumbullimin e informatave. Prokuroria Themelore në Prishtinë është e determinuar në luftimin e dukurive negative në Republikën e Kosovës, veçanërisht me rastet që kanë të bëjnë me mbrojtjen e vullnetit të qytetarëve të shprehur përmes votës së lirë.

‘Nuk po rrënon bageri, po rrënon kryetari Faton Peci’

MITROVICË, 26 JANAR - Kryetari i Mitrovicës, Faton Peci, ka njoftuar se të dielën gjatë orëve të vona të natës, kompanisë që ishte përgjegjëse për rrënimin dhe largimin e objekteve pa leje, i është djegur një mekanizëm/bager. Ai e ka dënuar ashpër këtë akt makabër e qyqar. “Ky veprim

kriminal përbën kërcënim direkt për të gjithë ata që angazhohen që Mitrovica të jetë qytet ku mbretëron rendi dhe qetësia publike. Por, të gjithë ata që me akte të tilla kriminale e kërcënuese mendojnë se na frikësojnë e kanë gabim. Lufta jonë ndaj paligjshmërisë, kriminalitetit e parregullsisë nuk do të

ndalet. Në anën tjetër, organeve të rendit ju bëj thirrje të intensifikojnë veprimet e tyre për zbardhjen sa më të shpejtë të rastit. E për të gjithë ata me këtë logjikë dua t’i siguroj se paqe me krimin nuk do të ketë asnjëherë, askund në Mitrovicë, as në jug as në veri”, ka shkruar Peci në “Facebook”.



LDK-ja të shtunën mban Kuvendin Zgjedhor, Abdixhiku: Koha të flasë anëtarësia

PRISHTINË, 26 JANAR - Kryetari i LDK-së, Lumir Abdixhiku, ka bërë me dije se partia do të mblidhet këtë të shtunë për të diskutuar dhe vendosur mbi çështjet e brendshme, duke vënë theksin te procesi demokratik dhe pjesëmarrja e lirë e anëtarësisë. Abdixhiku ka theksuar rëndësinë e hapjes dhe debatit brenda partisë. “LDK nuk është parti që frikësohet nga anëtarësia e vet, as nga vota, as nga gara. Vendimet e saj i ka marrë gjithmonë në Kuvend, mes njerëzve të vet, hapur, me

debat dhe pa frikë; dhe në fund, me shumicë. Edhe në kohë shumë më të vështira se kjo”, ka shkruar Abdixhiku në “Facebook”. Ai ka sqaruar se procesi i së shtunës do të jetë në frymën e respektimit të anëtarësisë dhe pa ndikime të jashtme. “Këtë të shtunë mblidhemi për të diskutuar dhe për të vendosur mbi të gjitha çështjet tona, me vullnet të lirë dhe me votë të lirë, ashtu siç i takon një partie demokratike që respekton anëtarësinë e saj dhe asnjë interes tjetër veç saj. Ky është

parimi ynë dhe mënyra jonë e veprimit. LDK nuk di ndryshe”, u shpreh Abdixhiku. Kreu i LDK-së ka bërë thirrje për pjesëmarrje aktive dhe ka theksuar se nga ky proces partia do të dalë më e fortë. “Koha tani të flasë anëtarësia jonë. Nga ky proces do të dalim më të fortë, më të organizuar, më funksional e më të përqendruar te e ardhmja e LDK-së dhe e Kosovës”, ka shkruar ai. Abdixhiku ka konfirmuar gjithashtu se ftesat zyrtare për delegatët e partisë janë



dërguar. “Sot kam dërguar për të vendosur drejtimin e ftesën zyrtare për delegatët e shtëpisë sonë”, u shpreh LDK-së. Të shtunën takohemi Abdixhiku.

ISH-KANDIDATË PËR ASAMBLISTË NË FERIZAJ KËRKOJNË HETIM TË REZULTATIT TË ZGJEDHJEVE LOKALE

PRISHTINË, 26 JANAR - Tridhjetë e tre ish-kandidatë për Kuvendin Komunal të Ferizajt i janë drejtuar Prokurorisë Themelore në këtë komunë duke kërkuar zgjerim të hetimeve lidhur me rezultatin zgjedhor të zgjedhjeve lokale të 12 tetorit. Ndërkaq, nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve kanë kërkuar masa të jashtëzakonshme verifikuese. Megjithatë, KQZ-ja ka certifikuar rezultate për këto zgjedhje dhe ka asgjësuar materialin zgjedhor. Bashkim Fazliu, që garoi i pavarur për Kuvendin Komunal të Ferizajt, tha se po kërkojnë zgjerim të hetimeve, pasi dyshon se ka pasur manipulim të rezultateve zgjedhore, njësoj sikurse është vërejtur edhe për zgjedhjet e përgjithshme të 28 dhjetorit sa iu përket votave për kandidatë për deputetë. “Kërkesën e parë e kemi dorëzuar te Prokuroria Themelore në Ferizaj dhe për dijeni do t’ia dërgojmë edhe Laura Pulës, koordinatorë nacionale për zgjedhje. Në prokurori kemi bërë kërkesë për zgjerim të hetimeve që janë duke u bërë për 28 dhjetorin pasi është natyra e njëjtë, janë komisionarët pothuajse të njëjtë”, tha ai, duke shtuar se ekziston dyshimi se komisionarët mund të kenë keqpërdorur votat edhe për votimet e 12 tetorit. Me urdhër të Prokurorisë Themelore të Prizrenit javën e kaluar u ndaluan 109 persona,



nën dyshimet për keqpërdorime të rezultatit zgjedhor të 28 dhjetorit. Ndaj 23 prej tyre është caktuar masa e paraburgimit prej një muaji. Ndonëse në Prizren manipulimi vlerësohet se ishte në shkallë më të lartë, edhe në Ferizaj dhe Malishevë kanë nisur hetimet për keqpërdorim të mundshëm të rezultatit zgjedhor.

Fazliu tha për mediet se nga KQZ-ja është kërkuar ndërmarrja e masave të jashtëzakonshme verifikuese “pas daljes në pah të provave të reja të keqpërdorimeve dhe manipulimeve që kanë ndodhur më 28 dhjetor”. “Ne KQZ-së i kemi kërkuar ndërmarrjen e masave të jashtëzakonshme verifikuese, pastaj një ndër kërkesat është

edhe rinumërimi i fletëvotimeve. Nëse del rezultati i njëjtë për hair ju qoftë, nëse nuk del rezultati i njëjtë kërkojmë anulimin e certifikimit”, tha ai, duke shtuar se për dallim nga zgjedhjet e përgjithshme, për ato lokale edhe një votë përcakton se kush hyn në Kuvend Komunal, e kush jo. Fazliu tha se nuk ka parë

informacion që për zgjedhjet lokale, rezultati i të cilave u certifikuan në fillim të dhjetorit 2025, është asgjësuar materiali zgjedhor. Megjithatë, zëdhënësi i KQZ-së, Valmir Elezi, tha se në përputhje me ligjin, materiali zgjedhor për zgjedhjet lokale të tetorit është asgjësuar. Ligji parasheh që materiali zgjedhor të shkatërrohet brenda 60 ditësh, pas certifikimit të rezultatit zgjedhor, veç nëse Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia vendos ndryshe. Elezi nga KQZ tha se në procesin e shkatërrimit të materialeve janë përjashtuar ato për të cilat Prokuroria e Shtetit dhe gjykatat “janë duke i trajtuar”. Radio Evropa e Lirë iu drejtua Prokurorisë së Shtetit me pyetjen nëse në mesin e materialeve që mund të jenë duke u trajtuar ka edhe nga komuna e Ferizajt, por ajo ridrejtoi pyetjet për Prokurorinë Themelore në Ferizaj. Nga organi ndjekës në Ferizaj ende nuk kanë kthyer përgjigje. Ndryshe, për shkak të mospërputhjeve të vërejtura te votat e kandidatëve për deputetë, më 19 janar KQZ-ja vendosi rinumërim të plotë të votave të rregullta. Rinumërimi pritet ta shtyjë edhe më shumë formimin e institucioneve të reja të Kosovës të dala nga zgjedhjet e 28 dhjetorit.

‘Shqipëria dhe Kosova ecin së bashku, përgjegjësia ndaj kombit tonë’

PRISHTINË, 26 JANAR - Kryetari i PDK-së, Bedri Hamza, ka pritur në takim ambasadorin e Shqipërisë, Petrit Malaj, me të cilin ka diskutuar për forcimin e lidhjeve

kombëtare dhe bashkëpunimin në mes të Kosovës dhe Shqipërisë. “Bashkëbisedim i hapur me ambasadorin Petrit Malaj për forcimin e lidhjeve kombëtare dhe bashkëpunimin

mes Kosovës dhe Shqipërisë. Marrëdhëniet tona shkojnë përtej diplomacisë. Ato janë vëllazëri, histori dhe një e ardhme e përbashkët.

Shqipëria dhe Kosova ecin së bashku, të lidhura ngushtë nga vlerat dhe përgjegjësia ndaj kombit tonë”, ka shkruar Hamza në “Facebook”.



TRANSPORTUESIT RAJONALË BLOKOJNË KUFIJTË ME BE-NË, KOSOVA NË VËSHTIRËSI

Kompanitë e transportit nga disa vende të Ballkanit Perëndimor bllokuan pikat kufitare drejt BE-së, si reagim ndaj sistemit të ri elektronik të hyrje-daljeve (EES). Bllokadat ndikojnë në eksportet dhe importet e Kosovës, që përfshijnë mbi 20 milionë euro mallra në ditë, dhe mund të shkaktojnë probleme në zinxhirin e furnizimit dhe kosto shtesë për kompanitë

PRISHTINË, 26 JANAR - Transportues nga Serbia, Maqedonia e Veriut, Bosnje e Hercegovina dhe Mali i Zi, nga mesdita e 26 janarit, bllokuan pikat kufitare për qarkullimin e mallrave drejt zonës Schengen të Bashkimit Evropian. Ky veprim është reagim ndaj sistemit të ri të BE-së për kontrollin e hyrje-daljeve, të cilin ata e konsiderojnë shkak për dëbime, vonesa dhe humbje ekonomike, dhe kërkojnë që kompanitë e transportit të përjashtohen nga zbatimi i tij. Transportuesit njoftuan se bllokadat do të zgjasin shtatë ditë, nëse gjatë kësaj kohe nuk gjendet zgjidhje për problemin e tyre.

Çka është sistemi EES?

I njohur si EES (Entry/Exit System), ky sistem u vendos në kufijtë e jashtëm të zonës Schengen dhe nisi të zbatohej gradualisht më 12 tetor 2025. Ai pritet të jetë plotësisht funksional deri më 10 prill 2026. Rregulli i ashtuquajtur “90/180 ditë” parasheh që transportuesit nga vendet jashtë Schengenit mund të qëndrojnë në këtë zonë maksimumi 90 ditë brenda një periudhe prej 180 ditësh. Si importuese e shumë mallrave përmes Serbisë dhe Maqedonisë së Veriut, Kosova pritet të ndjejë pasojat e protestave në qarkullimin e mjeteve të transportit. Qendra Kombëtare për Menaxhim të Kufirit njoftoi se, sipas informacionit të pranuar nga zyrtarët kufitarë të Serbisë, “do të ketë ndërprerje të qarkullimit të kamionëve në të gjitha pikat kufitare me Serbinë”. “Këto protesta ndikojnë në qarkullimin e mjeteve të transportit dhe mallrave, si dhe mbingarkojnë trafikun në zonat kufitare të Republikës së Kosovës me vendet e rajonit, që janë të përfshira në protesta”, thuhet në njoftim. Qendra Kombëtare për Menaxhim të Kufirit paralajmëroi se bllokadë të ngjashme do të ketë edhe nga Mali i Zi. Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës (OEK), Lulzim Rafuna, njëherësh udhëheqës i Odave Ekonomike të Ballkanit Perëndimor, thotë se Kosova nuk merr pjesë në protestë, pasi vendi nuk ka ende kompani

logjistike që realizojnë transport të rregullt me vendet e BE-së. Por, paralajmëron se efektet e saj do të ndihen edhe në Kosovë. “Për shkak të bllokadës së kufijve, Kosova nuk do të mund as të eksportojë dhe as të importojë mallra”, thotë Rafuna për Radion Evropa e Lirë. Sipas të dhënave të Doganës së Kosovës për vitin e kaluar, vendi ka importuar produkte në vlerë prej mbi 7 miliardë eurosh në total, ose rreth 20 milionë euro në ditë - një sasi të madhe të tyre përmes Serbisë dhe Maqedonisë së Veriut. Vlera e eksporteve, ndërkaq, ishte rreth 942 milionë euro vitin e kaluar, apo rreth 2.6 milionë euro në ditë. Në përpjekje për të gjetur një zgjidhje, Rafuna thotë se gjashtë Odat Ekonomike të Ballkanit Perëndimor i kanë dërguar një shkresë presidentes së Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen. Në letrën që siguroi Radio Evropa e Lirë dhe që mban datën e 20 janarit, kërkohet që të gjendet një zgjidhje e qëndrueshme për këtë çështje. “Zhvillimet e pritshme si pasojë e këtyre masave, janë shqetësuese dhe mund të shndërrohen në një sfidë sistematike ekonomike dhe politike për rajonin”, thuhet në letër. Sipas Rafunës, sistemi i ri ka detyruar kompani në Ballkanin Perëndimor që, çdo tre muaj, të punësojnë shoferë të rinj. “Ky është problem i madh, sepse ka mungesë të tyre... dhe kjo komplet e çrregullon zinxhirin e furnizimit”, thotë ai. Nënkryetari i Shoqatës së Transportuesve të Mallrave nga Kosova, Besnik Aliu, thotë për Radion Evropa e Lirë se transportuesit në Kosovë përballen me sfida të ngjashme me kolegët e tyre në rajon, për shkak të sistemit EES. Sipas tij, edhe pse në Kosovë janë të licencuar rreth 2.000 kamionë për transport mallrash, sektori mbetet i dobët në transportin ndërkombëtar, pasi shumica e importeve dhe eksporteve realizohen nga kompani të rajonit dhe BE-së. “Nuk është e lehtë të gesh shoferë për tregun e BE-së, sikurse gjenden për transportin brenda Kosovës apo në rajon”, thotë ai. Duke folur për Radion Evropa e Lirë, Sasho Ilievski, pronar i kompanisë “Stema Transport” në



Shkup, thotë se nuk preket drejtpërdrejt nga rregullat e reja - pasi kamionët e tij udhëtojnë drejt shteteve më të afërta të BE-së - por shton se ai do t'i mbështesë kolegët në protestë. “Udhëtimet tona zhvillohen kryesisht në Austri, Sllovaki, Republikën Çeke dhe Hungari. Për çdo udhëtim, qëndrojmë maksimumi katër deri në pesë ditë”, thotë ai. “Megjithatë, ka kompani që operojnë më thellë brenda BE-së... që hyjnë në Suedi, Norvegji, Portugali. Për një udhëtim, ato kalojnë 15 deri në 20 ditë brenda BE-së. Kur kthehen, nuk u lejohet të hyjnë përsëri gjatë atij muaji. E, nëse nuk udhëtojnë sërish, kompania dhe biznesi humbasin, pasi shoferët nuk mund t'i përmbushin detyrimet e tyre profesionale brenda asaj kohe. Ata nuk janë turistë, janë shoferë profesionistë dhe duhet t'u lejohet të qëndrojnë më gjatë”, shton Ilievski. Para se të hynte në fuqi sistemi elektronik, EES, transportuesit maqedonas nuk kishin probleme, edhe pse rregulli i 90 ditëve për qëndrimin në zonën Schengen ishte në fuqi. Doganierët vulosnin pasaportat, por nuk numëronin ditët dhe shpesh i “shikonin përmes gishtave”, thotë Ilievski. Por, që nga fillimi i funksionimit të sistemit elektronik të BE-së, qëndrimet në zonën Schengen monitorohen më rreptë. Kompjuteri me të dhëna biometrike përmbledh saktë të gjitha ditët - nga koha e kaluar në udhëtim, pushimet në parkime e deri te pritjet në kufi. “Të gjithë ata që udhëtojnë më thellë brenda Bashkimit Evropian, do të qëndrojnë më shumë ditë. Kjo i prek rreth 70 për qind të kompanive në vend. Kolegët në Suedi, për shembull, nuk mund të kthehen shpejt... Shoferi e drejton automjetin për 9 orë në ditë dhe pastaj duhet të pushojë. Pushimi që merr është brenda BE-së dhe konsiderohet po ashtu qëndrim, edhe pse ai nuk po punon”, thotë Ilievski. “Prandaj, ne kërkojmë nga BE-ja që t'i përjashtojë kompanitë e transportit. Shoferëve ose duhet

t'u zgjatet qëndrimi, ose të llogariten vetëm orët e tyre të punës”, sipas tij. Transportuesit maqedonas do të bllokohen dhjetë pika kufitare - në kufi me Bullgarinë, në kufi me Greqinë, në kufi me Shqipërinë dhe në kufi me Kosovën. Pika kufitare Tabanovc nuk do të bllokohet nga maqedonasit, por nga transportuesit serbë në anën e tyre të kufirit, që tashmë i kanë bllokuar edhe pikat e tjera. Bllokadat aplikohen vetëm për trafikun e mallrave, duke mbyllur korsitë dhe terminalët për kamionët, ndërsa makinat e zakonshme, autobusët dhe trafiku i pasagjerëve do të lëvizin pa pengesa. Në Maqedoninë e Veriut, mobilizimi për bllokadat u organizua nga “Makam-Trans” - shoqata më e madhe e punëdhënësve të kompanive të transportit në këtë vend. Bilana Muratovska, sekretare e përgjithshme e “Makam-Trans”, thotë se shoferët maqedonas, sikurse edhe të tjerët në rajon, përballen me rrezikun e dëbimit pas qëndrimit 90-ditor në zonën Schengen. Më herët, Konsorciumi i Logjistikës i Bosnje dhe Hercegovinës njoftoi se 100 shoferë profesionalë janë kthyer me forcë nga vendet e BE-së, ndërsa 47 shoferë kanë humbur punën për shkak të problemeve me qëndrimin në këto vende. “Ne kemi raste të tilla. Nuk kam një numër të saktë, por duhet bërë një dallim... për shembull, flota e transportit në Bosnje e Hercegovinë dhe në Serbi është shumë më e madhe se e jona”, thotë Muratovska. Ajo shton se dëmet për kompanitë janë të mëdha dhe shkaktojnë shpenzime shtesë. “Kur i llogarisim kostot që na shkaktojnë - sepse mjeti lihet në një parking plot me mallra, që mund të jetë shumë i shtrenjtë dhe pa mbrojtje, dhe ne nuk e dimë se çfarë do t'u ndodhë shoferëve - situata bëhet e vështirë. Shoferët dëbohen me avion, sepse nuk kanë ditë të mjaftueshme për t'u kthyer me

autobus ose me kolegët e tyre. Këto kosto i mbajnë transportuesit”, shpjegon Muratovska. BE: Asgjë nuk ka ndryshuar me rregullat e Schengenit Sistemi EES nuk vendos asnjë kërkesë të re për qëndrimet e shkurtra në zonën Schengen, tha zëdhënësi për Çështjet e Brendshme të Komisionit Evropian, Markus Lammert, më 19 janar, në përgjigje të pretendimeve të shoqatave të transportit nga Ballkani Perëndimor se sistemi i ri po i lë punëtorët dhe shoferët pa punë. “EES siguron zbatim më të mirë të rregullave ekzistuese dhe zbulim sistematik të parregullsive”, tha Lammert, duke theksuar se Komisioni Evropian po ndjek nga afër çështjen e njoftimeve për bllokada nga transportuesit. “Sipas rregullave, shtetasit e vendeve të treta pa vizë kanë të drejtë të qëndrojnë në zonën Schengen për gjithsej 90 ditë brenda çdo periudhe 180-ditore. Çdo ditë që e tejkalon këtë, duhet të mbulohet me vizë afatgjate ose leje të lëshuar nga një shtet anëtar”, shtoi Lammert. Por, sipas Muratovskës, edhe pse BE-ja thotë se rregulli i qëndrimit 90-ditor brenda 180 ditëve nuk ka ndryshuar, rrethanat kanë ndryshuar. “Të gjitha shtetet anëtare të Bashkimit Evropian tashmë janë në zonën Schengen - plus dy vende që nuk janë anëtare të BE-së, Norvegjia dhe Zvicra. Tani, pa marrë parasysh se si largohesh nga vendi, menjëherë hyn në zonën Schengen. Ndaj, pretendimet se situata është e njëjtë si më parë, janë fyerje për inteligjencën”, thotë Muratovska. Qeveria maqedonase u doli në mbrojtje transportuesve të vendit. Ministri i Transportit, Aleksandar Nikolovski, tha se e kupton revoltën dhe propozoi që problemi të zgjidhet ose duke shtyrë sistemin elektronik për shoferët profesionistë, ose duke u dhënë atyre mundësinë të marrin viza pune.

BLLACA '99

NË KOHË LUFTE DHE NË KOHË PAQEJE



Shkruan: Fatmir **KRASNIQI**

Vitet 1998-1999 përbëjnë një nga periudhat më të veçanta për historinë më të re të Kosovës, ngase ngjau çlirimi i saj nga pushtimi shekullor serb. Pas Luftës heroike të Prekazit e Masakrës së Drenicës, UÇK-ja (Ushtria e Lavdishme dhe e Pathyeshme Çlirimtare e Kosovës) zhvillonte luftë frontale për jetë a vdekje kundër forcave pushtuese të Serbisë. UÇK-ja është vepër epokale e popullit shqiptar të Kosovës, që lindi në zjarrin e luftës së tij për mbrojtjen e jetës, të lirisë dhe të drejtave njerëzore e kombëtare nga shtypja, sundimi e regjimi i egër serb. Gjatë muajit mars 1998, në shtëpinë time, ku banoja në Lagjen e Spitalit në Prishtinë, tani e njohur si Rruga “Muharrem Fejza”, erdhën për të biseduar Afrimi, djali i axhës tim, së bashku me Kadri Krasniqin, kontribuues për UÇK-në, që ishin të angazhuar rreth logistikës për Zonën Operative të Pashtrikut, Njësi “Çeliku”, që vepronte në Kleçkë e në Malet e njohura të Berishës, rreth mundësisë që në shtëpinë time njëkatëshe të kenë të siguruar një Pikë logjistike. Dëshira për të kontribuar e mbështetur UÇK-në, ish-nxënësit e mi trima e luftëtarë të dalluar e sypatrembur, si dhe bashkëvendësit e mi të dashur, ishte e madhe. Në oborr vinin kamioneta që zbarkonin e grumbullonin gjëra ushqimore e veshmbathje për t’i shpërndarë e dërguar në Malet e Berishës. Shpesh ndodhte që djali i axhës, Bajrami, avokat i njohur, atdhetar, veprimtar i palodhshëm e guximtar së bashku me Sylejman Ahmetin, po ashtu një atdhetar e veprimtar i shquar, vinin me veturë dhe ngarkonin materiale të nevojshme për luftë e niseshin drejt Berishës me shumë rreziqe, fljime e të papritura. Nganjëherë më merrnin edhe mua në Tërpezë, si dhe djalin tim Nolin, që ishte në klasën e parë në Shkollën fillore “Hasan Prishtina”, në Prishtinë. Nolit iu pat ngulitur një kujtim i paharruar, kur me një rast, duke shkuar për në Berishë, disa ushtarë i dhanë dredhëza. Ai, kur shkoi në shkollë, nga gëzimi e me shumë

emocione, i thotë mësueses se UÇK-ja i kishin dhënë dredhëza. Në të njëjtën kohë ngritët në këmbë shoku i tij klasës, Galdimi, duke iu drejtuar mësueses Antigone: “Edhe babai im është në UÇK...!” (është fjala për Ramë Bujën). Mësuesja me shumë vëmendje i dëgjon e me shumë kujdes i tejkalon emocionet e rrëfimet e Nolit e të Galdimit. Kur dihej se, në atë kohë ende kishte mëdyshje tek disa individë në Prishtinë, se ka apo nuk ka UÇK?! Dihej publikisht se Malisheva ishte Zonë e Lirë, e vetmja në Kosovë, në muajt maj-korrik 1998. Malisheva ishte dhe është zemra e Kosovës, ku Ushtria Çlirimtare e Kosovës arriti ta çlironte Malishevën gjatë këtyre muajve. Shpeshherë fqinjët ishin shumë kureshtarë dhe i pyesnin fëmijët e mi: Albulenën, Tringën e Nolin se përse po vinin këto kamioneta në oborrin tuaj?!... Fëmijëve u pata thënë se Afrimi, pra djali i axhës tim, e ka një shitore në Malishevë. Dhe, fëmijët sa herë që i pyesnin ua kthenin këtë përgjigje. Përveç Naimes, bashkëshortes sime, si dhe motrës së saj, Bahries dhe Mustafës – bashkëshortit a mjeshtakut tim, që i kishim shtëpitë në një oborr të përbashkët, askush tjetër nuk e dinte se në shtëpinë tonë ishte Pika logjistike e UÇK-së.

I mbijetuari i luftës – “Terroristi i vogël”

Tërpeza e Malishevës ishte bërë fortifikatë dhe qendër e rezistencës ndaj forcave policore, ushtarake e paraushtarake, dhe në pamundësi për të depërtuar në Malet e Berishës, ku edhe kryekrimineli Sheshel ëndërronte e shpresonte se aty do të pinte kafe, por që nuk iu realizua e as nuk iu mundësua, ngase aty qëndronin ushtarët trima, duke rezistuar e qëndruar të pamposhtur e duke luftuar ballë për ballë me forcat serbe. Forcat serbe ishin përqendruar e pozicionuar në Smanicë të Tërpezës, ku të tmerruar kishin filluar me granatime të ashpra e të shtëna nga të gjitha anët. Granatimet kishin filluar, më 19.4.1998, rreth orës17:15 e që kishin vazhduar gjatë tërë natës, ku ishin dëgjuar të shtëna nga armë të ndryshme. Çak i granatimeve në fshatin Tërpezë, nuk ishin vetëm shtëpitë, por edhe Shkolla fillore “Hasan Prishtina”, ambulanca dhe tendat plastmase në të cilat ishte strehuar një pjesë e madhe e popullsisë edhe nga fshatra të

tjera. Aty gjatë këtyre granatimeve u plagosën nënë e bir, Shpresa Krasniqi dhe djali i saj, Albioni, gjashtëmuajsh. Pikërisht në ditën kur u plagos Albioni, ai kishte mbushur gjashtë muaj jetë. Albioni u lind, më 19.4.1998 dhe u plagos, më 19.10.1998. Shpresa, me shumë emocione e ndjenja të përziera, tregon për ngjarjen e rëndë, që veç fati i ka shpëtuar, se ka mundur të shndërrohej në tragjedi të paparë. Shpërthimi i granatave ishte i tmerrshëm, saqë para nesh lopët e Ahmet Imerit, u qëlluan duke rënë përtoke. Për fatin e tij, për pak nga granatimi kishte shpëtuar Hamit Dobruna, mik i familjes sonë, profesor i shquar, veprimtar i dalluar, i përndjekur dhe i burgosur politik, tani i ndjerë që kishte qëlluar afër tyre. Shpresa, në ato çaste, kishte menduar si ta mbronte e shpëtonte Albionin, duke mbuluar me tërë trupin e saj si mburojë, ku dorën e gishtin e saj e kishte goditur një cifël e shpërndarë e granatës, ku papritmas kishte ndjerë një therje e dhimbje të papërballueshme, por që mendjen e kishte vetëm te djali i saj i shtrenjtë gjashtëmuajsh, se si ta mbronte e shpëtonte, duke treguar heroizëm të paparë. Megjithatë, përkundër përpjekjeve të saj mbinjerëzore, e njëjta cifël kishte depërtuar dhe e kishte qëlluar Albionin në pjesën e prapme të kraharorit. Kjo cifël granate edhe tashmë qëndron në trupin e Albionit 27 vjeçar, si dëshmi e luftës, por që nuk paraqet rrezik, i kanë thënë mjekët. Albioni, megjithatë, ka shëndet të plotë. Ai është shumë

i dashur e simpatik. Në ditën kur u plagosën, ai së bashku me nënë Shpresën, ishin në gjendje shumë të rëndë, ndërkohë që nuk iu kishte lejuar dërgimi i tyre në spital. Për këtë ngjarje të rëndë kishte njoftuar edhe Radio “Dojçe Vele”. Vendi ku ishin plagosur njihej si Rrëza e Mullinit, luginë e bukur me një përrua që rrjedh nga një krua, rrëzë rrënjëve të një ahu, i njohur si Vrella e Tërpezës. Në këtë luginë, të rrethuar me lisa ahu, ishin strehuar banorët e Tërpezës dhe shumë fshatrave të tjerë. Gjendja shëndetësore e Albionit po përkeqësohej, ngase gjakderdhja nuk po i ndalej, rrëfen Shpresa.- Edhe, unë kisha gjakderdhje, por shqetësimin, brengën e mendjen e kisha tek djali. Shaip Dobruna, që ishte i strehuar në Tërpezë, ua kishte ofruar veturën, ku Tomorri – nipi i tij së bashku me Jetishin, axhën e Albionit, Baliun, babain e të plagosurit, Shpresën e Albionin, ishin nisur me shpejtësi, nën breshërinë e të shtënave drejt Fshatit të Ri, ku ishte ambulanca. Aty iu kishte dhënë ndihma e parë, por gjakderdhja Albionit nuk i ndalej. Me të njëjtën veturë, por drejtues ishte një nip Tërpeze, djali i Sabrijes, nga Çikatova, Shemi. Ata ishin nisur drejt fshatit Shalë, ku ishte Spitali Usharak. Doktor Fitimi kishte bërë të pamundurën për ta mjekuar, por që Albioni kishte nevojë për serum. Një shofer autobusi nga Shala kishte shkuar në Prishtinë, duke ia siguruar e sjell serumin në Shalë, e që atë natë kishin bërë konak te një familje shumë bujare, te Sanija, vajza e dajës

Selman Gashi, nga Nekoci, që ishte e martuar në Shalë. Shpresa, falënderon me mirënjohje më të thellë këtë familje për të gjitha! Të nesërmen ishin nisur me autobus, që bartte vetëm gra për në Prishtinë. Në autobus ishte edhe Kushtrim Berisha, nga Prishtina, që kthehej nga Berisha, ku kishte qëndruar e kontribuar si ushtar e përkthyes në Malet e Berishës, e në Shtabin e Kleçkës. Kushtrimi i kishte thënë Shpresës të mos shqetësohej se sapo të mbërrinin në Prishtinë, po i priste nëna e tij. Për befasi, me nënën e Kushtrimit, Sheribanen, punonim së bashku në Shkollën fillore “Elena Gjika”. Kushtrimi është djali i profesorit të shquar të historisë, Sahit Berishës, të burgosurit politik e veprimtar i dalluar. Me të mbërrirë në Prishtinë, Shpresa u drejtohet Sheribanes e Kushtrimit: “Mua më duhet për të shkuar në Lagjen e Spitalit, se aty e ka shtëpinë kushëriri i burrit, Fatmir Krasniqi, është arsimtar!”. Sheribanja i drejtohet Shpresës: “Mos u shqetëso, se me Fatmirin punojmë bashkë dhe deri në shtëpinë e tij të dërgojmë ne!”. Dhe, me të mbërritur në shtëpinë tonë, u del përpara Naimja, bashkëshortja ime, që me profesion është infermiere, e cila deri në pension ka punuar në Klinikën e ORL-së, në Prishtinë. Ajo i pret me përzemërsi. Shpresa, ende pa hyrë brenda, e njofton Naimen se Albioni është i plagosur, e po ashtu e plagosur ishte edhe ajo. Naimja, menjëherë intervenon në pastrimin e plagëve, por që gjakderdhja Albionit nuk po i



ndalej. Pasi u ktheva nga shkolla, mbeta i shtangur kur pashë Albionin, të plagosur, por edhe Shpresën me plagë në duar. Menjëherë iu drejtova Mustafës, mjeshtakut (baxhanakut), që me veturën e tij të na dërgojë në Ambulancën “Nënë Tereza”, në Kodrën e Trimave.

Mjeku, siç dukej e kishte paksa të paqartë se ku ta dërgonim?!... Dihet, se në atë kohë spitalet dhe shtëpitë e shëndetit administroheshin nën masa të dhunshme.

Vendosëm t’u drejtohem i urologëve të shquar Dr. Lutfi Dërvishit e Dr. Tunë Pervorfit, që punonin në një ambulancë private në “Dardani”. Ata na pritën shumë mirë, edhe pse plagët e Albionit, rasti i tij, nuk kishte të bënte me fushën e tyre të ngushtë të mjekësisë.

Megjithatë, të dy mjekët e kontrolluan me shumë kujdes Albionin, ku na udhëzuan për një rëntgen, që gjendej afër tyre. Dhe, pas shikimit, mjekët konstatuan se një cifël e granatës ishte në pjesën e prapme të krahavorit të Albionit. Në fakt, ata gjatë kontrollimit, veç e vërejtën dhe dyshuan për një mjet shpërthyes në trupin e vogëlushit.

Na thanë e na udhëzuan se përkundër gjendjes së krijuar në spitalin shtetëror, sa më urgjentisht ta dërgonim në Klinikën Torakale. Pas shumë përpjekjesh e mundimesh arritëm që Albionin ta kontrollonim në Klinikën Torakale. Singerisht e me shumë përgjegjësi e them se atje nuk u trajtua siç duhej një foshnjë gjashtëmuajshe?!

Jo që nuk e pati përkujdesjen e trajtimit të duhur human, por Albioni, nga personeli serb i Klinikës Torakale e mori epitelin a nofkën e parë “Terroristi i vogël”, edhe pse ishte foshnjë gjashtëmuajshe?! “Terroristi i vogël”, ishte nga fshati Tërpezë e Malishevës, që nga serbët konsiderohej Zonë e luftës dhe shumë e rrezikshme.

Nga Klinika u larguam, unë së bashku me Shpresën, ku e bartnim Albionin në qafë e mbi supe, kur e dërguam disa herë për kontrollë mjekësore te mjeku i njohur për fëmijë Dr. Fazli Mekuli, që ordinancën e kishte afër Shkollës fillore “Gjergj Fishta” në Prishtinë. Me të parë gjendjen e Albionit që po i përkeqësohej, ngase nuk kishte shenja përmirësimi, Dr. Mekuli na këshilloi e na udhëzoi që të angazhohemi për t’i siguruar sasi gjaku, në të kundërtën gjendja shëndetësore e tij mund të rrezikohej, pasi që kishte humbur shumë gjak...

Naimja, meqë punonte në spital, shkon dhe bisedon me Dr. Remzije Kocin, pediatre, në Spitalin Pedriatik të Fëmijëve, duke e njoftuar për rastin dhe gjendjen e rëndë shëndetësore të Albionit.

Ajo i thotë Naimes: “Po

rrezikojmë dhe po e pranojmë, ku do ta trajtojmë me një “diagnozë tjetër”, për të mos e kuptuar personeli serb i klinikës se Albioni është i plagosur!”. Beteja tjetër ishte se si t’i sigurohej sasia e gjakut. Së bashku me Naimen, biseduam me fqinjin tonë, Haki Buçanin, teknik laborant i njohur, duke e njoftuar në hollësi për rastin.

Hakiu, me përkushtimin dhe humanizmin e paparë, u zotua se sasinë e gjakut do ta siguronte dhe se do t’ua sjellte në pediatri, ku ishte i shtrirë Albioni. Hakiu bisedon me Dr. Bukurijshe, që punonte në Transfuzion të Gjakut, ku këta të dy së bashku me Naimen dhe personelin tjetër të transfuzionit, nuk u frikësuan dhe urgjentisht siguruan gjakun dhe e dërguan në Pediatri për foshnjën gjashtëmuajshe. Kështu Albionin e plagosur gjatë luftës e shpëtuan!

Falënderim me mirënjohje më të thellë për: Dr. Remzijen, Hakiun, Dr. Bukurijshe si dhe për personelin tjetër shqiptar të spitalit të fëmijëve! – shprehin familjarët e Albionit.

Albioni, i mbijetuari i luftës, tani është me shëndet të plotë dhe i fortë si çeliku, i dashur dhe shumë i respektuar.

Gjatë asaj kohe, derisa ishte duke u mjekuar Albioni, në shtëpinë tonë qëndruan: dada Nurijshe, gjyshja e Albionit, së bashku me mbesat e saj, motrat Valentina e Dafina, vajzat e Fadilit, axhës së Albionit. Gjatë kohës sa qëndruan ata në shtëpinë time, erdhi gazetari i shquar i “Dojçe Veles”, Agim Zogaj, tani profesor e publicist i njohur dhe i dalluar, i cili e realizoi një intervistë me Shpresën, nënën e Albionit.

Për ushtarët e UÇK-së dhe popullsinë civile gatuheshin edhe nga 100 bukë në ditë

Shpresa na tregonte se si gjatë kohës së luftës, ajo së bashku me bashkëshortin Baliun si dhe kunatat Zejnijen e Mihrijen, gatuanin deri 100 bukë në ditë dhe nga pesë – gjashtë pite për ushtarët e popullsinë civile, që ishin zhvendosur në malet e Tërpezës.

Popullata ishin të kërcënuar, të larguar dhe zhvendosur nga një lagje në një lagje tjetër të Prishtinës dhe së fundi edhe të dëbuar për në Bllacë.

Gjatë marsit të vitit 1999, forcat policore serbe u pozicionuan në kulmin e ndërtesës së Arkivit të Kosovës, duke vëzhguar me çdo kujdes çdo lëvizje të banorëve të kësaj lagjeje, si dhe qytetarët tjerë.

Po ashtu, forcat serbe kishin ngritur edhe barrikada pranë shtëpive të Lagjes së Universitetit, që ishin përballë shtëpive tona (shtëpia ime, e Mustafës dhe e Elmi Mustafës)



që na ndanin nga policia e ushtria vetëm disa troje pa shtëpi dhe rruga.

Çdo çast a moment ne ishim të rrezikuar dhe nuk dinim si të vepronim. Madje, në shtëpinë time ishte edhe Pika logjistike, gjë që rreziku ishte edhe më i madh.

Disa herë ishim të detyruar e të kërcënuar që të zhvendoseshim nga një lagje në lagjen tjetër, herë në “Ulpianë”, tek daja i bashkëshortes, Ramiz Bytyçi, herë në “Tophane” tek motra Bahtije e dhëndri i ndjerë Rrahim Gërdovci dhe herë në “Breg të Diellit”, në banesën e Sami Berishës, profesor e humanist i shquar, tani i ndjerë. Një ditë, duke u kthyer nga “Ulpiana”, afër fushës së sportit te Shkolla fillore “Hasan Prishtina”, unë dorë për dorë me Albulenën e Tringën dhe Naimja me Nolin, papritmas dhe befasisht, para nesh dolën nga vetura e tyre, ngjyrë të kuqe e tipit të vjetër “Lada”, pjesëtarë të uniformuar si policë, të cilët na urdhëruan që të ndalemi, duke na i kërkuar letërnjoftimet. Pasi që na i shikuan, iu drejtuan Naimes: “Ti ndalu, ngase vendlindja jote, Llapushniku, është zonë e luftës! Çfarë po kërkon ti këtu?”.

Naimja, u shqetësua aq shumë saqë nuk mund të fliste dhe t’ua kthente përgjigjen. Nuk e di as vetë, se si në ato çaste tmerruese dhe me shumë qetësi iu drejtova

që të shikojnë mirë letërnjoftimin dhe adresën e vendbanimit, duke u thënë se Naimja vetëm ka lindur në Llapushnik, dhe se si fëmijë ka jetuar me familjen e saj në Prizren.

Ne, tashmë, jemi të martuar, punojmë e jetojmë në Prishtinë, në Lagjen e Spitalit. Është infermiere e punon në spital, dhe se tani është duke shkuar në punë.

Pas një situatë shumë të tensionuar, na thanë: “Shkoni e mos t’ju shohim më!”

Kur mbërrimë në shtëpi, rrugës ishte atmosferë e zymtë dhe tejet e rëndë, nga njerëz të hutuar e shumë të frikësuar dhe të pashpresë, të cilët nuk dinin si të vepronin e ku të shkonin. Gjatë një pasditeje, një kalimtar rasti i moshuar, që shkonte në drejtim të “Bregut të Diellit”, afër trullait të Çerkinit, e shumë afër shtëpive tona, forcat serbe e qëlluan me breshëri plumbash, e vranë!

I vrari, kuptuam më vonë, ishte babai i fqinjit të lagjes, Jakup Shaqirit, që quhej Bajram Shaqiri. Trupi i të ndjerit qëndroi, po aty ku u vra, tërë natën deri në orët e hershme të mëngjesit. Gjatë asaj kohe plumbat kanë goditur edhe shtëpinë e Mustafës, por ne nuk u tregonim fëmijëve, se edhe ashtu ata ishin shumë të frikësuar e të shqetësuar. Nga dritarja e shtëpisë sonë e kishin

parë trupin e vranë të të ndjerit. Tringa, vajza ime, në Kampin e Stankovecit këtë ngjarje tmerruese, e vrasjen e kalimtarit të rastit, njeriut të pafajshëm, e pati vizatuar – pikturuar.

Të hënën, 29 mars 1999 – një lumë njerëzish dëboheshin nga Prishtina

Ishim të lodhur e dërmuar fizikisht, të thyer shpirtërisht e emocionalisht, të pambrojtur e të kërcënuar, të shtrënguar e të detyruar, dhunshëm të dëbuar të lëviznim e të ndërronim lagjet, ku mendonim se janë “më të sigurta”. Prishtinën, atë ditë e kishin mbuluar re të zeza. Rrugët e Prishtinës ishin shndërruar si lumenj të mbushur me njerëz, që niseshin nga të gjitha anët drejt stacionit hekurudhor, ku ishte shpresa e vetme e cakt për t’u larguar si të dëbuar, e pa e ditur se ku do të shkonin dhe se a do të mbërrinin?!...

Edhe ne u nisëm në drejtim të stacionit hekurudhor, drejt “Bregut të Diellit”, por që nuk ishim të sigurt se a do të mund të mbërrinin?!...

Duke kaluar afër ambulancës, nga lart dëguam disa zëra, duke thirrur nga ballkoni i banesës, emrin tim!

Ngrita kokën lart dhe i befasuar e shumë i emocionuar pashë Lutën e Miradijen, duke na e bërë me dorë, duke na ftuar, që të ktheheshim e të ndaleshim në

banesën e tyre. Bashkëshortët Miradije e Lutfi Qehaja, na e hapën derën e madhe të konakut. Me Miradijen punonim së bashku në Shkollën fillore “Elena Gjika”. Familja Qehaja është e njohur, meqë shquhet për virtyte e tipare të larta të bujarisë e të mikpritjes, të zemërgjerësisë e shpirtmadhëstisë, të humanizmit e fisnikërisë. Në banesën e tyre ishte edhe motra e Lutës, Kadirja me fëmijët Visarin e Albanin. Madje, aty na u bashkuan edhe Shpresa e Nazmi Çitaku, së bashku me vajzën e tyre Blerandën. Me Shpresën punonim së bashku në shkollë. Shpresa e Nazi banonin shumë afër banesës së Lutës e Miradijes, dhe se një natë patëm qëndruar edhe në banesën e tyre.

Që nga data 29 mars e deri më 3 prill 1999, ne qëndruam në banesën e familjes Qehaja, në “Bregun e Diellit”. Përkundër gjendjes së rëndë të luftës, ankthit e tmerrit, fëmijët gjatë atyre ditëve sa qëndruam aty, sikur ndjeheshin më të sigurt e më të qetë, ngase ne si prindër iu dhuronin dashuri, ngrohtësi e qetësi...

Ato ditë, për ne, do të mbetën përjetë të paharruara, ku me mirënjohjen më të thellë nga zemra e falënderojmë këtë familje me zemër të madhe për mikpritjen e veçantë e shumë të ngrohtë dhe të përzemërt. Familja Qehaja është shembull e simbol i oqeanit të mikpritjes e bujarisë, bamirësisë e humanizmit si dhe fisnikërisë së rrallë shqiptare e të pakrahasuar.

Bllaca e atyre ditëve e netëve të tmerrit e të ferrit...

E shtunë, 3 prill 1999

Nuk e dimë ende, as sot e asaj dite, se ç’ndodhi me foshnjën gjashtëmuajshe?!... Në asnjë lagje të Prishtinës nuk ishte askush i sigurt, meqë dëbimi masiv dhe i tmerrshëm i qytetarëve të Prishtinës, nga forcat serbe ishte gjenocid i paparë, thjesht pastrim etnik. Dhe, i ashtuquajtur “Korridori” i Gligorovit, Plani famëkeq “Patkoi” i Millosheviqit si dhe realizimi i një ëndrrë shekullore serbomadhe për një Kosovë pa shqiptarë, filloi të zbatohej në vazhdimësi... Në orët e hershme të mëngjesit, të së shtunës, dolëm nga banesa e familjes së madhe bujare Qehaja, për të vazhduar rrugëtimin me shpresa të thyera e pakthim drejt stacionit hekurudhor. Shiheshin qytetarë në grupe të hutuar e shumë të shqetësuar, të kërcënuar e me fëmijë të frikësuar përdore, duke ecur në rrugë e drejtime të ndryshme. Feridja, ish-arsimtare, me një zë shumë të ulët e me një mirësjellje të veçantë m’u drejtua: “Mund të vini edhe ju me ne në një autobus, që jemi

duke pritur për t’u nisur për në Bllacë!”. Autobusi u vonua, megjithatë pritëm një kohë të gjatë por më vonë mbërrini. Megjithatë, kishte vështirësi e nuk kishte siguri se nga cili vend të niseshim?!...Dhe, më në fund, pritjes së gjatë e shumë të mundimshme i erdhi fundi. U nisëm... Një nisje e papërballueshme, shumë e madhe dhe e dhimbshme. Në autobus ishim mbi 80 persona, nga foshnjat e deri më të moshuarit. Në të dy anët e rrugës, nga Lipjani e deri në Han të Elezit, shihnim shtëpi të djegura dhe tymra që përhapeshin në qiell, si dhe dëgjoheshin të shtëna armësh e granatimesh. Udhëtimi me autobus zgjati 50 minuta. Mbërrimë në Bllacë. Bllaca, vend tmerri e ferri. Një kohë të gjatë na ndalën te Fabrika e Çimentos, e madje policët serbë na urdhëruan që të ecnim vetëm brenda binarëve të trenit ngase në të dy anët e hekurudhës, na thoshin: “Janë të minuara?!”. Në Bllacë, pranë lumit, shihje njerëz të dëbuarish, si lumenj të rrëmbyeshëm. Nuk dinim se ku e si të vendoseshim?!... Iu bashkuam turmës së madhe të njerëzve që prisnin e shpresonin ta kalonin kufirin e hekurta maqedonas. Aty takuam Dr. Sami Delijajn së bashku me bashkëshorten, djalin dhe vajzat e tij. Pjesën tjetër të familjes së tij, nga Abria e Drenicës, forcat serbe ia kishin vrarë e masakruar. Unë i njihja, meqë isha arsimtar dhe kujdestar i djalit të tij, Gentritit. Ishim shumë të lodhur, të këputur e të dërmuar dhe mezi qëndronim në këmbë, vetëm e vetëm me shpresën se ndoshta do të kemi fatin që ta kalojmë atë kufi të mallkuar...

Atë natë mundi e përpjekja jonë dështoi, por edhe disa ditë e net të tjera dështuan dhe assesi ta preknim a ta kalonim atë kufi të çeliktë nga ushtarët maqedonas! Binte një shi dhe bënte ftohtë. Një natë shumë e zymtë, e nën qiellin e hapur e me vetëm dy batanije, e pa tendë plastmase, fëmijët dhe bashkëshorten time i zuri gjumi. Unë qëndroja pranë tyre. Bllaca gjëmonte nga qarjet e foshnjave a fëmijëve dhe mallkimet e nënave. Rreth orës 22:00 afrohet një nënë me foshnjën e saj duke e lutur Naimen që t’i bëjë pak vend sa të shtrihej për t’i dhënë gjë foshnjës së saj gjashtëmuajshe. Naimja, me shumë mirësi, i bëri vend dhe i tha: “Eja e shtriju lirisht!” – ku ajo u mbulua me batanije. Pas një kohe, pasi i dha gjë dhe e qetësoi fëmijën, nëna e foshnjës, na u drejtua neve: “A mund ta lë për një kohë fëmijën këtu tek ju, derisa t’i takoj prindërit e burrit?”. Foshnjën e zuri gjumi në prehër të Naimes. Kaluan dy orë dhe nëna e fëmijës nuk po vinte dhe as që mund ta shihnim edhe pse e kërkonim?!... Pas mesnate foshnja u zgjua nga

gjumi dhe filloi të qante e të dëneste me të madhe, saqë edhe neve zemra filloi të na dridhej, ngase nuk mund ta qetësonim atë assesi. Në ato çaste përjetuam shumë emocione dhembshurie dhe ishim shumë të prekur e të shqetësuar! Fillova ta kërkoja nënën e foshnjës nga të gjitha anët, por ishte e pamundur ta dalloja a njihja në ato orë të vona të natës dhe në atë turmë të madhe njerëzish. Pas shumë kërkimesh e njoftova Kryqin e Kuq me rastin. Ata erdhën menjëherë, e me shumë kujdes e mirësi e morën foshnjën. Për ne ishte një çast shumë i ndjeshëm, shumë i prekshëm dhe shumë i dhembshëm si dhe i paharruar në mendjen dhe në kujtesën tonë?! Sa shumë do të dëshironim të dinim se çfarë ndodhi më vonë, me fatin e kësaj foshnjeje engjëlllore?!... Sa do të dëshironim ta takonim! Por, asgjë kurrë nuk mësuam se çfarë ndodhi me atë?! Në luginën e tmerrshme të Bllacës veneronim njerëz të këputur e të lodhur si dhe të thyer shpirtërisht e emocionalisht, meqë ishin të pangrënë, pa bukë dhe pa ujë. Pas dy ditësh, ne mezi me ndihmën e disa njerëzve të mirë, e ngritëm një tendë të vogël prej plastmase. Për fatin tonë ishin shqiptarët e Maqedonisë, motrat e vëllezërit tanë që u organizuan dhe u aktivizuan me bujarinë e fisnikërinë si dhe me humanizmin e tyre të paparë për të na ndihmuar me ushqime e gjëra të tjera. Asnjëherë nuk mund t’i harroj ato çaste të prekshme, kur nga traktorët apo automjetet tjera, ato vullnetarët humanistë shqiptarë të Shkupit e rrethinës, në pamjaftueshmëri të hapësirës hidhnin bukë në drejtim të turmës të njerëzve, që ishin me duar të zgjatura e të ngritura për të siguruar së paku një bukë. Megjithatë, një njeri shpirtkazmë, edhe pse i rritur, nga duart ia mori bukën Tringës, vajzës sime 12 vjeçare?!!! Atë ditë, megjithatë, ne mbetëm pa bukë. Por, ndërkohë takova fqinjin tonë, Shaqir Shaqirin, i njohur si mësuesi Shaqë, një veprimtar e humanist i madh. Ai sapo kishte ardhur me familjen e tij nga Prishtina, m’i dha disa gurabije që i kishte marrë me vete nga shtëpia. Për atë ditë e atë natë na mjaftuan ato gurabijtë e fqinjit tonë të nderuar, Shaqës. Po ashtu, në Bllacë, takova Mire Gashin me familje. Me mësuesen e dalluar Mire, punonim së bashku në shkollë. Aty takova edhe Qëndrim Gashin djalin e saj, ish-nxënës imi, tani Doktor i Matematikës, ish-ambasador e profesor i shquar ndërkombëtar. Në Bllacë ne qëndruam deri më 7 prill, ku në orët e hershme të mëngjesit, diku rreth orës 4:00, iu



afrova ushtarëve maqedonas duke i lutur me mirëkuptim dhe ndjenjë humaniteti, duke i njoftuar se fëmijët nuk po ndjeheshin mirë, duke kërkuar nga ata për të na mundësuar për të kaluar atë kufi të mallkuar!... Një ushtar, me shumë mirësjellje, ndoshta ishte shqiptar (?) më tha: “Shko dhe zgjoji fëmijët dhe ejani!”. Me shpejtësi u ktheva te gjysmëtenda dhe i zgjova nga gjumi fëmijët dhe bashkëshorten. Shpejt i morëm valixhet dhe u nisëm drejt vendit, pika e caktuar, ku më sygjeroi ushtari. Por, ky ushtari për një çast e kishte ndërruar vendin e pozicionin, ndërkaq ai tjetri që ishte aty, na u kërcënua që të zbrisnim shpejt poshtë. Por, për fatin tonë, nga largësia na vërejti ai ushtari i cili më herët më kishte premtuar se do të na ndihmojë ta kalonim kufirin. Ai na ftoi që të afroheshim duke na ndihmuar që të kalonim mbi shkallët e improvizuara. Më në fund morëm frymë lirshëm. Autobusët ishin radhitur në pritje, ndërsa ne as që dinim se ku mund të na dërgonin?! Ishin disa procedura, para se të hipnim në autobus ngase persona të caktuar në gjuhën maqedonase na pyesnin të gjithëve për emrin e mbiemrin, vitin e lindjes dhe vendin... Disa gra të moshuara, por edhe më të reja, nuk kuptonin se çfarë po u thonin e kërkonin?!... Albulena, vajza ime 15 vjeçare, përveç gjuhës angleze njihje edhe gjuhën serbe, ku te dera e fundit e autobusit përkthente për ata që nuk e kuptonin gjuhën, ndërsa unë isha te dera e parë. Pas kryerjes së këtyre procedurave autobusi u nis. Askush nuk na tregonte se ku po na dërgonin. Dhe, pas një kohe autobusi u ndal në Kampin e

Stankovecit.

Në kampin e Stankovecit në intervistë me gazetarin e Televizionit Belg, VRT

Në Stankovec na pritën e na vendosën menjëherë në Tendën B-65, ushtarët italianë të KFOR-it, ku na dhanë pako me gjëra ushqimore, pije e veshmbathje. Në tendën tonë e vendosën edhe familjen Veselaj nga Gllareva e Klinës. Në Kampin e Stankovecit takuam edhe familjen Hajrullahu, fqinjët tanë të nderuar: Selamiun e Havën, vajzën e tyre – Jehonën si dhe djemtë Astritin e Kujtimin, ku kalonim së bashku një pjesë të kohës. Çdo mëngjes para tendës na sillnin gjëra ushqimore. Po ashtu edhe kushtet higjienike ishin, deri diku, pak më të mira, në krahasim me Kampin e përqendrimit famëkeq të Bllacës. Përkujdesja shëndetësore ishte në nivelin e duhur. Pas disa ditësh Kampi i Stankovecit u stërmbysh me refugjatë të luftës dhe gjendja u përkeqësua. Natën bënte shumë ftohtë. Sa herë që binte shi krijohesh baltë e madhe. Në Stankovec qëndruam prej datës 7-18 prill 1999. Në Kampin e Stankovecit filloi të bëhej jeta e padurueshme dhe e papërballueshme, e mundimshme dhe e frikshme. Përveç ushtarëve të KFOR-it, që përkujdeseshin për sigurinë tonë, vepronin edhe organizata humanitare të ndryshme ndërkombëtare. Opinioni botëror u njoftua me gjendjen e rëndë të refugjatëve shqiptarë të Kosovës. Filluan të vepronin urgjentisht: Kryqi i Kuq Ndërkombëtar, Komisariati i



Lartë Ndërkombëtar, OSB dhe UNHCR.

Shumë shtete të botës, përmes UNHCR-it filluan të merrnin refugjatë nga Kampi i Stankovecit. Unë u paraqita në zyrat e UNHCR-së, duke kërkuar që të më sistemonin në ndonjë nga shtetet, që të largoheshim nga kampi sa më parë.

Aty i plotësova formularët sipas procedurave të kërkuara dhe shtetin se ku mund të na dërgonin. Pasi i plotësova formularët, zyrtarit i kishte lënë përshtypje të madhe bukurshkrimi im.

Meqë unë nuk njihja gjuhën angleze, përkthyesi një djalë tejet i edukuar nga Prishtina, më drejtohet me shumë mirësjellje, duke më thënë se çfarë po më thoshte e propozonte zyrtari.

Ai mu drejtua duke më thënë se në cilën prej këtyre shteteve dëshiroja të shkoja: në Izrael, Holandë, Gjermani apo në Austri?! Mua, në ato çaste, më ishte ngulitur në mendje Belgjika. Prandaj, kërkoja të shkoja nëse do të më mundësohej vetëm në Belgjikë, pasi atje jetonte, që nga viti 1991, motra ime Sevdija së bashku me bashkëshortin, Avniun, si dhe fëmijët: Emirjetën, Shqipronin dhe Ermirën. Përgjigjja e zyrtarit irlandez ishte: “Belgjika ende nuk ka kërkuar zyrtarisht refugjatë”. Unë isha i vendosur, duke u thënë se vetëm në Belgjikë dëshiroja të shkoja. Zyrtari me shumë mirësjellje mu drejtua: “Belgjika ende nuk kishte ofruar njoftimin zyrtar për strehimin e refugjatëve të luftës nga Kampi i Stankovecit”. Zyrtari, megjithatë, shkruajti emrin tim, numrin e tendës B-65 dhe kërkesën time për Belgjikë. Po atë ditë ata e dërgojnë kërkesën time në ambasadën e Belgjikës në Shkup.

Dhe, pas një dite erdhën gazetarët belgë dhe më takuan te tenda B-65, ku edhe zhvilluan një intervistë me mua. Gazetari i ri, i njohur dhe i shquar belg Tim Pauwels, së bashku me kameramanin belg dhe një përkthyes shqiptar nga Shkupi, erdhën në tendën ku rrinim për të realizuar një intervistë, kronikë e dokumentar me mua dhe familjen time në Kampin e Stankovecit, pasi që Ambasada belge i kishte njoftuar ata për dëshirën time të zjarrtë që si refugjat i luftës të shkoja në Belgjikë.

Timi me profesionalizmin e tij të rrallë e humanizmin e madh realizoi një intervistë e kronikë të drejtpërdrejtë, të rrallë, prekëse dhe të veçantë televizive, duke njoftuar Qeverinë e opinionin belg për gjendjen, tmerrin e luftës që po përjetonim ne shqiptarët e Kosovës nga regjimi i egër shtypës e shfarosës i Millosheviqit, meqë po ushtronte e bënte dhunë të paparë, duke vrarë e djegur si dhe duke na dëbuar dhunshëm nga shtëpitë e trojet tona shekullore.

“Ju, Tim, erdhët në Kampin e Stankovecit në kohën e duhur dhe në momentet më dramatike, që po përjetonim për të na vizituar neve të dëbuarve kosovarë, refugjatë të luftës!”- i thashë. Pas mbarimit të Intervistës e kronikës, me pamjet nga kampi, ata na u falënderuan, por falënderimi për ta, me mirënjohjen më të thellë ishte i pafund nga ana jonë!

Para se të përshëndeteshin ata më dhanë një copë letër, me emrat e tyre dhe diçka të shkruar që mund të më shërbente si dëshmi.

Të enjten, më 15 prill, u realizua intervista, dhe po të njëjtën ditë, në orët e mbrëmjes e kishin dhënë kronikën për ne në lajmet qendrore Televizioni Belg, VRT, dhe televizionet tjera të Belgjikës.

Shumë shpejt reagon Qeveria belge, duke marrë vendim të menjëhershëm, që më 18 prill, t'i merrte 170 refugjatët e parë me aeroplan nga Kampi i Stankovecit. Njoftimin e dhanë dhe e publikuan në Kamp përfaqësuesit e UNHCR-së. Me shpejtësi u dha lajmi dhe u grumbullua një numër i madh refugjatësh, duke krijuar radhë të gjata pritjeje për të plotësuar formularët që kërkoreshin.

Meqë, gazetarët belgë më patën thënë, duke ma dhënë edhe një letër, se kurdo që Belgjika kërkon refugjatë nga ky kamp: “Familja juaj do të jetë ndër të parat!” Pas shumë përpjekjesh iu afrova zyrtarit, si dhe përkthyeses nga Mitrovica, duke i njoftuar e kërkuar nga ata që ta shikonin letrën e gazetarëve.

E vërejta, se përkthyesja nuk po përkthente siç duhej?!... Këtë e vërejtja edhe zyrtari, por që s'mund të kuptohesha me të pasi nuk dija anglisht.

Përkthyesja, me shumë ironi mu drejtua duke më thënë: “Mos vallë, me këtë copë letër po mendon se mund të shkosh në Belgjikë?!...”

– Pritë në radhë, nëse ke fat derisa të plotësohet numri i kërkuar! – më thanë.

Hyra në radhë të pritjes, pas një kohe vëreja se po priste në radhë për të shkuar në Belgjikë edhe fqinja jonë, Hava.

Atë, në pritje të gjatë, e ndërroinin nganjëherë Selamiu e Jehona. Ndërsa, mua herë pas here, më sillte ujë bashkëshortja ime, Naimja.

Pritëm në radhë prej orës 18:00 të mbrëmjes deri në orën 5:00 të mëngjesit, kur na njoftuan lajmin e hidhur se ishte plotësuar lista. I zhgënjyer tejmas, i lodhur e i dërrmuar u ktheva në tendë për të pushuar pak...

Gjatë ditës, shikoja se mos po publikohej ndonjë njoftim i ri nga ndonjë shtet tjetër?!... Diku rreth orës 18:00 ishin tubuar refugjatë të shumtë, duke shikuar e shpresuar se a janë emrat e tyre në listën e publikuar nga autoritetet belge dhe të UNHCR-së, se lista për t'u



strehuar në Belgjikë, tashmë ishte plotësuar.

Unë, as që u afrova për të shikuar?! Pas një kohe më ndal një i njohur dhe më thotë: “Sa mirë ishte bërë për ju, ku pashë listën që ishit pranuar për të shkuar në Belgjikë!”

Nxitova, meqë nuk besoja... U afrova duke shikuar me shumë kujdes listën, meqë më nuk kishte turmë të madhe njerëzish.

Në fillim të listës ishte emri im, si kryefamiljar dhe i anëtarëve tjerë të familjes sime. Shkova drejt te tenda, i njoftova fëmijët dhe bashkëshorten. Në fytyrat e tyre, pas një kohe shumë të gjatë, shpërtheu buzëqeshja e gëzimi i papërshekruar! Të dielën, më 18 prill 1999, u larguam paradite me një ndjenjë lehtësimi shpirtëror e emocional nga Kampi i Stankovecit, dhe të gëzuar u nisëm me aeroplan special nga Aeroporti i Shkupit për në Belgjikë. Në aeroplan ishim 170 refugjatët e parë të luftës nga Kosova.

Mikpritja më madhështore për ne në Belgjikë

Ne as që e dinim se me të arritur në Aeroportin e Brukselit, po na pritnin gazetarët e shquar belgë, Timi dhe kryeredaktori (tashmë) i ndjerë i Televizionit belg VRT Jose, si dhe motra ime Sevdija e dhëndri, Avni Durguti. Pasi pushuam e u çmallëm me ta, të gjithë refugjatët na dërguan në një bazë ushtarake për të rregulluar procedurat e statusin se çfarë kërkohej për qëndrim në shtetin shumë mikpritës, bujar e human të Belgjikës, si refugjatë të luftës. Madje, me autobusë e të shoqëruar me vetura të policisë na dërguan në Qendrën e Frepos, që më parë kishte shërbyer si pushimore e punëtorëve të postës, ku kushtet ishin shumë të mira, dhe asgjë nuk na mungonte.

Gjatë udhëtimit tonë me autobusë, në të dy anët e rrugës, kishin dalë qytetarët belgë për të na përshëndetur, e për të na uruar mirëseardhje, duke u solidarizuar me ne refugjatët e parë të luftës nga Kosova.

Të nesërmen në Qendër erdhën gazetarë të ndryshëm, jo vetëm belgë, për të na pyetur e intervistuar për gjendjen e luftën e tmerrshme, që kishim përjetuar në Kosovë, por edhe për kushtet në Kampet e Bllacës e të Stankovecit.

Një gazetar jo belg, ndër të tjera m'u drejtua me një pyetje provokative, duke më thënë: “Ju keni ikur nga bombardimet e NATO-s?!”. Përgjigjja ime ishte shumë e prerë duke i thënë: “Kjo që ju po thoni nuk është e vërtetë dhe se nuk qëndron, por jemi dëbuar nga regjimi agresiv i Millosheviqit, i cili në pamundësi për t'iu kundërpërgjigjur sulmeve të NATO-s, tërë arsenalin e tij luftarak (ushtarak e policor), ai e drejtonte ndaj popullsisë së pafajshme civile, duke vrarë e masakruar e duke realizuar politikën e Tokës së Djegur në Kosovë!”.

Pastaj iu drejtova gazetarëve: “Tash e sa më parë, për të shpëtuar Kosovën, atje duhet të dërgohen urgjentisht edhe Trupat Tokësore të NATO-s!”

Të gjitha intervistat dhe kronikat tjera televizive belge, kudo ku kam folur, i kam të ruajtura si dëshmi atëherë e kësaj dite. Këto dëshmi ua kam ofruar disa regjisorëve në Prishtinë, për të realizuar ndonjë dokumentar, por për çudi, asnjëri nga ata nuk ka shprehur interesim për këto?! Pas dy javësh, në Qendrën ku ishim të vendosur në Frepo, ne refugjatët, nën mbikëqyrjen e përkujdesjen e madhe të Kryqit të Kuq të Belgjikës, pasi që kishte shikuar intervistat e mia në TV, si dhe disa nga kronikat e shumta televizive belge, erdhi një zonjë e madhe dhe e nderuar belge, me shpirt e zemër humane për të na takuar e biseduar me ne.

Njohja dhe takimi i saj me ne ishte shumë i përzemërt e emocional, befasues dhe i papritur. Ajo na u prezantua me emrin Michele Delperdange, duke na u drejtuar me shumë dashamirësi e lutje për të na marrë në shtëpinë e saj.

Dhe, ne pas dy ditësh, vendosëm të shkonim. Bertogne ishte shumë larg Qendrës, ku banonin ata. Ajo erdhi me veturën e saj e

na mori. Na vendosi në shtëpi të re, ku asgjë nuk na mungonte. Shtëpinë e kishte rregulluar posaçërisht për ne, me të gjitha gjërat e reja. Dhe, të mos flasim për ushqim të bollshëm e veshmbathje të reja për të gjithë ne. Ajo shtëpi e saj, tashmë ku u vendosëm edhe ne, kishte edhe pishinë.

Në atë kohë me ne në Bertogne, ishte edhe familja Zeka-Spahi nga Ferizaj, Flora me fëmijët Lizin e Zanën. Ata qëndruan te familja Baltus, Zhozef e Marizhoja.

Me gjithë zemër ne e falënderojmë familjen Delperdange, posaçërisht zonjën e madhe e humanisten e dalluar, miken më të shtrenjtë të familjes sonë, Michele, prindërit e saj shumë bujarë e të dashur (tani të ndjerë), djalin e saj Fransua, qytetarët e dashur dhe shumë bujarë e fisnikë të Bertonjes (Bertogne), Shkollën fillore të Bertonjes (Bertogne), drejtoreshën Francine Lambert, mësueset: Stephanie Calbert, Pascale Meunier, e të tjerë. Gjimnazin Real të Bastonjes (Bastogne), Komunën e Bertonjes (Bertogne), Zhaninën, Kryqin e Kuq të Belgjikës, Mjekun e shuqar të familjës sonë, doktor Schabben, Kishën e Bertonjes (Bertogne). Njeriun e mirë e bujar Rene Gillet, Emilie, motrën e Michele dhe familjen e saj. Qendrën Strehuese të Frepos, si dhe drejtorin e palodhshëm e shumë të respektuar Billin. Me mirënjohjen më të thellë e të përzemërt falenderojmë gazetarët e shquar e shpëtimtarët tanë të VRT-së, Tim Pauwels e Joos Van Hemelrijck, televizionet tjera e gazetatat e njohura belge.

Ne Belgjikën e ndjejmë si atdhe tonin, të dytë! Më 29 qershor 2000, ne u kthyem vullnetarisht nga Belgjika në Kosovë, edhe pse e kishim të rregulluar statusin e refugjatëve të luftës, ku mund ta merrnim edhe shtetësinë belge. Ky ishte një rrëfim yni familjar, me përjetime lufte, nga ai rrugëtim i gjatë, por edhe ngadhënjimtar.

DITËLINDJA E RADHËS E GAZETËS MË TË GUXIMSHME SHQIPTARE



Ismet SYLEJMANI


25 Janari i vitit 2000, sigurisht se shënon shumë ditëlindje, por për ne 25 Janari i vitit 2000 shënon ditëlindjen e gazetës EPOKA E RE, të gazetës më të guximshme shqiptare! Në këtë ditëlindje të gjithë gëzojnë, por më së shumti gëzon shoku e miku im i madh Muhamet Mavraj!

Gëzuar të gjithëve ditëlindjen e 26 -të Epokës së Re, e më së shumti shokut e mikut tim të madh Muhamet Mavraj! DITËLINDJA E “EPOKËS SË RE”, ËSHTË DITËLINDJA E GAZETARISË SË PAVARUR NË KOSOVËN E LIRË Ish – gazeta studentore legale e Universitetit të Prishtinës

“bota e re”, ish- gazeta ilegale e LPK-se “Zëri i Kosovës” bashkë me dokumentet e UÇK-së,definitivisht janë shkrirë gazetën e lirë dhe të pavarur “Epoka e Re”! Gazeta Epoka e Re, mbetet trekëndëshi i famshëm, i cili i ka lidhur në një edhe UP-në, edhe LPK-në edhe UÇK-në!

Shëndet e suksese themeluesit të saj, shokut e mikut tim të madh Muhamet Mavraj! Shëndet e suksese stafit të mrekullueshëm të “EPOKËS SË RE”! Gëzuar ditëlindjen e famshmja “EPOKA E RE”! Prishtinë, 25 Janar 2026!





Korenica po kërkohet edhe në Kinë

PRISHTINË, 26 JANAR - Meriton Korenica edhe pse vlerësohet lojtar shumë i rëndësishëm për Clujin, ka gjasa që të largohet nga skuadra rumune gjatë këtij muaji. Te Cluji kanë pranuar se kanë marrë oferta për Korenicën edhe nga Kina, por nuk kanë

përmendur emrat e skuadrave të interesuara. Gjithashtu, në garë është edhe ekipi nga MLS e ShBA-së, DC United që veçse ka ofruar 4 milionë dollarë për kartonin e tij. “Ka interes nga Kina, nga MLS për Korenicën por do të mundohemi ta mbajmë edhe pse do të jetë

vështirë pasi ofertat janë të mira. Ai është lojtar i rëndësishëm për ne dhe me largimin e tij do të humbim shumë, por do të shohim”, ka thënë Bogdan Mara, drejtori sportiv i Clujit. 29-vjeçari është pjesë e Clujit prej vitit 2024 dhe ka kontratë deri në verën e

vitit të ardhshëm, ndërsa në sezonin aktual, Korenica ka 7 gola e po asistime në 31 paraqitje në të gjitha garat. Gjithashtu, Korenica ka edhe gjashtë ndeshje të luajtura me Kombëtaren e Kosovës për të cilën debutoi në shtator të vitit 2023.



DRITA FITUESE E SUPERKUPËS

ANTALYA, 26 JANAR - Drita ka fituar Superkupën e Kosovës duke e mposhtur Prishtinën, me rezultat 2:1. Ky është trofeu i dytë i Superkupës në histori për skuadrën gjilanase, pas suksesit të saj të parë në edicionin 2018/2019, kur edhe atëherë kishte mposhtur të njëjtin kundërshtar. Ndeshja është zhvilluar në stadiumin “Mardan Sports Complex” në Antalya të Turqisë, atje ku të dyja skuadrat janë duke e zhvilluar fazën përgatitore për

stinorin pranveror. Prishtina, fituese aktuale e Kupës së Kosovës, ka kaluar e para në epërsi në minutën e 8-të me golin e Leotrim Kryeziut. Besnik Krasniqi ka barazuar rezultatin në 1:1 për Dritën në minutën e 39-të nga penalltia. Në fund të pjesës së parë, Prishtina ka mbetur me një futbollist më pak pasi Harun Kariq është ndëshkuar me karton të kuq për pengim të një kundërsulmi të shpejt të Dritës. Golin vendimtar e të



fitores (2:1), e ka shënuar Kristal Abazaj në minutën e 50-të, me gjuajtje me kokë, duke i dhënë Dritës trofeun e Superkupës. Trofeun e Superkupës Besnik

Krasniqi dhe Faton Malokut ia ka dorëzuar presidenti i FFK-së, Agim Ademi, ndërsa medaljet për ekipet janë ndarë nga kryetari i Komunës së Gjilanit, Alban Hyseni, dhe drejtori i sportit në Komunën e Prishtinës, Kushtrim Mushica. Pas fitores në finalen e Supekupës nuk ka munguar as urimi i presidentit Ademi për Dritën. “Përgëzoj përzemërsisht FC Dritën për fitimin e këtij trofeu, ku organizimi dhe performanca e

mirë në fushë u kurorëzuan me sukses. Një vlerësim i veçantë edhe për FC Prishtinën, për lojën e mirë e shpirtin luftarak deri në minutat e fundit. Ndeshje të tilla janë dëshmi e progresit të vazhdueshëm të klubeve tona dhe e ambicies për paraqitje dinjitoze edhe në arenën ndërkombëtare. Vazhdojmë përpara së bashku me punë dhe përkushtim për ta ngritur futbollin e Kosovës në nivelin që meriton”, ka thënë Ademi.

KËRKOHEN INVESTIME URGJENTE NË BREZOVICË PËR ZHVILLIMIN E SPORTIT

PRISHTINË, 26 JANAR - Komiteti Olimpik i Kosovës (KOK) ka prezantuar zyrtarisht ekipin që do të përfaqësojë vendin në Lojërat Olimpike Dimërore “Milano Cortina 2026”. Skitarët Kiana Kryeziu dhe Drin Kokaj do të mbajnë flamurin e Kosovës në këtë ngjarje madhore sportive, por sukseesi i tyre vjen me një sfond sfidash dhe një apel të fuqishëm për investime në infrastrukturën e sporteve dimërore në vend. Kryetari i Federatës Skitare të Kosovës, Milaim Kelmendi, ka thënë se mungesa e infrastrukturës së nevojshme sportive që nga paslufta është duke penalizuar zhvillimin e sportistëve në Kosovës, pasi në të kundërtën, sipas tij, në lojëra të tilla Kosova do të

përfaqësohej me më shumë skitarë. “Ata janë të përgatitur, kanë ditë shumë në borë, por kryesisht i kanë nëpër vende të tjera. Edhe gjithë ato mjete financiare kanë shkuar atje, do të thotë për t'u përgatitur këta. Duke e ditur që ne nuk kemi një infrastrukturë të tillë që të ngrisim edhe më lart cilësinë e këtyre sportistëve, edhe patjetër që me infrastrukturën e re që do të na vijë, dashtë Zoti, do të shkojmë edhe me dy, edhe me katër, edhe me gjashtë, edhe me më shumë sportistë, sepse kemi mundësi ta ushtrojmë këtë sport në vendin tonë këtu afër nesh. Kështu që infrastruktura është ajo e cila e ka penalizuar qysh nga mbarimi i luftës edhe deri tani që Kosova të ngecë vetëm me dy sportistë. Kështu që

nëse na bëhet infrastruktura e mirëfilltë si duhet në Kosovë, atëherë besoj që do të kemi më shumë garues prezent nëpër olimpiadat e radhës”, ka thënë Kelmendi. Këtij apeli i është bashkuar edhe presidenti i KOK-ut, Ismet Krasniqi, i cili i ka bërë thirrje Qeverisë së Kosovës të ndërmarrë hapa urgjentë për të investuar në Brezovicë, vend ky në të cilin skitarët vendorë edhe do të mund të përgatiteshin, por edhe të zhvilloheshin garat të nivelit të lartë. “Kiana na përfaqëson me tri disiplina dhe Drini me një. Kosova në Lojërat Olimpike Dimërore ‘Cortina’ do të jetë në mediet e gjithë botës për katër ditë radhazi. Kjo është besoj një impakt shumë i mirë për vendin tonë,



për qeverinë tonë, për vendin tonë si një shtet i ri që ka shumë nevojë për promovim të tillë. E kjo po bëhet më së miri përmes sportit. E ftoj Qeverinë e Kosovës që me hapa urgjentë të ndërmerr

masa që Brezovica, një aset shumë i madh i Kosovës, mos të lihet anash. Kemi nevojë për këtë vend që të investohet në infrastrukturë sportive. Jo vetëm për garuesit tanë, por pse jo të vijnë edhe nga rajoni të bëjnë gara dhe të ushtrojnë në atë vend, që mos të çojmë paratë në vende të tjera kur e kemi vendin tonë këtu brenda në Kosovë”, ka thënë Krasniqi. Paraqitja e Kosovës me dy atletë në “Milano Cortina 2026” është vlerësuar një sukses i madh, derisa është kërkuar që talenti dhe sakrifica e sportistëve të mbështeten nga një vizion strategjik dhe investime konkrete shtetërore për të garantuar një të ardhme të ndritur për sportet dimërore në Kosovë. /KP

Hoffenhemi dhe Beshiktashi afër marrëveshjes për Rashicën

PRISHTINË, 26 JANAR - Milot Rashica sipas të gjitha gjasave do të rikthehet në Bundesligën gjermane, por te skuadra e Hoffenheimit. Mediumet turke kanë bërë me dije se Hoffenheimi është në negociata zyrtare me Beshiktashin për Rashicën, i cili gjatë kësaj

jave mund të bëjë lëvizjen nga Turqia për në Gjermani. Negociatat mes klubeve janë duke shkuar mirë dhe palët janë afër marrëveshjes, pasi Hoffenheimi ka ofruar sulmuesin Adam Hlozek si pjesë të shkëmbimit me Rashicën. Mësohet se palët

janë duke i negociuar kushtet, përpara se të bëhet zyrtare gjithçka dhe Rashica të bashkohet me Hoffenheimin, ekip ku luajnë edhe tre futbollistët e Kosovës, Fisnik Asllani, Leon Avdullahu dhe Alban Hajdari. Rashica këtë sezon ka shënuar 2 gola dhe ka

bërë 3 asistime në 20 paraqitje për Beshiktashin, ekip me të cilin ka kontratë deri në vitin 2027. Ai te Beshiktashi është transferuar në vitin 2023, ndërsa karrierë ka bërë edhe te Norwich City, Galatasaray, Werder Bremei dhe Vitesse.





Në mbështetje të nenit 8, nenit 10 nën par. 2.2 dhe nenit 15 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës i shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës me datë 01.12.2010, nenin 7 të Udhëzimit Administrativ MFPT - Nr. 01/2024 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik i cili është pjesë e Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës i cili është i shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës me datë 11.03.204, neni 18 dhe nenin 22 të Rregullores Nr. 13/25 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës të miratuar nga Bordi i Drejtorëve të N.P.L "Përparimi" Sh. A, e duke u bazuar në vendimin me nr. të protokollit 155/26 të datës 26.01.2026 të Kryeshefit Ekzekutiv, N.P.L "Përparimi" Sh. A, me datë 26.01.2026 shpall:

KONKURS PUBLIK

I. Titulli: Mbledhës i mbeturinave – Punëtor Fizik

Numri i ekzekutuesve: 1

Orët e punës: 40 orë në javë

Kohëzgjatja e emërimit: Me kohë të caktuar një (1) vit nga të cilat gjashtë (6) muaj do të jenë punë provuese, me mundësi vazhdimi.

Përgatitja profesionale: Shkolla Fillore

Përvoja e punës: Preferohet një (1) vit

I raporton: Menaxherit të Njësisë të Mbledhjes dhe Transportimit të Mbeturinave

Koeficienti i pagës: 457.87 Euro Bruto

Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësi të punës:

- Kryen të gjitha punët në mbledhjen dhe ngarkimin e mbeturinave.
- Mbledh mbeturina dhe bënë zbrazjen e Kontejnerëve dhe mjeteve tjera për mbeturina apo çesëve nga shfrytëzuesit të shërbimeve në sektorin privat dhe shtetëror.
- Pas zbrazjes së Kontejnerëve dhe mjeteve tjera, është i obliguar t'i kthejë ato në vende të caktuara dhe për to të ketë kujdes.
- Është përgjegjës për kryerjen e punëve në mënyrë efikase dhe kualitative, për sjellje korrekte me qytetarët-shfrytëzuesit e shërbimeve.
- Për punën e tij i përgjigjet Menaxherit të Njësisë së Mbledhjes dhe transportimit të mbeturinave.

Aplikacionit i duhet bashkangjitur:

- Formulari për aplikim i N.P.L "Përparimi" Sh. A - Vushtri.;
- Dëshmitë për kualifikimin shkollor (e skanuar);
- Ekstraktin e lindjes; (certifikata e nxjerrë online në platformën e-Kosova do të pranohet);
- Certifikatën mbi dënimin penal të lëshuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, se nuk ka dënime penale në evidencën qendrore penale të Republikës së Kosovës (certifikata e nxjerrë online në platformën e-Kosova do të pranohen);
- Dëshmitë për përvojën e punës (të skanuara) (nuk është obligative);
- Kopjen e letërnjoftimit (e skanuar);

Kriteret e përgjithshme që duhet t'i plotësojnë të gjithë kandidatët.

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës.
- Të ketë zotësi të plotë veprimi.
- Të zotërojë të paktën njërën nga gjuhët zyrtare në pajtim me Ligjin për Gjuhët.

Mënyra e vlerësimit të kandidatëve.

- Testimi me shkrim deri në shtatëdhjetë (70) pikë.
- Intervista me gojë deri në njëzetë (20) pikë
- Jetë përshkrimi (CV) i kandidatit deri në dhjetë (10) pikë.

Periudha e aplikimit të kandidatëve dhe kalendari i përafërt i procedurës së rekrutimit.

Konkursi mbetet i hapur pesëmbëdhjetë (15) ditë kalendarike nga dita e publikimit të të njëjtit. Shpallja është e hapur nga data 27.01.2026 deri me datë 10.02.2026 në ora 16:00.

Kalendari i përafërt i procedurës së rekrutimit:

- Verifikimi paraprak i aplikacioneve të kandidatëve më së largu deri me datë 18.02.2026.
- Afati për ankesë nga data 19.02.2026 deri me datë 23.02.2026.
- Periudha e kandidatëve kur do t'i nënshtrohen testit me shkrim, dhe kur do të bëhet vlerësimi i tyre do të jetë më së largu deri me datë 05.03.2026.
- Afati për ankesë nga data 06.03.2026 deri me datë 09.03.2026.
- Periudha e kandidatëve kur do t'i nënshtrohen intervistës me gojë, dhe kur do të bëhet vlerësimi i tyre do të jetë më së largu deri me datë 16.03.2026.
- Afati për ankesë nga data 17.03.2026 deri me datë 19.03.2026.
- Publikimi i rezultateve përfundimtare në lidhje me kandidatin e suksesshëm është më së largu 26.03.2026.

- Formulari për aplikim i N.P.L "Përparimi" Sh. A - Vushtri.;
- Dëshmitë për kualifikimin shkollor (e skanuar);
- Ekstraktin e lindjes; (certifikata e nxjerrë online në platformën e-Kosova do të pranohet);
- Certifikatën mbi dënimin penal të lëshuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, se nuk ka dënime penale në evidencën qendrore penale të Republikës së Kosovës (certifikata e nxjerrë online në platformën e-Kosova do të pranohen);
- Dëshmitë për përvojën e punës (të skanuara) (nuk është obligative);
- Kopjen e letërnjoftimit (e skanuar);

Kriteret e përgjithshme që duhet t'i plotësojnë të gjithë kandidatët.

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës.
- Të ketë zotësi të plotë veprimi.
- Të zotërojë të paktën njërën nga gjuhët zyrtare në pajtim me Ligjin për Gjuhët.

Mënyra e vlerësimit të kandidatëve.

- Testimi me shkrim deri në shtatëdhjetë (70) pikë.
- Intervista me gojë deri në njëzetë (20) pikë
- Jetë përshkrimi (CV) i kandidatit deri në dhjetë (10) pikë.

Periudha e aplikimit të kandidatëve dhe kalendari i përafërt i procedurës së rekrutimit.

Konkursi mbetet i hapur pesëmbëdhjetë (15) ditë kalendarike nga dita e publikimit të të njëjtit. Shpallja është e hapur nga data 27.01.2026 deri me datë 10.02.2026 në ora 16:00.

Kalendari i përafërt i procedurës së rekrutimit:

- Verifikimi paraprak i aplikacioneve të kandidatëve më së largu deri me datë 18.02.2026.
- Afati për ankesë nga data 19.02.2026 deri me datë 23.02.2026.
- Periudha e kandidatëve kur do t'i nënshtrohen testit me shkrim, dhe kur do të bëhet vlerësimi i tyre do të jetë më së largu deri me datë 05.03.2026.
- Afati për ankesë nga data 06.03.2026 deri me datë 09.03.2026.
- Periudha e kandidatëve kur do t'i nënshtrohen intervistës me gojë, dhe kur do të bëhet vlerësimi i tyre do të jetë më së largu deri me datë 16.03.2026.
- Afati për ankesë nga data 17.03.2026 deri me datë 19.03.2026.
- Publikimi i rezultateve përfundimtare në lidhje me kandidatin e suksesshëm është më së largu 26.03.2026.

Lume's Details
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi



U osnovu člana 8, člana 10 stav 2.2 i člana 15 Zakona o radu br. 03/L-212 objavljenog u Službenom glasniku Republike Kosovo od 01.12.2010, člana 7 Administrativne upute MFPT br. 01/2024 o uređenju postupaka konkursa u javnom sektoru, koji je dio Zakona o radu br. 03/L-212 objavljenog u Službenom glasniku Republike Kosovo od 11.03.2024, člana 18 i člana 22 Pravilnika br. 13/25 o unutrašnjoj organizaciji i sistematizaciji radnih mjesta, donijetog od strane Upravnog odbora J.P. "Perparimi" Sh. A, i na osnovu odluke br. Protokola ____/26, a na osnovu rješenja br. protokola 155/26 od **26.01.2026**, godine glavnog izvršnog direktora, N.P.L. "Perparimi" Sh. A od **26.01.2026**, saopštava:

JAVNI KONKURS

- I. Naslov:** Skupljač otpada – Fizički radnik
Broj izvršilaca: 1
Radno vrijeme: 40 časova nedeljno
Trajanje termina: Na određeno vreme od jedne (1) godine, od čega će šest (6) meseci biti probni rad, sa mogućnošću produženja.
Stručna priprema: Osnovna škola
Radno iskustvo: Preferira se jedna godina
Izveštava: Menadžer Jedinice za prikupljanje i transport otpada
Iznos mjesečne plate: 457.87 Euro bruto

Opis radnih obaveza i odgovornosti:

- Obavlja sve poslove prikupljanja i utovara otpada.
- Skuplja otpad i prazni kontejnere i druge posude za otpad ili kese od korisnika usluga u privatnom i državnom sektoru.
- Nakon praznjenja kontejnera i drugih posuda, dužan je da ih vrati na određena mjesta i da vodi računa o njima.
- Odgovoran je za efikasno i kvalitetno obavljanje poslova, kao i za korektno ponašanje prema građanima-korisnicima usluga.
- Za svoj rad odgovara Menadžeru Jedinice za prikupljanje i transport otpada.

Uz prijavu je potrebno priložiti sljedeće:

- Formular za prijavu J.P. "Perparimi" Sh. A - Vučitrn;
- Dokaz o školskoj kvalifikaciji (skenirana kopija);

- Izvod iz matične knjige rođenih (online certifikat sa platforme e-Kosova će biti prihvaćen);
- Potvrdu o nekažnjavanju izdatu od Vijeća sudova Kosova, koja potvrđuje da nema krivičnih osuda u centralnoj evidenciji Republike Kosovo (online certifikat sa platforme e-Kosova će biti prihvaćen);
- Dokaz o radnom iskustvu (skenirana kopija) (nije obavezno);
- Kopija lične karte (skenirana kopija).

Dokumenti potrebni prije zasnivanja radnog odnosa:

- Da bude državljanin Republike Kosovo.
- Da ima punu poslovnu sposobnost.
- Da govori barem jedan od službenih jezika u skladu sa Zakonom o jezicima.

Način vrednovanja kandidata.

- Pismeni test do sedamdeset (70) bodova.
- Usmeni intervju do dvadeset (20) bodova
- CV kandidata do deset (10) bodova.

Rok za prijavu kandidata i okvirni kalendar procedure zapošljavanja.

Konkurs ostaje otvoren petnaest (15) kalendarskih dana od dana objavljivanja. Oglas je otvoren od **27.01.2026** do **10.02.2026** u 16:00 sati.

Okvirni kalendar procedure zapošljavanja:

- Prethodna verifikacija prijava kandidata najkasnije do **18.02.2026**.
- Rok za žalbu je od **19.02.2026** do **23.02.2026**.
- Period kada će kandidati polagati pismeni test, i kada će biti obavljena njihova evaluacija, biće najkasnije do **05.03.2026**.
- Rok za žalbu je od **06.03.2026** do **09.03.2026**.
- Period kada će kandidati obaviti usmeni intervju i kada će biti obavljena njihova evaluacija biće najkasnije do **16.03.2026**.
- Rok za žalbu je od **17.03.2026** do **19.03.2026**.
- Objavljivanje konačnih rezultata za uspješnog kandidata najkasnije do **26.03.2026**.

Okvirni kalendar postupka zapošljavanja može biti duži ili kraći, u zavisnosti od toga da li je pritužba podneta ili ne, a u zavisnosti od rada komisije za evaluaciju i kadrovske službe. U svim slučajevima kada se pritužba podnese u bilo kojoj fazi postupka zapošljavanja, žalba će imati suspenzivno dejstvo, sve dok istu ne razmotri Komisija za žalbe.

Kako se prijaviti i komunicirati sa kandidatima

Zainteresovani kandidati mogu dobiti prijavni formular u Arhivu N.P.L. "Perparimi" Sh. A u gradu Vučitrnu, ul. "Gjergj Kastriot Skënderbeu" br. 82, (bivša zgrada TMK kod Osnovnog suda u Mitrovici – filijala u Vučitrnu) svakog radnog dana od 08:00 do 16:00 časova. Kadrovska služba za sprovođenje člana 8 st. 3 Uputstva MFPT-br. 01/2024 za Uređenje konkursnih procedura u javnom sektoru, daće potrebna pojašnjenja za kandidate u vezi sa kriterijumima javnog konkursa, te pomoći i dati potrebna uputstva za prijavu putem elektronske adrese.

Podnošenje prijave sa svom potrebnom dokumentacijom u ovom javnom oglasu vrši se isključivo putem elektronske adrese: hrrperparimi@gmail.com.

N.P.L. "Perparimi" Sh. A u Vučitrnu nudi jednake mogućnosti zapošljavanja za sve građane Republike Kosovo.

Sva komunikacija tokom postupka javnog nadmetanja odvijat će se putem elektronske komunikacije.

Napomena: Prijave dostavljene nakon navedenog roka neće biti prihvaćene.

Objašnjenje:

Preduzeće ima za cilj da razjasni pitanje termina koji se koriste u rodnom kontekstu, gde reči i naslovi jednog roda uključuju i drugi rod.

Zaključak:

N.P.L. "Perparimi" Sh. A u Vučitrnu pruža jednake mogućnosti zapošljavanja za sve građane Republike Kosovo, a posebno ohrabruje pripadnike manjinskih zajednica, osobe sa invaliditetom i manje zastupljeni pol da se prijave.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



www.facebook.com/gjejpuneshpeite

RESTAURANT

SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Genius Connect” Sh.P.K. me seli në Fushë Kosovë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb UNIK: 812293025 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Genius Connect D.O.O. od Kosova Polje, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 812293025 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “Genius Connect” L.L.C. with headquarters Fushë Kosova, has come to the decision to quit its business: 812293025 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Ballkan Darabuka Dj Nicky” Sh.P.K. me seli në Mitrovicë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb UNIK: 811945312 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Ballkan Darabuka Dj Nicky” D.O.O. od Mitrovica, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811945312 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “Ballkan Darabuka Dj Nicky” L.L.C. with headquarters Mitrovica, has come to the decision to quit its business: 811945312 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “RAHAMOBISHOP” Sh.P.K. me seli në Prishtinë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb UNIK: 812220333 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “RAHAMOBISHOP” D.O.O. od Prishtina, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 812220333 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “RAHAMOBISHOP” L.L.C. with headquarters Prishtina, has come to the decision to quit its business: 812220333 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

“Palma” SH.P.K. me numër Unik Identifikues: 810679417, Gjilan me pronar Ekrem Shahini bënë shpallje në gazetë për zvogëlim të kapitalit nga 1759953.92 Euro në 4000 Euro.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Enkela Gashi shpall të pavlefshme dëftesat, certifikatën, diplomën QK “11 Marsi” Prizren.

- Belkize Krasniqi shpall te pavlefshme diplomën shme “Ymer Prizreni” Prizren.

- Dafina Gashi shpall të pavlefshme dëftesat e vitit XI , XII shme “Ymer Prizreni” Prizren.

- Nazmi Krasniqi shpall të pavlefshme certifikatën QK “11 Marsi” Prizren.

- Mesude Dogani shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - IX shfmu “Mati Logoreci” Prizren.
- “FAR” SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. Unik Identifikues: 810155722.

- Fitore Rexhepi shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore “Fazli Greiçevci”.

- Maurita Koca nga Bishtazhini KK Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e kl.10 të Gjimnazit “Hajdar Duishi” Gjakovë.

- Bedri Zeneli nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12 dhe diplomën dhe certifikatën e notave të Gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.

MEKA
®
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992





ROYAL CROWN

RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

Columbus, Georgia, USA
Since 1904

Columbus, Georgia, USA
0.5L